NË KËTË NUMËR LEXONI


9 Bastoremania


10 Çelësi që hapi kutinë e Pandorës


20 Fotoreportazh


30 Kuptimësia shtresore e shkrimit


36 Sëmundjet e gjirit

Fituesit e çmimit Nobel për vitin 2007 2

Milazim Krasniqi: Çka fshihet pas "negociatave shtesë"........ 3

Intervistë me myftiun Naim ef. Tërnava 4-6

Gëzim Qerimi: Vazhdimësi e reformimit në Arsimin e Lartë 7

Muhamed Jusufi – Kajolli: Në Kosovë unë nuk kam parë femra me ferexhe 8

Fitim Flugaj: Bastoremania 9

Avni Avdiu: Çelësi që hapi kutinë e Pandorës..................... 10

Sead Ujkani: Ekonomia në programet zgjedhore të subjekteve politike 11

Florije Ademi: A po e përkrah UNMIK-u spastrimin etnik të veriut të Mitrovicës.. 12-13

Blerime Ajeti: Jeta nën tymin e termocentraleve që prodhojnë kancer 14-15

Emine Vezaj: Koncepti koekzistencë në Islam 16-17

Demir Reshiti: Riaktualizohet opsioni i ndarjes së Kosovës .. 18-19

Osman D. Gashi: Fotoreportazh - Aktivitete të Shoqatës Kulturore "Zëri Ynë" në Muajin e Ramazanit 20-21

Ajni Sinani: Masakra e Sabrës dhe Shatillës 22-23

Mehmet Shkëmbi: Festa e Fitër Bajramit 24

Muhamed Jusufi – Kajolli: Betejat e myslimanëve në gadishullin arabik-2 25-27

Sadik Mehmeti: Një vështrim i përhapjes së dorëshkrimeve orientale në Kosovë 28-29

Flamur Maloku: Kuptimësia shtresore e shkrimit 30-31

Ervina Halili: Mall për kohën e heshtur (poezi) 32

Gëzim Aliu: Artshkrimi i erës së re 33

Iliriana Alloqi & Artan Bejta: Dhjetë ushqimet natyrale më të shëndetshme 34-35

Dr. sci. Selami Sylejmani: Sëmundjet e gjirit 36-37

Arber Zeka: Masturbimi 38

Lulzim Ahmeti: Kosova pret mbështetjen e Donatorëve ndërkombëtarë edhe pas statusit 39

Fjalëkryqi 40



REVISTË MUJORE PËR AKTUALITET,
KULTURË, ARSIM, ETIKË

Viti I / Nr. 11
19 Tetor 2007

Botues



O.J.Q. "Zëri Ynë"

Drejtor
Muhamed Jusufi - KAJOLLI
kajolli5@hotmail.com

Redaktor përgjegjës
Demir RESHITI
demireshiti@hotmail.com

Redaktor gjuhësor
Flamur MALOKU
flamurmaloku@hotmail.com

Redaktor teknik/Grafika
Osman D. GASHI
osmangashi@msn.com

Anëtarët e redakisisë:
Arber ZEKA
Gëzim QERIMI
Lulzim AHMETI
Mergim LUSHTAKU
Sead UJKANI
Shkelzen NUZA

e-mail:
revistapaqja@gmail.com
revistapaqja@yahoo.com
revistapaqja@hotmail.com

Adresa:
Rr. Xhavit Mitrovica, nr. 14,
përballë teatrit Dodona,
Prishtinë, Kosovë

Letërsi



Doris Lessing

Paqe




Al Gore



Këshili Botëror për Ndryshimin e Klimës

Ekonomi



Leonid Hurwicz



Eric S. Maskin



Roger B. Myerson

Oslo

Fituesit e çmimit Nobel për vitin 2007

Nga data 8 deri më 15 tetor, në Oslo të Norvegjisë u bë ndarja e çmimit Nobel, i cili jepet për të arriturat në fushat e Mjekësisë, Fizikës, Kimisë, Letërsisë, Paqes dhe Ekonomisë. Laureat të këtij çmimi për këtë vit janë gjithsej 11 individë dhe një organizatë (Këshilli Botëror për Ndryshimin e Klimës). Dy çmime (për Mjekësi dhe Ekonomi) janë ndarë në tri pjesë, dy të tjera (për Fizikë dhe Paqe) janë ndarë në dysh, ndërsa çmimi për Kimi dhe Letërsi është ndarë i plotë.
Më poshtë po i paraqesim fituesit e çmimeve në mënyrë kronologjike sipas datës së ndarjes:

MJEKËSI

8 TETOR 2007

Çmimi Nobel në Fiziologji ose Mjekësi 2007 i është ndarë Mario R. Capecchi, Martin J. Evans and Oliver Smithies për zbulimet e tyre në "parimet për paraqitjen e modifikimeve në gjenet e veçanta tek miu me përdorimin e qelizave embriologjike"

FIZIKË

9 TETOR 2007

Çmimi Nobel në Fizikë i është Albert Fert Unité Mixte de Physique CNRS/THALES, Université Paris-Sud, Orsay, France dhe Peter Grünberg Forschungszentrum Jülich, Germany, "për zbulimin e efekteve magneto-rezistuese".

KIMI

10 TETOR 2007

Akademia mbreterore suedeze e shkencave bëri të ditur se çmimi Nobel për kiminë për vitin 2007 i takoi Gerhard Ertl-it, nga instituti Fritz-Haber, Max-Planck-Gesellschaft, Berlin, Gjermani, "për zbulimet e tij në proceset kimike në sipërfaqet solide ".

LETËRSI

11 TETOR 2007

Autorja britanike Doris Lesing, ka fituar çmimin e sivjetshëm Nobel për letërsinë. Akademia mbretërore në Stokholm bëri të ditur se me këtë çmim çmohet, shprehimisht, shkrimtarja epike e përvojës femërore, e cila analizon me skepticizëm, pasion dhe forcë vizionare shoqërinë e fragmentarizuar. Shkrimtarja ndërkohë 87 vjeçare e arriti suksesin ndërkombëtar me romanin e botuar në vitin 1962 'Libri i artë i shënimeve'. Romani u kthye në vepër kult të lëvizjes së grave. Çmimi shoqërohet me 1.100.000 euro.

PAQE

11 TETOR 2007

Albert Arnold (Al) Gore Jr. dhe Këshilli Botëror për Ndryshimin e Klimës janë fitues të çmimit të sivjetmë Nobel për paqen. Komiteti Nobel në Oslo duke argumentuar vendimin tha se të nderuarit me këtë çmim janë kujdesur për sensibilizimin lidhur me ndryshimin e klimës dhe kanë hedhur bazat për marrjen e masave përkatëse.

EKONOMI

15 TETOR 2007

Çmimi Nobel për ekonominë iu dha këtë vit shkencëtarëve amerikanë Leonid Hurwicz, Eric Maskin dhe Roger Myerson. Akademia suedeze për shkencat, nderoi kështu tre përfaqësuesit e të ashtuquajturës teoria mekanike e dizajnit (design). Kjo teori fokusohet tek mundësitë e vënies së rregullave për tregjet dhe institucionet ekonomike, në mënyrë që ato të funksionojnë siç duhet. Ky çmim shoqërohet me 1.1 milionë euro.

Mjekësi



Mario R. Capecchi




Sir Martin J. Evans




Oliver Smithies

Fizikë



Albert Fert



Peter Grünberg

Kimi



Gerhard Ertl

Ana tjetër e medaljes

ÇKA FSHIHET PAS "NEGOCIATAVE SHTESË"

Duket se strategët kundër pavarësisë së Kosovës, duan që me shtyrje dhe me komplikime të reja,ta shpijnë Kosovën drejt eksplodimit, të cilin do ta përdornin pastaj si argument final kundër pavarësisë së saj.



Milazim KRASNIQI

Të ashtuquajturat "negociata shtesë", të cilat janë miratuar sipas kërkesave serbe e ruse, në të vërtetë janë një presion shtesë mbi Kosovën, që të heqë dorë nga përcaktimi i saj edhe për një pavarësi të mbikëqyrur. Ekskursionet e kota të delegacioneve të Prishtinës e të Beogradit sa në Bruksel, sa në Nju Jork sa në Londër, janë blerje e kohës, për ta paketuar disi në fund një zgjidhje, e cila do ta kënaqte edhe palën serbe, e kjo do të thotë zgjidhje, e cila pashmangshëm do ta hidhëronte palën shqiptare. Nuk ka asnjë gjasë që të gjendet zgjidhje e cila do të kënaqte edhe ish-okupatorin e edhe të ish-okupuarin, të cilët janë në konflikt për të njëjtin territor.

Edhe përkundër këtij fakti, deklaratat e përsëritura të zyrtarëve rusë se duhet gjetur një zgjidhje, e cila do të kënaqë të dyja palët, është bërë formula dominuese e këtyre negociatave shtesë. Në favor të kësaj formule perverse, u deklarua madje edhe presidenti francez, Nikolas Sarkozi, gjatë qëndrimit në Moskë, edhe pse më herët ai ishte dukur i vendosur në favor të pavarësisë së mbikëqyrur, të cilën e ka propozuar Arti Ahtisari. Presidenti Sarkozi, duket se në Moskë ka harruar që ministri i tij i jashtëm, Bernard Kushneri, bashkë me ministrin e jashtëm britanik, Dejvid Milibandin, ka firmosur një tekst në favor të zgjidhjes që ofron plani i Ahtisarit. Por, rregullat në këtë mes nuk janë duke vlejtur, madje as për Sarkozinë.

Në të vërtetë, këto negociata shtesë, paradoksalisht janë të ngjashme me lojën shtesë në futboll. Lojën shtesë në futboll e zyrtarizon referi i katërt, pra ai që nuk është fare përgjegjës për lojën dhe mbarëvajtjen e saj në terren. (Ashtu si po bën Rusia me negociatat shtesë për Kosovën.) Minutat shtesë mund të jenë edhe minutat më të paparashikuar, sepse pala humbëse përpiqet të nxjerrë ndonjë favor, me simulime dhe me sjellje agresive. (Ashtu si po bën Serbia me nxjerrjen e kartës së bandave të car Llazarit.) Në fund, minutat shtesë llogariten si pjesë e rregullt e lojës, edhe pse nuk janë pjesë e saj. (Ashtu po i trajton negociatat shtesë edhe komuniteti ndërkombëtar, edhe pse ato janë rezultat i prishjes së rregullave të lojës, të cilën vetë e kishte afatizuar me mandatin për Ahtisarin.)

Gjatë të ashtuquajturave "negociata shtesë", Kosovës dhe banorëve të saj, u është imponuar edhe një presion i paparë psikologjik, si pjesë e dhunimit të rregullave të lojës. Në këtë periudhë janë promovuar edhe çdofarë ushtrish, që deklarojnë se janë të gatshme të rinisin luftërat e reja. AKSH-ja në njërën anë dhe bandat e car Llazarit në anën tjetër, janë vë në funksion të rikujtimit të llahtarive të luftës së shkuar. Nga ana tjetër, është "zbuluar" edhe korridori i ri për refugjatët, që kësaj here thuhet se është më i përshtatshëm për t'i mbajtur refugjatët në torishtë, e për të mos i lënë që t'ia mësyjnë shteteve të Bashkimit Evropian. Kroacia thuhet të ketë dalë vullnetare në këtë projekt. Edhe pse lajmi i gazetës kroate "Jutarnji list" u demantua nga zonja Di Karlo, prapë se prapë frika e injektuar, ka mbetur të prodhojë efektet e veta.

Ky skenar lufte, në fakt, është vë në qarkullim, për të bërë presion mbi qytetarët e Kosovës, që të zbutin qëndrimin e vet, pra që të heqin dorë nga pavarësia, sepse vetëm ashtu po u evituaka fati i përsëritur i katastrofës humanitare dhe i tmerreve të luftës.

Gjatë këtyre "negociatave shtesë" qytetarëve të Kosovës u është imponuar edhe një luftë e tmerrshme propagandistike, e veshur me gjoja angazhim diplomatik. Deklaratat e shumicës së diplomatëve janë kundërthënëse, konfuze, injorante. Po të mos ishte një realitet i hidhur, do të ishte një propagandë qesharake, kjo që na serviret prej tyre. Mjafton të shihen këta tituj, të huazuar nga dy agjencitë kosovare të lajmeve, për të parë qëndrimet konfuze të këtyre diplomatëve: "Vizner: Nuk ka të ngjarë që çështja e Kosovës të zgjidhet këtë vit", "Frid: Uashingtoni kundër shtyrjes së statusit përtej afatit të caktuar", "Di Karlo thotë se pavarësia e Kosovës është e pashmangshme", "Ishinger paralajmëron një konferencë të tipit të Dejtonit për Kosovën", "Harçenko: S' ka Dejton për Kosovën", "BE është thellësisht e ndarë lidhur me pavarësinë e Kosovës, thotë Patën", "Shqiptarët e Kosovës duhet të pajtohen me një formë të pavarësisë, thotë Kushner", "Ishinger: Gjasat për marrëveshje ekzistojnë, por nuk janë të mëdha", "Solana: Solana thotë se ka gjasë që të arrihet marrëveshja për Kosovën deri më 10 dhjetor", "Statuskuoja në Kosovë është e paqëndrueshme, tha Oli Ren".

Ka edhe me dhjetëra deklarata të këtilla, konfuze e diletante, nga diplomatë që janë përgjegjës për këtë proces. E tëra tregon se diplomacia ka mbetur pa një grimë etike dhe se i ka barazuar xhelatin dhe viktimën. Në vend që Serbia të ndëshkohej për krimet që ka bërë mbi popullatën e pafajshme, asaj i afrohen favore si pranimi në Partneriteti për Paqe. Madje kryeministri italian, Romano Prodi dhe ai slloven, Janez Jansha, kanë propozuar pranimin e përshpejtuar të Serbisë në Bashkimin Evropian!!! A e bëjnë këta njerëz një pyetje elementare: shteti që ende nuk është defashistiziuar, nëse pranohet në Bashkimin Evropian, a e bartë atje virusin vdekjeprurës të asaj ideologjie? Çfarë statusi do të kishin Karaxhiqi e Mlladiqi dhe të akuzuarit e tjerë për krime lufte, nëse shteti i tyre, Serbia, do të bëhej anëtar i Bashkimit Evropian? Por, në këtë proces dhe veçmas në të ashtuquajturat "negociata shtesë", nuk ka mbetur shumë vend për pyetje logjike.

Duket se strategët kundër pavarësisë së Kosovës, duan që me shtyrje dhe me komplikime të reja, ta shpijnë Kosovën drejt eksplodimit, të cilin do ta përdornin pastaj si argument final kundër pavarësisë së saj.

Intervistë me myftiun e Kosovës, Mr. Naim ef. Tërnava

Do të përjashtohen nga BIK-u hoxhallarët që merren me politikë

- Mbi 80 për qind e xhematit falen jashtë objekteve fetare...;
- 57 shtete anëtare të Konferencës Islamike, kanë marrë qëndrim që ta njohin në pako pavarësinë e Kosovës;
- Liderët tanë nuk duhet të bëhen servilë të politikës ditore;
- Presheva dhe Bujanovci janë pjesë të pandara tonat...;
- Ministria e Arsimit duhet t'i luftojë dukuritë tjera negative që po ndodhin nëpër shkolla e jo mbulesën;

Intervistoi: Demir RESHITI

Aktiviteti i Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK), gjatë muajit të madhërishëm të Ramazanit; problemet me të cilat po përballet ky institucion fetar; kontributi i BIK-ut në sensibilizimin e faktorit ndërkombëtar lidhur me çështjen e Kosovës; çështja e angazhimit në politikë të disa hoxhallarëve; qëndrimi ndaj përjashtimit nga shkolla të vajzave me mbulesë, etj., janë temë e intervistës që zhvilluam me kreun e Bashkësisë Islame të Kosovës Mr. Naim ef. Tërnava.

PAQJA: Çfarë aktiviteti keni zhvilluar gjatë muajit të madhërishëm të Ramazanit?

TËRNAVA: Bismilahirrahmanirrahim. Falënderojmë Allahun xh.sh. që na bëri të mundur që edhe njëherë të jemi pjesëtarë të këtij muaji të shenjtë të Ramazanit, muajit të Kur'anit, muajit të librit të shpallur, dhe të muajit të njërës nga shtyllat e islamit, siç është agjërimi. Sigurisht, që i madhi Zot këtë muaj e ka veçuar nga muajit e tjerë dhe se në këtë muaj është zbritur Kur'ani, në këtë muaj ka ndodhur edhe lufta e Bedrit, është hapur një faqe e re e historisë islame. Në këtë muaj është nata e Kadrit, dhe ka edhe shumë e shumë karakteristika tjera, të cilat e veçojnë nga të gjithë muajt e tjerë. Bashkësia Islame e Kosovës, ka bërë aktivitete të shumta gjatë këtij muaji. Është një ekip prej 25 imamëve që dalin pothuajse çdo natë nëpër të gjitha komunat e Kosovës ku vizitojnë xhematët, xhamitë, ligjërojnë, shihen me xhematët, pastaj marrin pjesë nëpër shumë radio e televizione lokale të vendit, nëpër tribuna të shumta në nivele komunale dhe në nivel qendror, etj., me një fjalë është një aktivitet i shtuar i Bashkësisë Islame të Kosovës gjatë këtij muaji të shenjtë të Ramazanit.

Mbi 80 për qind e xhematit falen jashtë objekteve fetare...

PAQJA: Çfarë bashkëpunimi keni me institucionet vendore dhe ato ndërkombëtare?

TËRNAVA: Në përgjithësi kemi bashkëpunim të mirë me institucionet tona vendore, por mund të jetë edhe më i mirë. Nuk është i mirë në aspektin e kërkesave që i bën Bashkësia Islame e Kosovës. Ne për shembull kemi bërë kërkesë të vazhdueshme në Kuvendin e Kosovës, që ta fusë lëndën e mësim besimit nëpër shkolla, pastaj kemi bërë kërkesë në vazhdimësi që të na ndahen frekuenca për një radio dhe për fat të keq, tash e tetë vjet kemi marrë përgjigje negative. Pastaj kemi kërkuar që të na krijohet mundësia e hapjes së një emisioni televiziv dy orë në ditë që do të përgatitej nga Bashkësia Islame e Kosovës, por edhe kjo nuk është bërë deri më tani, andaj nuk mund të them se marrëdhëniet janë shumë të mira.

Edhe nga pushteti lokal këtu në Prishtinë, kemi marrë përgjigje negative në kërkesën tonë për dhënien e një hapësire të nevojshme për ndërtimin e një Qendre Kulturore Islame në kuadër të së cilës, do të jetë edhe një xhami e madhe, në të cilën mund të falen njëkohësisht 10 mijë xhematlinj, ngase siç po e shihni edhe ju, mbi 80 për qind e xhematit falen jashtë objekteve fetare, në mungesë të hapësirës së mjaftueshme nëpër xhami, në veçanti gjatë namazit të xhumave, teravive, etj.

Nga ana tjetër, me pushtetet lokale nëpër shumicën e komunave tjera të Kosovës kemi pasur një bashkëpunim shumë të mirë. Kemi një bashkëpunim shumë të mirë edhe me televizionet dhe radiot lokale, por jo edhe me tri televizionet që kanë frekuenca kombëtare.

Me institucionet ndërkombëtare Bashkësia Islame e Kosovës ka një bashkëpunim shumë të mirë. Me të gjitha zyrat ndërlidhëse të shteteve të ndryshme që janë në Kosovë, pastaj edhe me UNMIK-un, e në veçanti PSSP-në, Joachim Ruecker dhe me të gjithë paraardhësit e tij. Ky bashkëpunim është ka reflektuar edhe me një bashkëpunim tepër të mirë me Zyrën Amerikane në Prishtinë, pastaj me atë Zvicerane, Gjermane, Bullgare e të tjera.

Falë këtij bashkëpunimi, ne kemi zhvilluar një vizitë 16 ditore në Amerikë, kemi qenë mysafirë të Stejt Departmentit amerikan, kemi vizituar edhe shumë vende, si Uashingtonin, Nju Jorkun, Detroitin, e shumë qytete tjera. Pastaj kemi vizituar Bundestagun gjerman, e kështu me radhë.

PAQJA: Përmendet një vizitë që ua keni bërë SHBA-së dhe diasporës. Sa janë të organizuar atje komuniteti islamik shqiptar?

TËRNAVA: Unë falënderoj shumë të gjitha qeveritë, si në Zvicër, Gjermani, Danimarkë, Norvegji, Austri, Amerikë dhe vende të tjera ku ju kanë krijuar hapësirë të bollshme vëllezërve dhe motrave tona, që të organizohen nëpër qendra islame. Ato qendra, nuk e kanë rolin thjeshtë vetëm të një xhamie, por aty zhvillohen aktivitete të shumta, ku krahas lutjeve, organizohet edhe mësim në gjuhen shqipe që ndikon që fëmijët shqiptarë të mos e harrojnë gjuhën e nënës. Mund të them me plot gojën, se mërgata shqiptare ka kontribuar jashtëzakonisht shumë, si në aspektin moral të përkrahjes së Kosovës, ashtu edhe në aspektin material, pastaj edhe në aspektin ushtarak-fizik kur ka qenë nevoja. Ata në vazhdimësi e kanë dhenë provimin dhe nuk kanë kursyer asgjë nga kafshata e gojës. Tash isha në Zvicër para pak ditësh, dhe vërtetë ka qenë një pritje jashtëzakonisht e mirë. Kam, kaluar atje pesë ditë të paharrueshme, dhe unë i falënderoj të gjithë ata që u kujdesen për qëndrimin tim atje, dhe më shoqëruan në më tepër se 20 qendra, ku jam njohur për së afërmi me hallet dhe kërkesat e tyre. Ata janë të interesuar, që bashkësia Islame e Kosovës, të jetë sa më afër tyre dhe ne iu kemi premtuar, se do ta bëjmë një gjë të tillë.

PAQJA: Në Kongresin islamik për Euro-Azinë, ju jeni zgjedhur nënkryetar i parë. Sa keni kontribuuar në këtë organizatë që të sensibilizohet çështja e Kosovës?

TËRNAVA: Zgjedhja ime në këtë post për mua ka qenë një nder dhe sigurisht edhe për Kosovën, ngase janë hapur dyer të shumta për ta thënë fjalën tonë për Kosovën. Kjo më ka bërë të mundur që të jem prezent nëpër konferenca, takime dhe seminare në vende të ndryshme të botës, ku në emër të këtij këshilli kam ngritur çështjen e Kosovës, e cila ka reflektuar gjithkund me sukses, e në veçanti në Kongresin i cili është mbajtur në Kajro para 6 muajve, ku ishin të pranishëm përfaqësuesit e 87 shteteve. Aty u paraqita me një kumtesë, e cila u përkrah dhe u fut në konkluzionet e Kongresit përkrahja e Kosovës nga të gjitha shtetet të cilat ishin të pranishme në atë Kongres dhe që përfaqësoheshin me delegacione të niveleve të larta, presidentë shtetesh, kryeministra, ministra të jashtëm etj. Sigurisht, që në këtë drejtim

kemi bërë shumë dhe elhamdulilah prej Zotit, që Konferenca Islamike ku tubohen 57 shtete, në mbledhjen e fundit në Islamabad, ka marrë qëndrim që njohja e Kosovës të bëhet në pako nga të gjitha këto vende.

Liderët tanë nuk duhet të bëhen servilë të politikës ditore

PAQJA: Si e komentoni faktin se shumë nga liderët tanë që i përkasin besimit islam janë pak prezent nëpër xhami, ndërkohë që të njëjtit nuk pritojnë të shkojnë nëpër kisha me rastin e festave të krishtere?

TËRNAVA: Liderët tanë, nuk duhet të bëhen servilë të politikës ditore. Bota na njeh se çfarë jemi. Do t'i kisha ftuar të gjithë liderët të cilët i përkasin besimit islam që të vijnë, të jenë në mesin e popullit, t'i vizitojnë xhamitë, sepse i përkasin kësaj feje. Sikur të ishin deklaruar se i përkasin një feje tjetër kishte me qenë çdo gjë në rregull, që të shkonin t'i kryenin adhurimet e tyre edhe nëpër kisha. Shkuarjen nëpër kisha nuk e ndalon feja islame, mirëpo shkuarja e liderëve tanë nëpër kisha, por jo edhe në xhami është e pakuptimtë dhe këtë një mysliman i mirëfilltë nuk guxon ta bëj, sepse është lëshim do të thosha më tepër politik, sepse ta avancosh një besim përballë një besimi tjetër kjo nuk është një politikë e mirëfilltë që e udhëheq një politikan i çfarëdo partie politike, qoftë dhe unë kisha thënë se vërtetë këta bëjnë gabim kur e bëjnë një hap të tillë. Këta duhet t'i përmirësojnë sjelljet e tyre, në të kundërtën populli i cili po vetëdijesohet më të madhe në aspektin fetar, do të di ti ndëshkoj të gjithë ata që bëjnë vepra të tilla, apo hapa të tillë të pavend.



PAQJA: A bashkëpunoni me bashkësitë tjera fetare në Kosovë dhe çfarë relacioni keni me kishën ortodokse serbe?

TËRNAVA: Kemi marrëdhënie të mira me kishën katolike në Kosovë. Jemi munduar të kemi marrëdhënie të mira edhe me Kishën ortodokse serbe në Kosovë. Kemi arritur që në kuadër të grupit ndërfetar që ekziston në Kosovë tash e disa vite, t'i nënshkruajmë disa deklarata të përbashkëta,. Vitin e kaluar në Ipeshkvinë e Pejës është mbajtur një konferencë treditore, në të cilën janë rrahur problemet në këtë fushë, dhe në atë konferencë, jemi munduar t'ua bëjmë me dije serbëve se ato manastiret e tyre që janë në Kosovë janë thjeshtë të Kosovës dhe nuk mund të merren të qiten në krah e të dërgohen në Serbi, ato janë pjesë e trashëgimisë kulturore të Kosovës, prandaj ata i kemi ftuar që ta ndiejnë vetën qytetarë të Kosovës... Mirëpo, ata nuk kanë treguar një gatishmëri të mjaftueshme bashkëpunimi, veçanërisht zoti Artemije, i cili me punën e tij, jo të drejt, jo të mirë, ka futur intriga, gënjeshtra, shpifje të mëdha në mesin e priftërinjve të tij por edhe në mesin e qarqeve brenda Serbisë si dhe në ato ndërkombëtare, duke e akuzuar edhe bashkësinë islame të Kosovës, mirëpo edhe popullin e Kosovës se me pavarësinë e Kosovës, ky do të jetë një shtet xhihadist, një shtet kriminel, një shtet ku do të aplikohet sheriati, një shtet ku do të prehen duart, një shtet i cili sipas tij do të jetë kundër parimeve fundamentale njerëzore.

PAQJA: Me organizatat simotra në rajon çfarë bashkëpunimi keni?

TËRNAVA: Ju e dini që kohëve të fundit kemi pasur një jostabilitet në Bashkësinë Islame të Maqedonisë. Tani është zgjidhur ky problem dhe bashkëpunimi është gjithnjë e më i madh. Sigurisht, se bashkëpunim të mirë kemi dhe do të kemi edhe me Bashkësinë Islame në Shqipëri. Ne kemi një Këshill të përbashkët ndërfetar të formuar tash e 12-13 vjet më herët. Ai Këshill fetar për fat të keq është pasivizuar për shkak se rrjedhat e përgjithshme politike në Shqipëri, pothuajse kanë ngulfatur vazhdimin e një aktiviteti të tij, dhe ndoshta edhe neglizhenca e Bashkësisë Islame në Shqipëri ka bërë që ky Këshill të mos jetë shumë aktiv. Ne kemi ndërmarrë hapa që Këshilli... të aktivizohet dhe të punoj dhe të kemi mendime dhe qëndrime të përbashkëta të kryesive të të tri Bashkësive Islame, në Prishtinë, Shkup dhe Tiranë.

Presheva dhe Bujanovci janë pjesë të pandara tonat...

PAQJA: Po me Bashkësinë Islame të Serbisë?

TËRNAVA: Me Bashkësinë Islame të Serbisë nuk kemi kurrfarë bashkëpunimi. Në të ardhmen sigurisht se do të bëjmë përpjekje të vendosim bashkëpunim shpirtëror, sepse edhe ata janë besimtarë islam, dhe shpresojmë se këto marrëdhënie të arrijnë nivelin e atyre që kemi me Bashkësinë islame të Malit të Zi, i cili është bashkëpunim shumë i mirë. Ne kemi një pjesë, Preshevën, Medvegjën dhe Bujanovcin, që edhe sot e kësaj dite i mbikëqyrim në aspektin fetar. Ne kemi dërguar edhe imamin në Medvegjë, të cilin e paguajmë ne dhe zhvillon aktivitet fetar me ata pak vëllezër e motra që kanë mbetur aty, (kanë mbetur diku 750). Të rikujtojmë se para lufte aty kanë jetuar mbi 7500 shqiptar, dhe ata kishin mbetur pa asnjë udhëheqës fetar shpirtëror, dhe tani kemi dërguar një imam nga Presheva i cili ka arritur që atyre pak besimtarëve që kanë mbetur aty t'u shërbejë dhe ta kthej sadopak besimin edhe shpirtëror tek ata njerëz. Sigurisht që Presheva dhe Bujanovci janë pjesë të pandara tonat dhe ne nuk do të heqim dorë kurrë nga ajo pjesë në aspektin fetar, edhe pse ka pasur tentativa të ndryshme që të formohen bashkësi fetare për Luginë, ka pasur tendenca të disa njerëzve të shtyrë nga politika ditore e Beogradit që të bëjnë përçarje atje, por populli e ka kuptuar këtë dhe nuk iu ka krijuar hapësirë.

Ministria e Arsimit duhet t'i luftojë dukuritë tjera negative që po ndodhin nëpër shkolla e jo mbulesën

PAQJA: Cili është qëndrimi i Bashkësisë Islame të Kosovës lidhur me përjashtimin nga shkolla të tri vajzave në Skenderaj për shkak të mbulesës?

TËRNAVA: Qëndrimi i Bashkësisë Islame të Kosovës ka qenë edhe është se mbulesa është obligim fetar, që del nga porositë kuranore. Mirëpo, tek ne, fatkeqësisht tek njerëzit të cilët janë të thirrur ta mbrojnë arsimin, ata marrin hapa në largimin e nxënësve nga shkolla vetëm pse e mbajnë mbulesën. Dhe nëpër gazetat tona dhe mjetet tjera të informacionit fatkeqësisht lexojmë dhe dëgjojmë se ferexheja nuk lejohet në shkolla. Ata nuk dinë ta bëjnë dallimin në mes të mbulesës dhe ferexhesë. Duke e parë situatën e krijuar, unë kërkova një takim me zotin Ruecker dhe atij ia paraqita shqetësimet e mia dhe kërkova nga ai që të ndërmerr masa që ato vajza të kthehen në shkollë. Ai më premtoi se do të bisedoj me kryeministrin dhe ministrin e arsimit, dhe derisa nuk ka ligj për këtë çështje të miratuar në kuvendin e Kosovës, ato vajza duhet ta ndjekin mësimin dhe besoj se ato vajza shumë shpejt do t'i kthehen shkollës ashtu me mbulesë, sepse shamia nuk është pengesë assesi e mbarëvajtjes së suksesshme të procesit mësimor. Sigurisht që Ministria e Arsimit dhe të tjerët duhet luftuar dukuritë tjera që po ndodhin nëpër shkolla, lakuriqësia, droga, rrahjet..., dukuri këto që për fat të keq janë mjaft prezente nëpër shkollat tona.

PAQJA: A nuk keni bërë përpjekje që këtë

çështje ta zgjidhni ju vetë me kryeministrin dhe ministrin e arsimit, apo ka qenë e domosdoshme ndërhyrja e kryeadministratorit Ruecker?
TËRNAVA: Unë këto shqetësime disa herë ua kam shfaqur njerëzve tanë, mirëpo ata për fat të keq nuk kanë treguar gatishmëri për t'i zgjidhur këto probleme, andaj kam qenë i shtyrë që ta kërkoj ndërhyrjen e personit më autoritativ që është në Kosovë, z. Ruecker, i cili vjen nga një shtet demokratik ku nuk është e ndaluar bartja e shamisë nëpër shkolla, njëjtë si edhe në Amerikë, Zvicër e në vendet tjera më demokratike të botës, dhe jemi të bindur se ai do ta ketë këtë gjë parasysh dhe do të ndihmoj në tejkalimin e problemit.

Do të përjashtohen nga BIK-u hoxhallarët që merren me politikë

PAQJA: Jemi në prag të zgjedhjeve në Kosovë. Nga publikimi i listave të kandidateve të subjekteve të ndryshme politike po vërehet se kanë kandiduar edhe hoxhallarë. Si e shpjegoni këtë dukuri?
TËRNAVA: Bashkësia islame është mbipartiake. Sipas rregullores së Bashkësisë Islame të Kosovës, imamët dhe personat tjerë që punojnë në Bashkësinë Islame të Kosovës, nuk kanë të drejtë që të jenë të përcaktuar për një parti apo një tjetër. Është e vërtetë se nëpër lista zgjedhore këtë radhë janë emrat e disa hoxhallarëve, por ata me kohë kanë paraqitur dorëheqjen, sepse janë të vetëdijshëm se do të largohen nga puna. Çdonjëri i cili do të figurojë në listat zgjedhore për parlament të Kosovës dhe është punëtor i Bashkësisë Islame të Kosovës, do të largohet nga puna sepse ne nuk dëshirojmë që të kemi përçarje në mesin tonë, për arsye se ne u takojmë të gjitha partive. Ne ua kemi bërë të qartë të gjithëve: nëse dëshironi të merreni me politikë, urdhëroni, shkoni, largohuni nga Bashkësia Islame, zhvisheni petkun e imamit, apo punëtorit të Bashkësisë Islame, dhe urdhëro e jepe aktivitetin tënd aty ku mendon se mund të jesh i suksesshëm, por jo si punëtor i BI-së, e cila ka bërë që ata ta krijojnë një emër, ta keqshfrytëzoj këtë dhe të futet nëpër parti të ndryshme, dhe të fus përçarje në mes të myslimanëve.
Pra këta të cilët kanë dalë me emra dhe për të cilët ne nuk kemi pas njohuri më herët, vetëm kur i kemi parë, këta do të përjashtohen nga puna në bashkësinë islame të Kosovës. Jo vetëm këta, por edhe të tjerë të cilët mendojnë të merren aktivisht me politikë.

PAQJA: Në kuadër të Bashkësisë Islame të Kosovës ekzistojnë edhe medreseja dhe fakulteti i studimeve islame. Me çfarë vështirësish po përballet mbarëvajtja e arsimit në këto institucione?
TËRNAVA: Falënderojmë Allahun xh. sh. që na ka bërë të mundur ta kemi një shkollë të mirë këtu në Prishtinë, si për djem ashtu edhe për vajza. Tani kemi ndërtuar një shkollë të re në Prizren edhe për djem edhe për vajza, që është shkolla më e mirë në Prizren dhe një prej shkollave më të mira në Kosovë, dhe i plotëson të gjitha nevojat për një zhvillim tepër normal të procesit mësimor. Në Gjilan paksa kemi ngecur në këtë drejtim, por shpresojmë se vitin e ardhshëm edhe atje do ta ndërtojmë një shkollë të re.
Problem kryesor me të cilin ballafaqohet Bashkësia Islame e Kosovës lidhur me këto shkolla është baza materiale. Nga buxheti i Kosovës nuk ndahen mjete për Bashkësinë Islame të Kosovës, përkundër kërkesave të vazhdueshme tonat. Ju e dini që kemi afro 2000 punëtorë për të cilët duhet të kujdesemi që të marrin pagën mujore, gjë që për mua dhe Bashkësinë Islame është një përgjegjësi tejet e madhe. Unë mendoj dhe besoj se është detyrë e qeverisë së Kosovës që të ndaj nga buxheti i shtetit një shumë parash e cila do t'i mbulonte pagat e imamëve anekënd Kosovës, dhe të gjithë të punësuarve brenda Bashkësisë Islame të Kosovës.
Nuk kemi probleme për medresenë sa i përket kuadrit. Shyqyr Zotit, kuadri është qind për qind i kualifikuar, gjithashtu kemi siguruar edhe të gjitha tekstet e nevojshme, dhe diploma e medresesë është ekuivalente me të gjitha diplomat e shkollave të mesme tjera të Kosovës. Me këtë rast më duhet ta falënderoj ministrinë e Arsimit e cila tash e disa vite bën mbikëqyrjen direkte të medresesë "Alauddin", ashtu siç vepron edhe me shkollat tjera.
Ndërkaq fakulteti i studimeve islame i hapur para 15 vitesh, ka nxjerrë deri më tani afro 100 studentë të diplomuar nga Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Shqipëria. Është institucioni më i lartë i Bashkësisë Islame, në të cilin po bëhet një punë jashtëzakonisht e mirë. Në aspektin infrastruktural ndoshta nuk plotësohen kriteret e mjaftueshme, por ne besojmë se brenda një kohe të shkurtër do të fillojmë me ndërtimin e objektit të ri prej 8 mijë metrash katrorë ku do të krijohen hapësira të reja të mjaftueshme për nevojat e fakultetit. Shkaku i vonesës së ndërtimit të këtij fakulteti ka qenë procesi i marrjes së lejes nga kuvendi komunal i Prishtinës, proces që ka zgjatur më tepër se dy vjet dhe nuk na është lejuar ndërtimi në tokën tonë!. Më në fund e kemi marrë lejen dhe do ta fillojmë ndërtimin, nga se këtu kemi blerë edhe katër parcela, dhe kemi krijuar hapësirë të mjaftueshme për ndërtimin e fakultetit këtu në kompleksin ku është selia e bashkësisë islame të Kosovës.


Çdonjëri i cili do të figurojë në listat zgjedhore për parlament të Kosovës dhe është punëtor i Bashkësisë Islame të Kosovës, do të largohet nga puna, sepse ne nuk dëshirojmë që të kemi përçarje në mesin tonë, për arsye se ne u takojmë të gjitha partive.

PAQJA: Bashkësia Islame merret edhe me veprimtari botuese. Si po iu shkojnë punët në këtë drejtim?
TËRNAVA: Këtu kemi një ngecje. Kemi revistën Dituria Islame që është mujore dhe revistën Edukata Islame që del një herë në tre muaj. Gjatë vitit botojmë edhe libra. Shyqyr Zotit, tani kemi edhe një donacion për një shtypshkronjë dhe brenda muajit që vjen do të kemi shtypshkronjën tonë, gjë që do të na e lehtësojë punën për botimin e sa më shumë librave, sepse është nevojë dhe kërkesë e madhe e besimtarëve që të kenë literaturë të mjaftueshme për të lexuar. Jemi duke menduar për nxjerrjen e një gazete fillimisht javore e më vonë ndoshta edhe ditore, me qëllim që besimtarët të jenë të informuar për aktivitetet e Bashkësisë Islame të Kosovës.

PAQJA: Dhe për fund cili është mesazhi juaj për lexuesit e revistës "PAQJA", dhe në përgjithësi për besimtarët e fesë islame meqë jemi në fund të muajit të bekuar të ramazanit.
TËRNAVA: Revistës "PAQJA" i dëshiroj suksese. Është një revistë që e kam përcjellë që nga numri i parë. Kjo është një revistë që dallon nga revistat tjera për problematikat që rrah. Ju përgëzoj për punën madhore që po bëni. Ju dëshiroj suksese juve dhe të gjithë këshillit drejtues të kësaj reviste, njëherit nëpërmes kësaj reviste dëshiroj që t'i përshëndes të gjithë besimtaret e besimit islam, si në Kosovë, në trojet shqiptare dhe në mërgatën shqiptare, duke e lutur Allahun xh.sh. që agjërimin tonë ta ketë pranuar, që në mesin tonë të mbretëroj gjithnjë harmonia, familjet tona të kenë shëndet, që të na jep edhe më tepër kurajë që të punojmë për vetën tonë, për fenë tonë, për vendin tonë, dhe sigurisht jo vetëm me fjalë por edhe me punë të tregojmë që në të ardhmen e afërt Kosovën do ta kemi një shtet të pavarur dhe sovran. Kjo gjë mund të bëhet me punën tonë sistematike, duke respektuar edhe vlerat fetare islame që i përkasin shumicës absolute të këtij populli, si në Kosovë, Shqipëri, Maqedoni etj.

Zhvillimi i Kurrikulave në Arsimin e Lartë në Kosovë

VAZHDIMËSI E REFORMIMIT NË ARSIMIN E LARTË

Në fund të vitit akademik 2006/2007, Universiteti i Prishtinës (UP) ka vendosur të fillojë procesin e konsolidimit të kurrikulave dhe të zbatimit të studimeve të ciklit të dytë sipas Bolonjës. Këto procese, në UP janë zhvilluar duke u bazuar në vendimet përkatëse të Senatit të UP-së, të cilat ofrojnë edhe kornizën orientuese për këto procese



Gëzim QERIMI

Zbatimi i Procesit të Bolonjës në Kosovë ka filluar në vitin akademik 2001/2002, kur kishte orvatje për reformimin e kurrikulave të Universitetit të Prishtinës, i cili asokohe ishte institucioni i vetëm i arsimit të lartë në Kosovë. Kjo u bë në rrethana të një dualizmi të funksioneve në udhëheqje, kur administratori ndërkombëtar i UP-së njëkohësisht kryente edhe funksionin e bashkëdrejtuesit të departamentit të arsimit në Kosovë.

Ky proces ishte organizuar me një qasje lart-poshtë pa përfshirje të mësimdhënësve në pjesën e analizës së gjendjes, hulumtimit të nevojave dhe planifikimit të procesit, por vetëm duke zbatuar hartimin e kurrikulave sipas objektivave të Bolonjës.

Në atë kohë nuk qenë zhvilluar politikat dhe udhëzimet e veçanta për reformim të kurrikulave, pos një urdhërese për ndarje të lëndëve të vitit në semestra dhe për shndërrimin linear të programeve, të ciklit të parë nga katër vjeçare në studime trevjeçare.

UP-ja ndër institucionet e para të arsimit të lartë në rajon me sistem të Bolonjës

Përkundër këtyre mangësive, UP-ja ishte ndër institucionet e para të arsimit të lartë në rajon që i kishte hyrë një procesi të gjithmbarshëm të reformimit sipas objektivave të Bolonjës, duke bërë përpjekje për zbatimin e objektivave dy dhe tre (ECTS-ja dhe futja në zbatim i dy niveleve /cikleve të studimeve – bachelor dhe master).

Kjo periudhë karakterizohet edhe nga vështirësi në hartimin e kurrikulave dhe në zbatimin e ciklit të dytë të studimeve për master.

Një gjendje e këtillë ka vazhduar deri në vitin akademik 2006/2007. Gjatë këtij viti udhëheqja e UP-së bëri rishikimin e planeve mësimore, duke vendosur një lidhje më të mirë të kredive- ECTS me ngarkesën e punës së studentit dhe konsolidimit të silabuseve, bazuar në procesin evropian të harmonizimit (TUNING) të kurrikulave.

Tuning është një program i mbështetur nga Komisioni Evropian, që synon harmonizimin e strukturave të nxënies dhe të procedurave e të instrumenteve të hartimit dhe të rishikimit të kurrikulave. Kjo metodologji e vë theksin në kompetenca, rezultate të nxënies dhe në lidhjen e kredive ECTS me ngarkesën e punës së studentit.

Në anën tjetër, institucionet private të arsimit të lartë kanë hartuar kurrikulat e veta, duke u bazuar kryesisht në ato të UP-së, si dhe në disa raste duke u mbështetur në kurrikulat e rajonit por edhe më gjerë. Në këtë kuptim përjashtim bën Universiteti Amerikan i Kosovës –AUK, i cili bazohet në sistemin amerikan të studimeve.

Universiteti tjetër publik në veri të Mitrovicës, ka bërë përpjekje për reformim të programeve studimore, të cilat kanë dështuar tërësisht për shkak të ndërhyrjes flagrante të politikës (së qeverisë serbe) në strukturën udhëheqëse të universitetit.

Në fund të vitit akademik 2006/2007 UP-ja, ka vendosur të filloi procesin e konsolidimit të kurrikulave dhe të zbatimit të studimeve të ciklit të dytë sipas Bolonjës. Këto procese në UP, janë zhvilluar duke u bazuar në vendimet përkatëse të Senatit të UP-së të cilat ofrojnë edhe kornizën orientuese për këto procese. Në të njëjtën kohë, komisioni përkatës ka hartuar, ndërsa Senati i UP-së e ka miratuar rregulloren për studimet e ciklit të tretë (të doktoratës), në zbatim të objektivit të dhjetë të Bolonjës.

Po ashtu, UP-ja ka themeluar Njësinë për Sigurimin e Cilësisë, e cila ka për detyrë të përcjellë sigurimin e cilësisë në të gjitha aspektet e funksionimit të saj, me theks të veçantë cilësinë e kurrikulave.

Në të gjitha këto zhvillime, UP-ja ka siguruar përfshirje të plotë dhe pjesëmarrje aktive të tërë komunitetit akademik. Kështu, 4 prej 11 anëtarëve të komisionit të studimeve në Universitet janë studentë (të përfaqësuar pos kësaj edhe në komisionet e njësive akademike), gjë që ka ndikuar në përmbushjen e objektivit të tetë për përfshirjen e studentëve në ndryshimet e kurrikulare.

Shtatë studentët senatorë në Senatin e UP-së

Gëzim Qerimi –Paqja Studentore
Sead Ujkani –Paqja Studentore
Shkelzen Osmani -Paqja Studentore
Armend Rugova-UPSUP
Fidan Selimi -UPSUP
Labinot Halilaj –UPSK dhe
Bedri Istrefi-UPSK

Senati është organi më i lartë akademik i Universitetit të Prishtinës, i cili po ashtu miraton edhe kurrikulat. Në Senatin e UP-së studentët përfaqësohen me 17% të anëtarëve, apo me shtatë anëtar nga gjithsej 46 sa ka senati.

Komisioni për Studime në nivel të UP-së:

Prof. Dr. Luan Ahma - Prorektor i UP-së
Shkelzen Nuza - Paqja Studentore
Prof. Dr. Muharrem Jakupi - Fakulteti i Mjekësisë
Prof. Dr. Liman Matoshi - Fakulteti i Filologjisë
Iliriana Alloqi - Paqja Studentore
Prof. Fetah Podvorica - F. SH. M. N
Mr. Mehmet Behluli - Fakulteti i Arteve
Lulzim Krasniqi - UPSUP
Ilir Dugolli - Instituti "KIPRED"
Mimoza Ibrani - Fakulteti i F. I. K-ut.
Blerim Dugolli - UPSK

Komisioni i studimeve është komision i përhershëm i Senati të UP-së i cili vepron sipas dispozitave të Statuti të UP-së. Ky komision shqyrton kurrikulat para se t'ia dërgojë Senatit për miratim.

Reagim ndaj shkrimit "A i kontribuon procesit të statusit të Kosovës debate për shamitë islame? , të botuar në gazetën "Express" më 3 tetor 2007

Në Kosovë unë nuk kam parë femra me ferexhe...

Si duket, dikush është shumë i interesuar që myslimanët të dalin në protesta! Grupe të interesit (dhe ata që punojnë për Serbinë) ishin dhe sigurisht që janë shumë të interesuara që myslimanët të protestonin ... Ata janë të interesuar që rrugët e Kryeqytetit t'ishin të stërmbushura, e pastaj ata të bëjnë dasmë brenda tyre. Por jo, edhe këtë provokim myslimanët e përpinë dhe nuk protestuan

Muhamed Jusufi-KAJOLLI

Ajo që më shtyri të reagoj këtë artikull nuk ishte titulli, por brendia tekstit, dhe vetë autori. Nëse do të debatonim rreth këtij titulli, them se është i qëlluar. Kështu mendoj edhe unë, nuk do të duhej pikërisht tani në këtë kohë shumë delikate për Kosovën të hapeshin tema të tilla. Por ja, edhe ky shembulli ynë flet se ne jemi shumë hapa mbrapa trendëve dhe ndodhive që sillen rreth nesh në regjionin tonë. Shkaku i ndodhive që quan në debat e rreth këtij titulli, nuk do ta fajësoj askënd tjetër përveç Ministrit të Arsimit. Duke qenë figurë politike, ai nuk do të guxonte aspak ta bënte një gafë të tillë, sidomos në këtë kohë. Nga intervista e KTV-së u vërejt qartë se ai nuk meriton të jetë drejtor shkolle e lëre më Ministër! Por këto gafa nuk po kanë të ndalur. Dikush duhet ti paguaj ato, dhe s'do mend se të gjitha këto rëndohen në kurriz të popullit (në këtë rast komunitetit mysliman të Kosovës).

Nëse Ministri Arsimit ka sjellë një vendim kokë në vete, mendoj se është shumë i pa informuar, e nëse ka dëgjuar këshillat e ndokujt tjetër, them se u ka shërbyer serbëve.

Hapja e debateve fetare në këtë kohë delikate për Kosovën, nuk favorizon askënd tjetër përveç politikës serbe. Mendoj se, shumica dërmuese është dakord me mendimin se mbrojtja e vetme e Serbisë për ta mbajtur Kosovën akoma të robëruar është elementi islam. Atëherë pse të hapim tema të tilla dhe t'i provokojmë besimtarët mysliman të Kosovës. A nuk ju duket se myslimanët janë duke toleruar aq sa nuk bën. Kush i nxjerr këto vendime në dëm të myslimanëve në Kosovë, mos vallë këto provokime dalin nga komuniteti mysliman, apo nga zyrat e institucioneve tona.

Fillimisht ish-presidenti i Kosovës, i ndjeri Ibrahim Rugova kishte menduar se Prishtinës i "duhet një katedrale". Krejt vonë u bë kërkesa zyrtare nga komuniteti katolik i Kosovës në zyrat e komunës së Prishtinës. Kisha jo që nuk e ka përmbushur detyrimin e saj kundrejt marrëveshjes së Komunës për ndërtimin e shkollës "Xhevdet Doda", por ajo filloi ndërtimin e Katedrales në kohën kur bashkësia ndërkombëtare kishte vendosur që për 120 ditë të tjera të negociohet për Kosovën.

Si duket, dikush është shumë i interesuar që myslimanët të dalin në protesta! Grupe të interesit (dhe ata që punojnë për Serbinë), ishin dhe sigurisht që janë shumë të interesuara që myslimanët të protestonin kundër kësaj katedrale politike. Ata janë të interesuar që rrugët e Kryeqytetit t'ishin të stërmbushura, e pastaj ata të bëjnë dasmë brenda tyre. Por jo, edhe këtë provokim myslimanët e përpinë dhe nuk protestuan, edhe pse është një e drejtë e tyre për të protestuar. Në esencë askush prej myslimanëve nuk do të duhej t'ishte kundër kishave ose katedraleve, por për kisha dhe katedrale politike po, kanë plotësisht të drejtë të protestojnë. Në kohën kur u vërejt se askush prej myslimanëve nuk protestoi kundër katedrales, vjen provokimi tjetër. Vendimi prej drejtorit të shkollës "Hamzë Jashari" në Skenderaj të ndalojë nxënëset të futen në shkolla me mbulesë.

Kujt i nevojiten këto protesta? Serbëve. Ata (serbët dhe proserbët) shëtisin nëpër rrugët e Kosovës dhe këto ditë të 120 ditëshit të negociatave shtesë presin nga ne vetëm një protestë të vogël, e prej saj të shndërrojnë drama të dhembshme. E nëse kjo do të ndodhte, atëherë pa dyshim se fajin do ta kërkonin tek komunitetit mysliman.

Me një fjalë kërkoj që komuniteti mysliman në Kosovë të mos provokohet edhe nga vëllezërit tanë katolik (sikur rasti i këtij shkrimi nga Ndue Ukaj), sepse mjaft jemi duke u provokuar nga ish-komunistët me nostalgji sllave.

I dashuri Ndue,

Para se të filloja këtë reagim, hyra në internet dhe mësova që ju jetoni në Suedi dhe jeni "publicist". Duke qenë se jeni katolik dhe jeni jashtë realitetit ku ne përballemi, nuk ju takon juve të kërkoni se çka duhet të bëjnë shqiptarët mysliman. Kur ju shpreheni se: "ferexheja është një goditje kundër kulturës shqiptare, kundër identitetit shqiptar" them se ju nuk e emërtoni saktë mbulesën e femrave. Ferexhe është diçka tjetër, në Kosovë unë personalisht nuk kam parë femra me ferexhe, ndërsa me mbulesa po. Ndërsa sa i përket fjalës identitet nuk do të debatoj me ju rreth këtij termi, sepse nga formulimi i fjalisë suaj kuptoj se ju nuk e kuptoni këtë fjalë. Ndërsa sa i përket shkrimeve dhe shkrimtarët të cilët i ke theksuar në këtë artikull për të cilët me shumë mburrje i ke formuluar fjalitë, gjithashtu ju them se, shqiptarët ishin shqiptarë edhe para ardhjes së turqve (myslimanëve), por ata nuk dinin të shkruanin e as të lexonin shqip. Kjo, ndodhi vetëm atëherë kur shqiptarët u ambientuan me mentalitetin e qytetëruar. Këtë mundësi ia dhanë myslimanët shqiptarëve, pa marrë parasysh se ata që shkruan ishin të krishterë. Librat e tilla nuk kanë mundur të ekzistonin sikur të ndiqeshin nga myslimanët, por falë tolerancës dhe kulturës së myslimanëve ne e kemi Mesharin dhe...


Nëse ti i quan **hordhi** myslimanët flet për brendinë tënde të shëmtuar, ose për dituri rrugaçësh sepse përqindja dërmuese e shqiptarëve i përket identitetit të cilin t'i i quan hordhi. Si mund t'i quaj unë sot amerikanët ose evropianët e perëndimit hordhi, kur këta na çliruan nga robërimi dhe hegjemonizmi serb. Atëherë më trego se ku mbeti tek ti vëllazëria shqiptare. Mos vallë ju mendoni se vetëm të krishterët janë shqiptarë..., apo sipas logjikës tënde shqiptarë mund të njihen edhe ata që mbajnë emra myslimanësh por që në esencë janë ateistë ose komunistë etj. Ndërsa shqiptarët mysliman që tregojnë devotshmëri në besimin e tyre i trajton hordhi!?

Meqenëse je njëfarë publicisti, iu kisha lutur që mos publikoni shkrime pa u konsultuar me persona të tjerë të redaksisë suaj, ose më gjerë, sepse vërej që nuk jeni në gjendje ta ndani dot shapin prej sheqerit.

Bastoremania...

BASTORET, LOJËRAT E "FATIT", BIXHOZI DHE GJYKIMI NDAJ TYRE

Fitim FLUGAJ



opullata jonë e pasluftës, është duke përjetuar një krizë të përgjithshme; ekonomike, politike, sociale, edukative, kulturore dhe morale-etike.
Është fakt se në të gjitha ato shoqëri në të cilat dështon sistemi shoqëror-politik, paraqiten shumë dukuri negative, siç janë; kafenetë e shumta, prostitucioni, klubet e natës, kinematë porno, veshjet ekstravagante, droga, alkoolizmi, kazinotë, analfabetizmi edukativ, arsimi i dobët, bixhozi dhe shumë e shumë dukuri tjera negative.
Të gjitha këto, për fat të keq i kemi të pranishme edhe në Kosovë.
Këto dukuri negative, janë si rezultat i një boshllëku institucional dhe ligjor dhe situata që është krijuar nga status-kuoja dhe vetëdija e ulët e qeveritarëve tonë. Që të dyja këto shkaqe po e mbajnë peng Kosovën dhe u shkon për shtati atyre që ia duan të zezën Kosovës dhe popullit shqiptar.

Efekti i lojërave të "Fatit të Zi"...

Të ashtuquajturat "lojërat e fatit", lirisht mund t'i quajmë lojërat e fatit të zi, sepse këto lojëra sjellin fat të zi për shoqërinë.
Efekti i këtyre lojërave është shumë negativ dhe pas vete len pasoja të rënda, shkatërron individë, familje dhe shoqëri. Në vend të punës dhe aktivitetit, këto lojëra sjellin papunësi dhe përtaci, krijojnë parazitë të shumtë, shkatërrojnë vullnetin për punë...
Duke marrë parasysh pasojat e rënda që sjellin këto, lojëra që pasurojnë individët dhe varfërojnë masën, atëherë shoqëria më të gjitha strukturat, qofshin ato qeveritare dhe jo qeveritare, duhet të bëjë çmos për ndalimin e tyre. Shpeshherë shohim familje dhe shtëpi që janë mbyllur. Fjala popullore thotë: "Puno kot e mos rri kot", por rinia jonë për fat të keq nuk po i përmbahet kësaj maksime, dhe në vend që të bëjë përpjekje për të gjetur alternativa të mirëfillta, të cilat i sigurojnë vetvetes dhe vendit një të ardhme të sigurt, ata e shpenzojnë kohën duke mbushur bastore.

Gjykimi islam ndaj lojërave të bixhozit

Feja Islame kërkon punë të zellshme dhe fitim të ndershëm. Pikërisht është kjo kërkesë, e cila e ndalon dhe parandalon bixhozin. Fitimi pa mund dhe pa angazhim e përpjekje është i ndaluar rreptësishtë (Haram).
Prandaj, duke marrë parasysh rëndësinë që i kushton feja Islame rendit të mirëfilltë shoqëror dhe interesit të vërtetë shoqëror dhe individual dhe pasojat e rënda që mund të sjellin këto lojëra, feja Islame i ndalon rreptësishtë këto lojëra.
Citati Kuranor është shumë i qartë, kur fletë për Bixhozin, në ajetin 90,91 dhe 92 të sures ''El-Maide'', i Madhërishmi Allah thotë: "O ju që besuat, s'ka dyshim se vera, bixhozi, idhujt dhe hedhja e shigjetës (për fall), janë vepra të ndyta nga shejtani. Pra, largohuni prej tyre që të jeni të shpëtuar.
Shejtani nuk dëshiron tjetër, përveç se nëpërmjet verës dhe bixhozit të hedhë armiqësi mes jush, t'ju pengojë nga të përmendurit Zot, dhe t'ju largojë nga namazi. Pra, a po i jepni fund (alkoolit e bixhozit)?
Bindjuni All-llahut dhe bindjuni të dërguarit e kini kujdes (mos kundërshtoni)".
Edhe i Dërguari s.a.v.s., këshillon që besimtari të punojë me nderë dhe të fitoj me nderë, dhe e mallkon bixhozin e të gjitha llojeve ashtu siç e ka mallkuar Zoti fuqiplotë në ajetet e sipërshënuara.
Nga këto ajete Kuranore arrijmë të kuptojmë shumë nëse dëshirojmë të kuptojmë. Përndryshe, ai i cili e arsyeton vetveten dhe vepron e luan me bastore le ta dijë se atë e pret dënimi i Krijuesit të Madhërishëm.
E ne në Kosovë, po na prinë dështimi për çdo ditë dhe po sjellim mallkim për vetveten me bastoret që kanë mbushë çdo qoshe të Kosovës.

Historia e bixhozit

Historia e bixhozit fillon në shoqërinë kineze. Mendohet se e para nga lojërat e bixhozit është loja e dominove, e cila figuron në vitin 969 p.e.r. te imperatori Mutcung, i cili e kishte promovuar këtë lojë me gruan e tij me rastin e vitit të ri. Egjiptianët në shekullin XII dhe XIII e kanë plasuar një lojë që është e ngjashme me lojën e letrave. Ndërsa në shekullin e XVI persianët luanin lojën e "Ganjifes" dhe "Letrave të thesarit". Tavolina e "Ginjafës" konsistohej prej 96 letrave. Më vonë persianët luanin një lojë të quajtur "As Nas" me 25 letra.
Francezët këtë lojë e quanin "Poque" (Poker), ndërsa gjermanët e quanin "Pochen" (Poshen) dhe ishte e popullarizuar në Gjermani në shekullin e XVII dhe XVIII. Kjo lojë në Spanjë ishte e zhvilluar në shekullin e XVI (1526), me emrin "Primero" dhe konsiderohet si "Nëna e lojërave të bixhozit" e cila luhet deri në ditët tona.
Në Amerikë lojërat e bixhozit u bartën nga kolonizatorët francezë në shekullin XVIII.
Në vitin 1834, Xhonatan H.Grin referon për rolin e fitimit të madh që i mundësoi loja e bixhozit me emrin "Loja e mbrojtjes" anijeve turistike që lundronin nëpër lumin Misisipi.
Në vitin 1875 merr fund influenca evropiane në lojërat amerikane, pasi amerikanët e krijojnë një lojë me forma të veçanta e njohur me emrin JOKER (xhoker).
Në botën arabe, lojërat e bixhozit figurojnë mjaft herët, kjo vërtetohet edhe nga fakti se Kur'ani në mënyrë të posaçme flet për këto lojëra.
Tani në botë kjo lojë është shumë e përhapur. Por, më të përhapura tani janë bërë lojërat e fatit që lirisht mund të themi se janë lojërat e "Fatit të Zi".

Postmodernja te shqiptarët

ÇELËSI QË HAPI KUTINË E PANDORËS



Avni AVDIU

Është menduar dhe është pritur se pas çlirimit nga thundra serbe, shqiptarët e Kosovës të etur për mëmën Shqipëri, do të ngarendnin pas saj, do të lidheshin si mishi me thoin dhe do të këmbenin e shkëmbenin shumë gjëra në të gjitha sferat e jetës, nga ekonomia e gjerë të kultura. Por, mjerisht nuk ndodhi kështu.
Në shtator të 2006, disa gazeta botuan shkrimin e ish-kryeministrit të Shqipërisë Aleksandër Meks-it, në të cilin, ai duke iu referuar marrëdhënieve Shqipëri-Kosovë, thotë: "Shumëkush priste që me çlirimin e Kosovës nga ndërhyrja e NATO-s dhe lufta e UÇK-së dhe me vendosjen e një administrate ndërkombëtare, krahas shkëputjes de facto nga Serbia, marrëdhëniet ekonomike, njerëzore, kulturore e politike, do të shtoheshin ndjeshëm. Kjo çuditërisht nuk po ndodh, me ritmet dhe nivele e dëshiruara..., nuk kemi bashkëpunim e bashkërendim në kulturë, informacion e art, aq më tepër, nuk ka si të ndodhë ndryshe as në veprimtaritë politike e ekonomike, të kuptuara këto si veprimtari ndërshtetërore".
Tani marrëdhëniet e shqiptarëve të Shqipërisë, dhe të atyre jashtë kufijve administrativë të saj, nuk kanë më asnjë pengesë, përpos atyre që vetë ne i krijojmë së bashku subjektivisht.
Nga ana tjetër - krahas kësaj, në pah dolën tendenca që këto raporte të ftohen edhe më tej.
I ftuar nga "Media Art" më 1 dhe 2 prill 2006, qëndroi në Tiranë këngëtari serbo-kroat Goran Bregoviq, bashkë me grupin e tij. Në ditën e rrenave, ai këndoi (vërtet) në Pallatin e Kongreseve në Tiranë. Orkestra prej 42 anëtarësh, e veshur në veshje kombëtare serbe, u përshëndet me duartrokitje të gjata. Thuhej se në Shqipëri ajo ishte "java e Serbisë" dhe se shumë këngëtarë shqiptarë, përfshirë këtu edhe publikun (pjesëmarrësit) në emisionin "TOP SHOW" të udhëhequr nga Alban Dudushi në TV "TOP CHANNEL" me ëndje kanë kënduar këngë serbe në emision!
Organizatorët ishin të mendimit se muzika nuk njeh kufij, dhe se duhet ndarë politika nga arti, sepse tekefundit arti nuk njeh kufi, ksenofobi dhe politizime.
Mirëpo pjesa dërrmuese e shqiptarëve të Kosovës, ishin të indinjuar nga ky gjest, që për ta ishte provokativ. Dhe kulminacioni i pezmit arriti pikërisht me faktin se ky këngëtar u nderua në mënyrë institucionale, duke iu dhënë nga kryebashkiaku i kryeqytetit Edi Rama 'çelësi i Tiranës'. Reagimet në shtyp dhe në faqet e internetit ishin nga më të ndryshmet. Disa nga to theksonin se "turpi s'ka brirë" ; "në Shqipëri ndoshta do të thonë se me këtë koncert kanë dëshmuar se 'nuk janë pjesë e intrigave dhe politikave që dogjën Ballkanin (edhe pse në vitet e 90-ta Shqipëria e dogji veten); se kanë kulturë kosmopolite dhe se shqiptarët e Kosovës jetojnë ende në të kaluarën"! Por, në fakt, ata kanë dëshmuar ndjenjën e inferioritetit dhe injorancës; Ai ishte mik i Karaxhiqit, mik i propaganduesve të politikës së Milosheviqit; ai ishte kundër sulmeve ajrore të NATO-s, kundër humanizmit"; Qytetar nderi një serb???!!! Obobo ky është kulmi; Deri kur duhet të shtiremi me kurva? Ky kurvërillëku, i ka kushtuar gjithmonë popullit shqiptar".
Pa hyrë në detaje të reagimeve tjera, interesant tingëllon një krahasim që bën një polemizues tjetër në këtë debat, pro dhe kontra këtij koncerti. Ai pyet se "si do të kthehej një këngëtar shqiptar, po të merrte guximin për të kënduar në Beograd, do ta merrte çelësin e nderit, apo plumbin në ballë dhe a do të dalldiseshin serbët për të vallëzuar me këngë shqipe në zemër të Serbisë. Nderi duhet të jetë reciprok, përndryshe, konstaton ai, kur nderon e nuk të nderojnë e përbuz vetveten.
Beqë Cufaj analist i gazetës 'Koha Ditore', paradoksin 'Bregoviq' e vlerësoi si të panevojshëm për polarizime. Sipas tij kosovarët u tërbuan, u tranuan, e u çmendën, pse një Tiranë pret një Goran Bregoviq. Thua se ky Bregoviqi ia kishte mësy me kallashnikov nga fushëbetejat serbo-çetnike të Bosnjës drejt kryeqytetit shqiptar për të masakruar dhe vrarë. Dhe jo për të bërë muzikë...Në rregull, duhet të pranojmë: te kosovarët Bregoviqi është dëgjuar ose që të jem edhe më i saktë, është pranuar si 'babai' dhe mësuesi i rokerëve kosovarë deri në fazën e ardhjes së Milloshevigit në pushtet. Dhe pas kësaj faze ai nuk është dëgjuar publikisht, por gjithsesi privatisht. Në dhomat e tyre të gjumit apo ndejës!".

E vërtetë e hidhur e cila si e tillë dhemb, por duhet të thuhet...

Se muzika serbe dëgjohet edhe më tej nga disa shqiptarë, tani për tani akoma mund të jetë temë tabu, por megjithatë është fakt se ekzistojnë edhe jashtë Shqipërisë nostalgjikë të muzikës serbe, pa marrë parasysh se kush është interpretues i saj, një serb i thjeshtë a një grua e një ish krimineli.
Në qershor të 2005, gazetat në Maqedoni e Kosovë njoftonin se qindra kosovarë e shqiptarë të Maqedonisë u nxehën pas gruas së Arkanit. Thuhej gjithashtu se këngëtarja e turbofolkut serb Ceca Razhnjatoviq, gruaja e kryekriminelit Zharko Razhnjatoviq – Arkan në koncertin e saj në Shkup, ka joshur edhe shumë adhurues të saj që kishin ardhur nga Kosova. Njoftohej se qindra bileta ishin blerë nga shqiptarë nëpër pikat e shitjes nëpër Shkup, ndërsa qindra të tjera janë shitur në treg të zi, duke arritur çmimin deri në 30 euro. Disa taksistë të Shkupit bënin të ditur se atë ditë kanë pasur shumë më shumë punë në destinacionet kufi – Shkup dhe anasjelltas. Praninë në koncertin e Cecës e kishin konfirmuar edhe shumë të rinj shqiptarë nga Shkupi dhe Tetova.
Po ashtu, në një raport tjetër në gusht të 2006, në "Infopress", me titull: "Dragana në SHPK", thuhej se në lokalet e Shërbimit Policor të Kosovës zëri i këngëtares serbe Dragan Mirkoviq dëgjohet mjaft lartë. Zëdhënësja e policisë Sabrie Kamberi i kishte deklaruar gazetarit se "...muzika është muzikë, qoftë edhe ajo serbe dhe nuk na pengon".
E vërtetë e hidhur, ama e vërtetë, e cila si e tillë dhemb, por duhet të thuhet e të dihet.
Shqiptarët e Kosovës si duket më së tepërmi ishin të revoltuar, se koncerti i Bregoviqit në Tiranë, mori kahje institucionale dhe ata ishin të indinjuar pikërisht në prefektin e kryeqendrës shqiptare, i cili nderoi këngëtarin serb.
Institucionet e Kosovës plot dy muaj e gjysmë ia përgatitën një 'surprizë hakmarrjeje' kryebashkiakut të Tiranës Edi Ramës të cilit iu 'kthye bumerang'. Komuna e Prishtinës dhe ajo e Gjakovës, shpallën oponentin e tij politik, kryeministrin Sali Berisha "qytetar nderi", duke ia dhuruar çelësin e këtyre komunave. I ftuar nga dy komunat e Kosovës, kryeministri shqiptar shfrytëzoi rastin, që gjatë vizitës së tij treditore (prej 15 qershorit 2006...), të bëjë edhe disa vizita në qendra tjera të Kosovës.

Në prag të fushatës zgjedhore në Kosovë

EKONOMIA NË PROGRAMET ZGJEDHORE TË SUBJEKTEVE POLITIKE

Përderisa në zgjedhjet e kaluara, listës së premtimeve të partive politike i prinin ofertat për zgjidhjen e problemeve madhore të vendit, këtë fushatë parazgjedhore për dallim nga të kaluarat, do ta karakterizojë orientimi i subjekteve politike në ofertat e tyre që ndërlidhen me zgjedhjen e problemeve esenciale, që do të siguronin një jetë normale për çdo qytetarë të Kosovës



Sead UJKANI

Taktimi i datës së mbajtjes së zgjedhjeve në Kosovë, në një formë ka shënuar edhe fillimin e fushatës parazgjedhore, rezultat i së cilës janë premtimet e përsëritura lidhur me progresin që do të arrinte Kosova pas këtyre zgjedhjeve nëse fitues do të dilte njëri apo tjetri subjekt politik përkatës.

Përderisa në zgjedhjet e kaluara, listës së premtimeve të partive politike i prinin ofertat për zgjidhjen e problemeve madhore të vendit, këtë fushatë parazgjedhore për dallim nga të kaluarat do ta karakterizojë orientimi i subjekteve politike në ofertat e tyre që ndërlidhen me zgjedhjen e problemeve esenciale, që do të siguronin një jetë normale për çdo qytetarë të Kosovës.

Në këtë drejtim, në këtë fushatë parazgjedhore, elektorati do ta konsumojë më pak nocionin "pavarësi" ndërsa, premtimet për përmirësimin e standardeve të jetesës, përmirësimi i shëndetësisë, sistemit arsimor dhe mirëqenies sociale do të jenë pikat themelore në listën e gjerë të premtimeve të subjekteve politike.

Natyrisht në tërë këtë proces, finalizimi i zgjidhjes së statusit të vendit tonë do të ketë rëndësinë e vet ndërsa, rol thelbësor do të luajë hartimi i strategjisë për zhvillim ekonomik të mirëfilltë dhe rimëkëmbje të vendit.

Duke marrë parasysh gjendjen e përgjithshme ekonomike e sociale të vendit tonë, si dhe rëndësinë e një sistemi të qëndrueshëm ekonomik për zhvillimin e tërësishëm të një vendi, ofertat konkrete për një ekonomi të mirëfilltë do të jenë bazë e programeve zgjedhore në të cilat do të fokusohen partitë politike.

Evitimi i krizave të thella ekonomike, hartimi i platformave me koncepte të qarta për nxitjen e investimeve të huaja, funksionimi i tregut të lirë duke vepruar sipas parimit të ofertës dhe kërkesës, zhvillimi i një sistemi të mirëfilltë ligjor, forcimi i strukturës së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, stimulimet e prodhimeve vendore, do të ishin elementet kryesore në të cilat do të duhej përqendruar subjektet tona politike në ofertat e tyre për zhvillim ekonomik. Pastaj, një angazhim i denjë në këtë drejtim do të kishte si rezultat një përformancë më të mirë të ekonomisë së Kosovës drejt stabilitetit dhe prosperitetit afatgjatë të saj.

Duke u mbështetur në punën që po bëhet ditëve të fundit për përmirësimin e infrastrukturës rrugore, renovimin e ndërtesave, premtimet e drejtuesve të subjekteve politike për zgjidhje të statusit të të papunëve respektivisht për një jetë më të mirë për çdo qytetarë, elektoratit i mbetet të shpresoj, se pas zgjedhjeve do të këtë ndryshime pozitive, progres e lulëzim ekonomik, e jo që edhe premtimet e kësaj fushate parazgjedhore të futen e arkivin e retorikës dominuese të partive politike, sikur edhe në të gjitha fushatat e kaluara për zgjedhje lokale e qendrore.



Vazhdon shitblerja e pronave dhe ndërtimi i banesave në "Lagjen e Boshnjakëve"

A po e përkrah UNMIK-u spastrim

Ndonëse në vitet e para pas lufte "Lagja e Boshnjakëve", e banuar me shumicë shqiptare, është konsideruar simbol i qendrës dhe vijë lidhëse e dy anëve të Mitrovicës, dalëngadalë ajo po shndërrohet në një terren të banuar kryesisht me pjesëtarë të komunitetit serb, të cilët mbizotërojnë në atë pjesë të qytetit

Florije ADEMI

MITROVICË, TETOR

Mosangazhimi i institucioneve, duke u nisur nga ato lokale e deri te ato qendrore për pjesën veriore të Mitrovicës së ndarë në dysh, dhe ofertat me çmime të larta nga Qeveria e Serbisë për patundshmëritë joserbe, ka rezultuar me shpërnguljen e shumë shqiptarëve nga ajo pjesë e qytetit dhe ndërrimin e strukturës etnike atje.

Ndonëse në vitet e para pas lufte "Lagja e Boshnjakëve" e banuar me shumicë shqiptare, është konsideruar simbol i qendrës dhe vijë lidhëse e dy anëve të Mitrovicës, dalëngadalë ajo po shndërrohet në një terren të banuar kryesisht me pjesëtarë të komunitetit serb të cilët mbizotërojnë në atë pjesë të qytetit.

"Shitja e pronave shqiptare dhe joserbe në lagje ka filluar qysh në vitin 2000, mirëpo asokohe kishte vetëm raste individuale, kështuqë nuk i kushtohej shumë rëndësi kësaj dukurie", thotë përfaqësuesi i lagjes Adem Mripa.

Mirëpo, sipas tij gjatë muajve të fundit, vetëm në këtë lagje janë shitur rreth 30 shtëpi. Arsyet për shitje sipas tij paraségjithash janë ofertat e mira, por edhe frika e disa individëve, të cilët ndihen të rrezikuar.

"Çmimet janë jashtëzakonisht të larta, varësisht nga madhësia e objektit, por mendoj se shtëpitë e mëdha dy-tri katërshe, paguhen 200-300 mijë euro. Praktikisht familja që e shet pronën me ato të holla mund të blej banesa në jug për secilin anëtar të familjes", thekson Mripa.

Ai shton, se ky mjedis është i varfër, prandaj njerëzit mashtrohen për një shumë të madhe parash dhe shesin pronat e tyre duke menduar se janë në fitim.

"Unë mendoj se të gjithë janë në humbje, ngase interesi ynë është që ky mjedis të jetë multietnik siç ka qenë përherë Mitrovica. Dëshiroj që të mbetet kështu, e jo të shkojmë kah krijimi i një mjedisi i pastër etnik".

Provokimet nga ana e ekstremistëve



Nexhat Uglanin: Ndarjen e Kosovës po edhe UNMIK-u

serbë, duke shkaktuar frikë dhe pasiguri të shqiptarët, sipas Mripës është arsye e dytë që po i shtyn ata t'i shesin pronat e tyre dhe ta braktisin veriun.

Ai thotë, se ka pas disa raste të sulmeve mbi shqiptarët dhe joserbët, për të cilat raste nuk është ndërmarrë asgjë, pastaj hedhjen e bombës në oborrin e shtëpisë së tij, duke konsideruar se kjo është bërë me qëllim që ta përzënë nga ai vend. Megjithatë, ai është i vendosur të qëndroj në shtëpinë e tij edhe nëse mbetet i vetmi shqiptar në veri.



Adem Mripa: Shtija e pronave shqiptare dhe joserbe në lagje ka filluar qysh në vitin 2000...

Uglanin: Ndarjen e Kosovës po e përkrah edhe UNMIK-u

Nexhat Uglanin, banorë i kësaj lagje, njëherit përfaqësues i komunitetit boshnjak, pohon se është në dijeni se janë duke u zhvilluar biseda edhe për shitjen e pronave të tjera, por çdo gjë sipas tij është duke shkuar në mënyrë të fshehtë.

Ai shprehet i mllefosur në komshinjtë e tij që po i shesin pronat e tyre dhe me këto veprime kanë bërë që sot shqiptarët dhe boshnjakët të mbesin pakicë në këtë lagje.

Shitjen e pronave ai e vlerëson si shitje kombëtare dhe kontribut për ndarjen e

...in etnik të veriut të Mitrovicës?

Kosovës.
"Nuk e kam ditur se kam kojshi të tillë, që i kontribuojnë ndarjes së Kosovës" thekson Uglanin dhe shton se, ndarjen e Kosovës po e përkrah edhe UNMIK-u, duke dhënë leje për ndërtimin e objekteve shqiptare në vendbanime multietnike.
"Ne kemi bisedu disa herë me administratorin, Gerad Galluci dhe ai na ka thënë se, nuk do të lejoj më ndërtimin e objekteve shumëkatësh në këtë lagje, por dy objekte të tilla kanë filluar tani të ndërtohen, derisa pesë të tjera kanë përfunduar" pohon Uglanin. Ai është i bindur se nëse vazhdohet kështu veriu i Mitrovicës do të jetë etnikisht i pastër.
Në anën tjetër, administratori rajonal i UNMIK-ut në Mitrovicë, Gerard Galluci thotë se nuk do të ketë ndarje të Kosovës, sepse pala ndërkombëtare nuk do të lejoj një gjë të tillë. Çështjen e blerjes dhe shitjes së pronave ai e konsideron si të drejtë individuale të çdo personi.
Derisa Mripa shprehet i sigurt, se pas kësaj dukurie qëndron Qeveria e Serbisë, dhe se qëllimi i saj është që të bëjë spastrim etnik në këtë lagje, Galluc pohon se nuk e di se nga vijnë ato mjete, por që sipas tij ato prona i kanë blerë individët dhe derisa shitësit nuk i kanë shit pronat e tyre nën presion dhe me dhunë atëherë ajo është e drejtë e tyre.
I pyetur se sa ndihet fajtorë UNMIK-u që ka dhënë leje për ndërtimin e objekteve shumëkatëshe në atë lagje, që ka rezultuar me shpërnguljen e dhjetëra familjeve shqiptare për shkak të pasigurisë, Galluci tha se nuk ndihet aspak fajtorë. Sipas tij pasiguria është vetëm në mendjen e njeriut, sepse në veri punojnë 140 policë që bëjnë sigurinë e të gjithë banorëve atje.
Megjithatë ai ka pranuar se deri më tani nuk është zgjidhur asnjë rast i përleshjeve ndëretnike në Mitrovicë, sikurse që nuk janë zgjidhur as aktet tjera kriminale në tërë Kosovën, duke mos dashur të thotë se ku qëndron faji për këtë.
Galluci është shprehur i sigurt se ndërtimi i atyre objekteve shumëkatëshe atje, nuk është arsye për shpërnguljen e popullatës shqiptare.



Kuvendi komunal ndihet i pafuqishëm

Në anën tjetër, zëdhënësi i Kuvendit Komunal të Mitrovicës, Hysni Syla thotë se ende nuk dihet saktësisht se sa shtëpi dhe banesa janë shitur në pjesën veriore të qytetit, për shkak se sipas tij është shumë vështirë të arrihet deri te të dhënat e sakta.
"Ka shumë raste kur flitet se është shitur kjo apo ajo shtëpi, por pronarët e këtyre objekteve nuk pranojnë se i kanë shitur ato. Pastaj edhe kontratat po bëhen nëpër gjykatat tjera e jo në Gjykatën Komunale legjitime, me përjashtim të disa rasteve, poashtu shpeshherë raportimet e veprimtarëve në lagjet veriore nuk kanë dalë të sakta, kështuqë KK pa fakte nuk mund të manipulojë me shifra rreth shitjes se atyre pronave", thekson Syla.
I pyetur se çka ka bërë Kuvendi Komunal i Mitrovicës për ndalimin e kësaj dukurie, zëdhënësi Syla thotë se Kuvendi i Komunës dhe udhëheqja e saj kanë debatuar për këtë fenomen, kanë marrë vendime përkatëse, kryesisht apele për ndihmë nga institucionet më të larta të vendit për të ndërpre këtë fenomen, por konkretisht nuk ka pas mundësi të bëjë diçka më tepër.
Sipas tij, drejtuesit e pushtetit lokal kanë kërkuar edhe nga UNMIK-u që të mos lejoj ndërtimet e banesave në mjediset ku ato shkaktojnë shqetësime, ngrisin tensione, por UNMIK-u ka vazhduar të lëshojë leje, ndonëse kjo ka shkaktuar ndryshimin e strukturës etnike, natyrisht në dëm të shqiptarëve, gjë që është e papranueshme.
Syla përmend disa ndihma të KK-së për banorët e veriut të zhvendosur në jug, siç është pagesa e rrymës, ujit, pako ushqimore etj, në mënyrë që të ndërpritet ky fenomen, ndonëse pranon se këto ndihma janë të pakta, por, siç shprehet ai kaq janë mundësitë e tyre. Sipas tij autoritetet komunale kanë kërkuar ndihmë në këtë drejtim nga niveli qendrorë, por asnjëherë nuk kanë marrë përgjigje nga ta.
Ndonëse, kjo dukuri kohën e fundit është zhvilluar më së shumti në "Lagjen e Boshnjakëve", gjatë dy viteve të fundit dhjetëra prona shqiptare janë shitur edhe në lagjet veriore "Kodra e minatorëve" dhe "7 shtatori", mirëpo tani atje vërehet një stagnim.

Të dhëna alarmante rreth ndotjes nga tymi dhe hiri i termocentraleve të Kosovës

JETA NËN TYMIN E TERMOCENTRALEVE QË PRODHOJNË KANCER

Sipas standardeve të BE-së, jashtë filtrave të oxhaqeve të termocentraleve lejohet të dalin rreth 50 miligramë metër kub hi, por në bazë të analizave që i ka bërë Instituti "Inkos", del se nga blloqet e termocentralit "Kosova A" dalin rreth 1500 miligramë, kurse nga blloqet e "Kosovës B" rreth 280 miligramë. Si pasojë e ndotjes së këtij niveli, të gjitha fshatarat e Dardhishtës vuajnë nga sëmundje të ndryshme të mushkërive, sidomos kancerit, dhe mjaft prej tyre kanë vdekur tashmë nga kjo sëmundje



Blerime AJETI

Të kërrusur nga pleqëria Mehreme Mexhuani, plaka 74-vjeçare nga fshati Dardhishtë, jeton që prej shumë vjetësh vetëm disa qindra metra larg pesë oxhaqeve të termocentralit "Kosova A". Burri, vjehrri dhe kunati i saj kanë vdekur të gjithë nga kanceri në mushkëri, si pasojë e ajrit të ndotur që kishin thithur nga këto oxhaqe. "Fabrika e territ", siç e quajnë Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK), përmes tymit vazhdon të prodhojë kancer për shëndetin e banorëve të Dardhishtës dhe fshatrave përreth.

Edhe vetë Mejremja, si pasojë e ajrit të ndotur, vuan nga një sëmundje e mushkërive dhe rregullisht përdor barna, sepse nuk ka mundësi të ngopet me ajër. "Na jena shumë keq ktu, me ni anë deponija e hinit a qysh po i thon, e ne tjetren anë e kemi termocentralin 'Kosova A'. Na kanë thanë shumë herë se do të na hjekin nga ky ferr, por hala po jetojna për me vdekë qitu", shprehet ajo, thellësisht e dëshpëruar me kushtet e jetesës. Sipas saj, jeta në fshatin Dardhishtë vështirësohet edhe më sidomos kur fryn veriu.

"Mua hala mjekët nuk më kanë thanë se kam kancer. Por, edhe neve të gjallëve do të na rrok qikjo smuje. Por, më vjen gjynah për qita të ri që janë tu jetu ktu...".

Banorët e Dardhishtës, mallkojnë pushtetarët...

Në këtë fshat shumica e banorëve vuajnë nga sëmundje të ndryshme, sidomos të mushkërive dhe vështirë është të gjesh ndonjë njeri të shëndoshë, i cili nuk ka probleme me frymëmarrje. Vesel Mexhuani, i cili jeton së bashku me familjen e tij afër termocentralit "Kosova A", pohon se ka vite që e kanë përcjellë problemet shëndetësore në mushkëri. Por, atë e mbante optimizmi se do të bëhet një ditë më mirë. Ai pohon se kohët e fundit kanë probleme me furnizim me ujë të pijes, ndërkohë që uji nga puset nuk përdoret fare, sepse është i kontaminuar. "Uji i pusit del i zi. Ndërsa, për të mbjellë diçka në oborr nuk bëhet fare, nga ndotja shumë e madhe që është bërë".



Banorët e Dardhishtës, mallkojnë pushtetarët që nuk janë kujdesur për ta për t'ua shpëtuar jetën nga ky ferr. Ata thonë se janë bërë shumë premtime për t'i zhvendosur në ndonjë vend tjetër, por kjo nuk është bërë kurrë.

Ndotja nga tymi ka "avulluar" edhe peshqit në lumin Sitnica

Dikur në lumin Sitnica, banorët e fshatit Dardhishtë dhe të fshatrave të Komunës së Kastriotit peshkonin vazhdimisht. Mirëpo, ka vite që për shkak të ndotjes së madhe, lumi ka mbetur edhe pa peshq. "Përpara krejt katunart dilshim e u knashim tu zan peshqi. Tash s'ka ma peshqi, rrin tanë ditën e sun e zen asnjë", thotë Vesel Mexhuani, të cilin nuk e brengos shumë mungesa e peshqve, sa rrezikimi i shëndetit të fëmijëve të tij dhe të bashkëfshatarëve të tij.

Mungesa e peshqve, sipas ekologut Behxhet Mustafa, është si pasojë e nivelit të lartë të ndotjes. "Tymi ka shkaktuar shumë pasoja në ambient. Sidomos në regjionin e KEK-ut, përreth ka shkaktuar tharjen e bimëve dhe zvogëlimin e jetëgjatësisë së tyre, madje ka ndikuar të ikin nga lumenjtë edhe peshqit", thekson Mustafa. Ambienti, sipas tij, mund të mbrohet me metoda të njohura ekologjike nëpërmjet gjelbërimit dhe izolimit të ndotjes.

"Nga kjo pikëpamje, Kosova trajtohet si një zonë e veçantë, sikur të funksiononin edhe fabrikat e tjera, ne vërtetë do të ishim

në një gjendje katastrofale ekologjike. Në bazë të hulumtimeve është vërtetuar se KEK-u gjithmonë ka shkaktuar ndotje dhe konsiderohet si ndotësi më i madh në Kosovë", thotë ai.
Mustafa thekson se ndotja e tillë e vazhdueshme do të lërë fshatrat për rreth termocentraleve te shkreta për sa i përket botës bimore. "Kjo gjendje dhe ky hi i cili po derdhet nga erërat e forta, pas disa vitesh do ta bëjë ambientin për rreth KEK-ut krejtësisht të shkretë".

Shifrat e ndotjes alarmante, KEK-u plotëson kushtet për t'u mbyllur

Shifrat e ndotjes së ambientit përreth termocentraleve të KEK-ut, sipas ekspertëve të ekologjisë janë tejet alarmante dhe paraqesin rrezik të përhershëm për shëndetin e banorëve. Zyrtarët e Ministrisë së Ambientit, kanë thënë se KEK-u vazhdimisht është alarmuar për rrezikun që shkakton pluhuri i termocentralit, si dhe kapacitetet e mëdha të ndotjes nga deponia e hirit. Mirëpo, sipas tyre, ata janë treguar të papërgjegjshëm ndaj këtij problemi. "Menaxherët e KEK-ut janë treguar krejtësisht të papërgjegjshëm dhe nuk kanë investuar sa duhet për ta zgjidhur problemin e ndotjes. Qeveria e Kosovës ka ndarë mjete për të investuar në filtrat të cilët do të zvogëlonin ndotjen e ambientit, por KEK-u i ka shpenzuar ato për riparime në blloqe", thotë sekretari i përhershëm i kësaj ministrie, Muhamet Aliu.
Mbyllja e KEK-ut, sipas tij, do të ishte zgjidhja më ideale për krijimin e një ambienti të pastër. "Realisht KEK-u i plotëson të gjitha kushtet për t'u mbyllur. Mirëpo, për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike, sidomos të krizës energjetike, ende duhet ta durojmë këtë gjendje", vlerëson Aliu. Sipas tij, po të mos linte Kosovën në terr, dhe të kishte alternative tjera të furnizimit me energji, mbyllja e KEK-ut do të bëhej me një vendim të ekzekutivit të vendit.
Për zyrtarët e KEK-ut, megjithëse kanë tejkaluar normat e parapara të BE-së, shifrat e ndotjes së ambientit janë në rënie dhe nuk janë alarmanete. Bexhet Shala, menaxher në departamentin e Mjedisit në KEK, deklaron se kohët e fundit ka rënie të ndotjes së ambientit. Sipas tij, me norma të lejuara të BE-së, jashtë filtrave të oxhaqeve të termocentraleve lejohet të dalin vetëm 50 miligramë hi për metër kub. Aktualisht nga oxhaqet e termocentralit "Kosova B", në bazë të analizave që janë bërë nga Instituti "Inkos", dalin rreth 280 miligramë kub hi, që do të thotë disa herë më shumë se normat e parapara të BE-së. Ndërkaq, jashtë filtrave të oxhaqeve të termocentralit "Kosova A" dalin rreth 1500 miligramë për metër kub. Bazuar në analizat e bëra sipas Shalës, rezulton se ndotja e ajrit nga hiri brenda në fshat, arrin në 815 miligramë për metër kub. Ndërkaq, sipas normave të BE-së, ndotja lejohet deri në 300 miligramë për metër kub.
Sipas të dhënave mjekësore të botuara tashmë, jo vetëm Dardhishta, por edhe banorët e komunës të Kastriotit vuajnë nga sëmundjet e kancerit të mushkërive për 30 për qind më shumë se pjesët e tjera të Kosovës.

Ndërtimi i TC "Kosova C" do ta ndotë edhe më shumë ambientin

Banorët e Dardhishtes shprehen se jeta nën tymin, të cilin e quajnë kancer, do të vështirësohet edhe më shumë nëse do të ndërtohet termocentrali i ri "Kosova C". Zërat për ndërtimin e këtij termocentrali tashmë duket se do të bëhen realitet, sidomos bazuar në deklaratat e ministrit të Energjetikës, Ethem Çeku.
Ambientalistët deklarojnë, se ndërtimi i këtij termocentrali është krejtësisht i papranueshëm, duke marrë parasysh shkallën ekzistuese të ndotjes së ambientit. "Paramendoni çfarë gjendje kemi tani. Po nëse ndërtohet edhe një termocentral, i cili medoemos do të shtojë shkallën e ndotjes, atëherë Kosova do të bëhet vend hiri", vlerëson ekologu Behxhet Mustafa.
Kundër ndërtimit të këtij termocentrali është shprehur edhe kryetari i Komunës së Kastriotit, Ismet Hashani. Ai ka deklaruar se gjendja e Kastriotit me rrethinë është tepër e vështirë për shkak të ndotjes së ambientit nga KEK-u. Ndërtimi i ndonjë termocentrali të ri, sipas tij, vetëm se do ta vështirësonte këtë gjendje dhe se përfundimisht do të shuante çdo mundësi për të vazhduar jetesën banorët e kësaj komune. "Ne jo vetëm që nuk e përkrahim ndërtimin e këtij termocentrali, por kërkojmë nga Qeveria e Kosovës që të ndërmarr të gjitha hapat e nevojshëm për të investuar në filtrat aktual të KEK-ut që të mos na sjellin vdekjen për së gjalli", deklaron Hashani.
Komunarët e Kastriotit, sipas tij, vazhdimisht kanë fajësuar KEK-un dhe qeveritarët të cilët kanë heshtur dhe nuk kanë bërë sa duhet për rregullimin e kushteve të jetesës për këta banorë. Mirëpo, zërat kundër si duket nuk do të dëgjohen nga qeveritarët, të cilët tashmë kanë vendosur të ndërtojnë termocentralin më të ri "Kosova C", i cili ende nuk dihet se kur do të dal në sipërfaqe.



Shifrat e ndotjes së ambientit përreth termocentraleve të KEK-ut, sipas ekspertëve të ekologjisë janë tejet alarmante

KONCEPTI KOEKZISTENCË NË ISLAM (I)

"Humaniteti ka humbur. Vallë ka mundësi t'i kundërvihemi barbarizmit dhe ta rikultivojmë atë që është njerëzore? A thua do të jetë e mundur ta shpëtojmë njerëzinë?"
Edgar Moren

Emine A. VEZAJ

Ndër çështjet gjithherë aktuale, si tek ne, ashtu edhe në qarqet botërore, është edhe tema e koekzistencës në rrafshin burimor dhe në atë teorik, ndërmjet Islamit dhe feve, ideologjive apo botëkuptimeve të tjera edhe në rrafshin praktik, historik, ndërmjet muslimanëve, krishterëve dhe feve apo ideologjive të tjera. Ky aktualitet, konsiston në faktin se shumë qarqe politike botërore, me anë të mekanizmave të veta, e shtrojnë këtë çështje në kontestin negativ, dhe si burime shfrytëzojnë pjesë kuranore të shkëputura nga tërësia, duke bërë nga Islami mostrum të llojit të vet, dhe veprat propagandistike, kryqtare e inkuzicionale.

Nga kjo, nuk është e lehtë të flasësh për një fe, e cila jo vetëm që është feja më pak e kuptuar nga të gjitha fetë tjera, por tani konsiderohet edhe si një rrjedhojë konflikti me pjesën tjetër të botës. Pra flitet për një fe, që assesi nuk ngërthen në vete elemente të dhunës dhe terrorit, madje në instancë të fundit edhe emërtimi i kësaj feje do të thotë, paqe.

Debati rreth karikaturave të Profetit Muhammed, vetëm se ka dhënë precedentin e guximit të atyre, që kanë shitur deri tani ilaçin helmues "të një përplasje qytetërimesh". Botimi i këtyre karikaturave në faqet e gazetës daneze "Jyllands-Posten", do të mund të pranohej se paskësh qenë fjala për një botim aksidental. Por, botimi i tyre nga shumë gazeta të tjera në Evropë, zbuloi se solidariteti në këtë rast nuk kishte të bënte me sulm të koncentruar dhe arrogant ndaj ndjenjave më të thella të muslimanëve.

Kësisoj, ky sulm i orkestruar në shumë gazeta, mori përmasat e një kryqëzate mediale, siç konstaton me të drejtë Dr. Milazim Krasniqi në librin "E vërteta e Islamit ndër Shqiptarë". Më tutje, për shembull edhe sulmet e 11 shtatorit, si dhe ngjarjet para dhe pas tij në Lindjen e Mesme, në Azinë e Mesme e në Kaukaz, u gjykuan në përgjithësi si lidhje terroriste. Sulmet terroriste të 11 shtatorit- 2001, kundër Qendrës Tregtare në Nju Jork, ishin kulminacion i një serie sulmesh kundër caqeve amerikane dhe aleatëve amerikanë në vende të ndryshme, përfshirë edhe vendet arabe. Nga këtu, mund të nxjerrim edhe faktin se, jo të gjithë janë shenjtorë ose muxhahid që të jenë të aftë të kontrollojnë zemërimin, pasionin apo egon e tyre, për më tepër mund të thuhet se, e gjithë kjo nuk është bazë e fesë Islame, por një praktikë strategjie luftarake që janë përdorur në luftërat fetare, ideologjike, nacionale e botërore për arritjen e objektivave në bazë të formulës dhe tipit makiavelist, "Qëllimi e arsyeton mjetin". Prandaj, në kontest të gjithë kësaj terrorizmi i përmendur i 11 shtatorit, mbetet i huaj për Islamin, si shpallje hyjnore.

Në një kumtesë të lexuar në konferencën rreth Islamit të mbajtur në Universitetin e Vanderbiltit në Nashville, me 11 mars 2006, Dr Habib Siddiqui, ka paraqitur ndër të tjera edhe këtë koment: "Ndërsa spektri i dhunës është bërë sot një fakt i jetës, prirja për të dënuar një traditë të tërë fetare për veprimet e paarsyeshme dhe të pakuptimta të një pakice është shumë e madhe. Por kjo është e gabuar. Nëse nuk mund të dënojmë të gjitha besimet për krimet e përkrahësve të tyre, nuk mund të kemi një grup të ndryshëm standardesh për muslimanët. Për shembull, nëse nuk mund ta dënojmë krishterimin për kolonizimin dhe masakrën e qytetarëve të paarmatosur në Jonestoën (Guyana) dhe Ëaco (SHBA), për vrasjet në Irlandë, Uganda, Haiti dhe Liberi, për spastrimin etnik në Bosnje, Kosovë, Çeçeni, Dagestan, Nagorno Karabaç dhe ishujt Mindanao (në Filipine) dhe gjenocidet në Kongo, Ruanda dhe ditët e sotme në Afganistan dhe Irak; nëse nuk mund të dënojmë judaizmin për krimet e grupit Rabbi Meir Kahane ose Baruch Goldstein, ose krimet e liderëve izraelitë – Sharonit, Olmertit, Netanjahut dhe të tjerëve – në Palestinën e pushtuar dhe në Liban; nëse nuk mund të dënojmë hinduizmin për vrasjen e MK Gandhit dhe masakrën e mijërave myslimanëve në Kashmir, Mumbai, Assam dhe Gujarat dhe vrasjet e budistëve singalezë në Sri Lankë; nëse nuk mund të dënojmë budistët për vrasjet në Kamboxhia ose masakrën e muslimanëve rohyngianë në Arakan (Mianmar), ose vrasjet e tamilëve në Sri Lanka dhe pakicave muslimane në Tailandë, atëherë nuk kemi asnjë të drejtë të dënojmë Islamin për sulmet e 11 shtatorit".

Në vazhdim po paraqesim disa nga aspektet, se çfarë proklamon Islami në raport të bashkëjetesës, a është besimi islam për një multikulturë dhe për një pluralizëm dhe cili ka qenë koncepti koekzistëncë në mesin e shqiptarëve në raport me besimet tjera në periudhën e Perandorisë Osmane.

Islami kundërshton racizmin

Duke u nisur nga ajeti kuranor i sures El-Huxhurat 13: "O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj dhe fise që të njiheni ndërmjet vete, e s'ka dyshim se tek Allahu më i ndërshmi ndër ju, është ai që më tepër është ruajtur (këqijat) e Allahu është shumë i dijshëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë", duket qartë se ky ajet kuranor hedh poshtë të gjitha supozimet dhe bindjet se Zoti është i njëanshëm ndaj një race apo një fisi të veçantë dhe se mëshira e Tij, është e kufizuar vetëm për një grup të caktuar.

Kuptimi i këtij ajeti është jashtëzakonisht i thellë, si çdo fjalë e Allahut, e këtu mund të theksojmë dy aspekte: e para, kjo thirrje u drejtohet të gjithë njerëzve pa diferencim dhe ndershmëria e tyre vërtetohet nga ruajtja e tyre prej të këqijave. E dyta, ky ajet dëshmon se të gjithë njerëzit në fakt kanë një prejardhje dhe janë të lidhur e të afërt njëri me tjetrin, dhe ndarjet në popuj e në fise janë bërë që ata të njihen më mirë mes vete.

Popujt janë produkt i vullnetit të Zotit. Zoti i ka krijuar popujt për t'u njohur

mes tyre. Po të dëshironte Zoti, të gjithë njerëzit do t'i kishte bërë arabë, por nuk i ka bërë ashtu, sepse ka dashur të krijoj pasuri më të madhe në këtë dynja, pasuri më të madhe kulturore, gjuhësore, etnike, demografike etj.

Studiuesi Ali Pajaziti në librin "Ese sociologjike", vëren se për të arritur deri te shoqëria e qëndrueshme duhet që të mbillet ideja për diversitet e dallueshmëri. "Për multikulturalitetin e multietnicitetin si pasuri e jo si mangësi, duhet kultivuar ndjenja për ngritjen e urave të jetesës me komshiun nën krahët e respektit të ndërsjellë, duhet kuptuar se njëtrajtësia dhe njëngjyrshmëria kanë kuptim vetëm në mesin e shumësisë së trajtave dhe ngjyrave. Gjuhët e shumta dhe dallimet racore, janë simbole hyjnore dhe lufta kundër tyre është luftë kundër natyrshmërisë", përfundon Pajaziti.

Me këto deklarata të thella të Kuranit, besimi Islam largon çdo mendim etnocentrik shekullor të epërsisë sipërfaqësore dhe fisnikërisë së veçantë të njerëzimit. Në besimin Islam predikohet vetëm bashkimi i njerëzve në një besim të drejt dhe këtë në besimin e pastër Islam.

Edhe në Hutben Lamtumirëse, që është mbajtur në kodrën e Arafatit nga Pejgamberi a.s, është proklamuar unifikimi i njerëzimit: "Gjithë njerëzimi janë nga Ademi dhe Hava, një arab nuk ka dallim ndaj joarabit, as një joarab nuk ka epërsi ndaj një arabi, gjithashtu një i bardhë nuk ka epërsi ndaj një njeriu më ngjyrë dhe as njeriu me ngjyrë nuk ka epërsi ndaj arabit, përveç në devotshmëri dhe vepra të mira".

Po ashtu, edhe monopolizimi është një mesazh i besimit Islam. Në besimin Islam qartë konfirmohen elemente të përbashkëta edhe me besimet tjera. Judaizmi dhe Krishterimi janë dy fe të cilat kanë liderë (pejgamberë), të cilët i besojnë që po ashtu janë të dërguar nga Allahu xh.sh. dhe që të dy janë pejgamberë edhe për besimtarët e besimit Islam, por që në besimin Islam pikëpamja është më ndryshe krahas bindjeve judaike ndaj Musaut dhe bindjeve krishtere ndaj Isaut a.s.

Sidoqoftë, përsëri besimi islam nuk ka mesazhe monopoliste gjë që dëshmon edhe kjo se të besosh disa pejgamber e të mohosh disa tjerë, që do të thotë, të mos i kushtosh vëmendje thirrjes hyjnore.

Përkundër gjithë kësaj, besimi Islam mirëpret diversitetin në çështjet e besimit dhe kjo është një shenjë e mëshirës së Krijuesit, dhe një shenjë për ata që mendojnë. Këtë, mund ta shohim edhe në ajetin në vijim ku Allahu xh.sh në suren "El-Maide"(48); pranon shumëllojshmërinë e ligjeve dhe bindjeve fetare. "...Për secilin prej jush, Ne caktuam ligj e program (të posaçëm në çështje të veprimit). Sikur të donte Allahu, do t'ju bënte një popull (në fe e sheriat), por deshi t'ju sprovojë në atë që iu dha juve, andaj ju (besimtarë) përpiquni për punë të mira. Kthimi i të gjithë juve është të Allahu, e Ai do t'ju njoftojë me atë që kundërshtoheshit". Po ashtu në këtë frymë koekzistence në mes feve dhe besimeve tjera gjejmë edhe tek letrat e Pejgamberit a.s dërguar të gjithë perandorëve.

Muhamedi a.s jepte këtë vizion për bashkëjetesë edhe në letrën që kishte dërguar Papës së Romës ku thuhet "Paqja qoftë mbi atë që i beson Allahut. Unë besoj se Isa/Jezusi (a.s), djali i Merjemes/Marisë ishte shpirt prej Allahut dhe fjalë e Ti. Allahu futi atë në Merjemen e devotshme. Unë i besoj Allahut, të gjitha librave të Tij. Ai ia ka shpallur Ibrahimit, Ismailit, Is'hakut, Jakubit, a.s. dhe pasardhësve të tyre. Unë gjithashtu, besojë në atë që Allahu i shpalli Musait, Isait, (a.s) dhe pejgambereve të tjerë. Në fe dhe besim nuk bëjmë ndonjë dallim në parimin e pejgambereve. Ne jemi musliman. Paqja qoftë mbi atë që e pason udhëzimin", (Letrat e Muhammedit a.s., Logos-A, Shkup, 2004).

Pra, Islami është pluralist dhe shumë tolerant edhe ndaj besimeve tjera dhe për këtë, është më i pranueshëm dhe më i logjikshëm për tu bërë pjesëtarë i saj, andaj, pikërisht ky është edhe njëri ndër faktorët më relevant që Islami është mirëpritur edhe tek shqiptarët në veçanti në periudhën e Perandorisë Osmane në trojet shqiptare për të cilën do të bëhet fjalë më poshtë në këtë punim.

Kush është më i keq, një fundamentalist laik, apo një fanatik fetar?

Debatet nuk kanë të ndalur, është debatuar në të kaluarën dhe vazhdimisht debatohet edhe sot, kjo e gjitha për faktin se njerëzit ose debatojnë nga arsyeja, për të qenë të informuar më shumë rreth ndonjë ngjarje apo dukurie, ose nga kurreshtja njerëzore.

Natyrisht sot bëhet debati se kush është më i keq: një fundamentalist laik, apo një fanatik fetar? Mendohet se që të dyja janë të dëmshme dhe të këqija. Ashtu si i pari që duhet të respektojë ndjeshmërinë fetare të të tjerëve, i dyti duhet të ngulisë në mendje vetëdijen për Zotin, që ta ndihmojë të tolerojë qeniet e tjera njerëzore, sepse kjo është dëshmi edhe e kësaj thënie kuranore ku Allahu xh.sh thotë: "Sikur të kishte dashur Zoti yt, do t'i besonin çka janë në tokë të gjithë. A ti do t'i detyrosh njerëzit të bëhen besimtarë?" (Junus: 99).

Historia provon se Islami ka bashkëjetuar me kultura dhe qytetërime të ndryshme. Bota Islame nuk ka qenë e mbyllur për pranin e religjioneve të tjera dhe tempujve të tyre fetarë. Kishat edhe sot plotësojnë panoramën e Kajros, Bejrutit, Damaskut dhe shumë qyteteve tjera. Edhe sinagoga ka kudo që jetojnë çifutët, që prej Teheranit deri ne Fes. Në Perandorinë Osmane në shumë vende në Ballkan, ku jetonin së bashku çifutët të krishterët dhe muslimanët, sinagogat, kishat dhe xhamitë ishin ndërtuar njëra pranë tjetrës. Prania harmonike e tempujve të ndryshëm fetarë është evidente në Stamboll deri në ditët tona. E njëjta gjë, mund të thuhet edhe për panoramën e Kosovës, ku hasim kisha dhe xhamia të ndërtuara pranë njëra tjetrës. E gjithë kjo, dëshmon për tolerancën islame, dhe për konceptin koekzistencë që proklamon Islami. (Ajni Sinani, "Islami besim, ligj, kulturë dhe qytetërim", Prishtinë, 2007).

Ndërsa studiuesi Nexhat Ibrahimi në librin "Islami si provokim global", duke iu qasur temës "Pengesat dhe prespektivat e dialogut ndërmjet Islamit dhe Kristianizmit", arrin në përfundim se Perëndimi dhe Islami mund të bashkëjetojnë, sikur dhe Veriu i pasur dhe Jugu i varfër. "Asnjë popull nuk paraqet 'ujdhesë' të vetëmjaftueshme. Porosia e Allahut në Suren "El-Huxhurat"(13); që tashmë e kemi përmendur më lartë, kërkon angazhim dhe bashkërenditje për kristianët dhe muslimanët në shërbim të Zotit e kundër sekularizmit, materializmt, padrejtësive shoqërore dhe politike, sëmundjeve fizike dhe morale, konflikteve të armatosura dhe globalizimit të komunikimit intelektual, kulturor dhe komercial", përfundon Ibrahimi.

(Vazhdon në numrin e ardhshëm)

Reflektime ndërkombëtare për Kosovën

RIAKTUALIZOHET OPSIONI

Demir RESHITI

Edhe gjatë muajit shtator kanë vazhduar përpjekjet e treshes SHBA-BE-Rusi, e përfaqësuar nga diplomatët Frank Wisner, Wolfgang Ischinger dhe Aleksandar Kaharchenko për të gjetur një zgjidhje kompromisi ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit. Si rezultat i këtyre përpjekjeve është organizuar një takim i drejtpërdrejt ndërmjet përfaqësuesve të Prishtinës dhe Beogradit, me ç'rast është miratuar e ashtuquajtura deklarata e Nju Jorkut. Deklarata e ashtuquajtur e Nju Jorku-t, bazohet në kumtesën e Grupit të Kontaktit, në të cilën thuhet se ende vlejnë parimet e miratuara të Grupit të Kontaktit, dhe procesi i tashëm negociator zgjatë deri më 10 dhjetor.

Ndërkohë në qarqet ndërkombëtare është riaktualizuar opsioni i ndarjes së Kosovës, madje, përfaqësuesi i Rusisë në treshen ndërmjetësuese, Aleksandar Kaharchenko, ka deklaruar se në kuadër të Grupit të Kontaktit është shqyrtuar çështja e ndarjes së Kosovës. "Këtë çështje e kemi inicuar edhe gjatë takimit me palët në bisedime", ka thënë ai për të shtuar se Prishtina dhe Beogradi janë shprehur kundër ndarjes...

Në vazhdim po e paraqesim një kronologji të ngjarjeve dhe deklaratave më të rëndësishme lidhur me Kosovën, gjatë muajit shtator 2007.

(1 shtator) D'Alema: " Italia do të vazhdojë të shtyjë përpara pavarësinë e Kosovës"
Romë - Italia do të vazhdojë të shtyjë përpara pavarësinë e Kosovës dhe të kërkojë një zgjidhje "jo-traumatike" për statusin e saj, ka deklaruar ministri i Jashtëm italian Massimo D'Alema, për të shtuar se duhet të plotësohen edhe kërkesat e Serbisë për sigurinë e objekteve fetare.

(3 shtator) Basescu: Rumania është kundër pavarësisë së Kosovës


Massimo D'Alema

Bukuresht - Kryetari i Rumanisë Train Basescu, ka pohuar se është kundër pavarësisë së Kosovës. "Ne kemi obligim që të mbështesim parimet e të drejtës ndërkombëtare në krijimin e shteteve të reja. A duhet komuniteti ndërkombëtare dhe unioni Evropian të vendos për pavarësinë e Kosovës? Si do që të jetë Bukureshti do ta pranojë atë, citon agjencia gjermane DPA, fjalët e kryetarit Rumun Basescu.

(4 shtator) Kharchenko: Në Grupin e Kontaktit është shqyrtuar çështja e ndarjes së Kosovës
Moskë - Përfaqësuesi i Rusisë në Treshen negociatore për Kosovën Alexander Botsan-Kharchenko ka deklaruar se "në kuadër të Grupit të Kontaktit është shqyrtuar çështja e ndarjes së Kosovës". "Këtë çështje e kemi inicuar edhe gjatë takimit me palët në bisedime", ka thënë ai për të shtuar se Prishtina dhe Beogradi kanë thënë se ndarja për ta është e papranueshme.

(5 shtator) Rehn: Bashkimi Evropian kundërshton ndarjen e Kosovës
Bruksel - Bashkimi Evropian kundërshton ndarjen e Kosovës, ka thënë Komisionari për zgjerim i Unionit Evropian Oli Rehn, pas takimit me ministrin e serb të punëve të Jashtme, Vuk Jeremiq.


Jose Manuel Barroso

(6 shtator) Casey: Dhuna në Kosovë nuk do t'i ndihmoj askujt
Uashington - "Nëse dhuna kthehet në Kosovë, kjo nuk do t'i ndihmoj askujt, kjo praktikisht do të thoshte një hap mbrapa për rajonin, serbinë, por edhe për banorët e Kosovës, ka deklaruar zëdhënësi i departamentit amerikan të shtetit Tom Casey.

(7 shtator) Ministrat e Jashtëm të BE-së kundër ndarjes së Kosovës
Viana do Castello - Ministrat e Jashtëm të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian në takimin e mbajtur në Viana Do Kastello të Portugalisë, janë shprehur kundër ndarjes së Kosovës, duke thënë se ndarja do të destabilizonte tërë Ballkanin. Kundër ndarjes së Kosovës janë shprehur Ministrat e jashtëm të Britanisë së Madhe, Francës dhe Suedisë.

(8 shtator) Amado: Çështja e statusit të Kosovës është "urgjente dhe prioritare"
Viana do Castello - Në Viana Do Kostelo të Portugalisë ka përfunduar samiti dyditësh i ministrave të jashtëm të Bashkimit Evropian. Pas këtij samiti, mbretëron përshtypja se në BE ende nuk ka unitet të


Vitaly Churkin

plotë rreth statusit të Kosovës. Ministri i jashtëm i Portugalisë, Luis Amado, që e ka kryesuar samitin, ka thene se çështja e statusit të Kosovës është "urgjente dhe prioritare".

(10 shtator) "The Indipendente": Britania e Madhe dhe Franca të gatshme për të pranuar pavarësinë e Kosovës
Londër - Britania e Madhe dhe Franca janë ndër shtetet e Bashkimit Evropian të gatshme për të pranuar pavarësinë e Kosovës, ka shkruar e përditshmja "The Indipendente", për të shtuar se pozicioni i Gjermanisë është më pak i qartë. Spanja, Hungaria, Greqia, Sllovakia, Qipro dhe Rumania ngurrojnë, ndërsa qeveritë e tjera tregojnë shenja të ambivalencës, ka shkruar kjo gazetë.

(11 shtator) Rehn: Serbia nuk do të përdorë forcën nëse Kosova shpallë pavarësinë
Beograd - Eurokomisioneri për zgjerim Oli Rehn, ka deklaruar se ka marrë garanca nga zyrtarët në Beograd, se Serbia nuk do të përdorë forcën nëse Kosova shpallë pavarësinë. Rehn gjithashtu ka deklaruar se vazhdimi i agonisë rreth statusit do të rrezikojë stabilitetin e Kosovës dhe do të ngadalësoj përparimin e gjithë Ballkanit Perendimor.

(12 shtator) Barroso: Duhet të arrihet "përparim i prekshëm" në bisedimet mes Prishtinës dhe Beogradit
Bruksel - Kryetari i Komisionit Evropian, Jose Manuel Barroso ka thënë se duhet të arrihet "përparim i prekshëm" në bisedimet mes Prishtinës dhe Beogradit për statusin e Kosovës, dhe shtoi se vetëm një zgjidhje politike sjell paqe dhe stabilitet të përhershëm në rajon. Bashkimi Evropian pret "qasje konstruktive" të Prishtinës dhe Beogradit në këtë proces, tha Barroso pas takimit me kryeministrin e Serbisë, Vojisllav Koshtunica.

I NDARJES SË KOSOVËS...

(13 shtator) Tadiq: Serbia nuk do të luftojë në Kosovë...


Condolezza Rice

Lisbonë - Serbia nuk do të luftojë në Kosovë në rast të shpalljes së njëanshme të pavarësisë, ka thënë presidenti serb Boris Tadiq për të përditshmen portugeze "Diario de Notisiass".

(14 shtator) Ischinger: Për statusin e Kosovës të vendoset tash e jo pas pesë vitesh
Bukuresht - Bashkësia ndërkombëtare duhet të vendosë për statusin e Kosovës "tash e jo pas pesë vitesh" sepse ekziston rreziku që të destabilizohet i tërë rajoni i Ballkanit, ka deklaruar Wolfgang Ischinger, anëtar i treshes ndërkombëtare për statusin e Kosovës, në intervistën për televizionin rumun Realitatea.

(19 shtator) Churkin: 10 dhjetori nuk është afat i fundit i negociatave
Moskë - Nuk mund të flitet për 10 dhjetorin si afat të fundit të negociatave për statusin e Kosovës, ka deklaruar ambasadori i Rusisë në OKB, Vitali Churkin.
"Do të ishte shumë mirë në qoftë se palët do të arrinin marrëveshje deri më 10 dhejtor", ka thene Churkin, por nëse jo, "ne jemi të bindur se do të jetë e nevojshme që bisedimet të vazhdojnë".

(21 shtator) Kramer: Procesi i statusit nuk mund të zgjasë përgjithmonë
Bruksel - Zyrtari i departamentit amerikan të shtetit, David Kramer, ka thënë se pavarësisht se a do të vendoset për statusin e Kosovës deri më 10 dhjetor apo pas kësaj date, një gjë është e qartë, procesi "nuk mund të zgjasë përgjithmonë".

(23 shtator) Bogdanoviq: Serbia do t'i ofrojë Kosovës "pavarësi brenda Serbisë"
Beograd - Anëtari i Ekipit Negociator serb, Goran Bogdanoviç ka deklaruar se Serbia do t'i ofrojë Kosovës "pavarësi brenda Serbisë". "Pozicioni ynë është që t'i ofrojmë Kosovës pavarësi brenda Serbisë. Kjo domethënë se shqiptarëve po u japim një shansë që t'i menaxhojnë jetët e tyre...", transmetohet të ketë thënë Bogdanoviq për shtypin e Beogradit.

(25 shtator) Rice: Kosova do të jetë e pavarur
Nju Jork - "Kosova do të jetë e pavarur. Ne jemi të dedikuar për këtë. Kjo është e vetmja zgjidhje që potencialisht e stabilizon Ballkanin, e jo që e destabilizon Ballkanin", ka thene sekretarja amerikane e shtetit, Condoleezza Rice në një intervistë për agjencinë Reuters.

(26 shtator) Lavrov: Shpallja e njëanshme e pavarësisë do të ishte qasje e gabuar
Nju Jork - Ministri i Jashtëm rus Sergei Lavrov, tha se shpallja e njëanshme e pavarësisë së Kosovës do të ishte një qasje e gabuar."Kur vende të caktuara, përfshirë anëtarë të Treshes, bëjnë deklarata publike se pavarësisht nga rezultati i negociatave, pavarësia e Kosovës është e pashmnagshme, thjesht e provokojn njërën palë që


Jan Kubish

të hedhë poshtë kompromisin", ka thënë Lavrov, një ditë pas deklaratës së Sekretares amerikane të Shtetit Condoleezza Rice, se vetëm pavarësia e Kosovës mund të sjellë stabilitet në Ballkan.

(27 shtator) Grupi i Kontaktit diskuton për Kosovën
Nju Jork - Ministrat e Jashtëm të 6 vendeve anëtare të Grupit të Kontaktit për Kosovën, janë tubuar në Nju Jork, një ditë para takimit të drejtpërdrejtë ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit. Në takim kanë marrë pjesë Condoleezza Rice, Sergei Lavrov, David Miliband, Bernard Kouchner, Frank Walter-Steinmeier dhe Massimo D'Alema, si dhe Treshja ndërmjetësuese, përfaqësuesi i Lartë i BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Javier Solana, Komisioneri për Zgjërimi, Oli Rehn dhe sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jaap de Hoop Scheffer.

(28 shtator) Miratohet "deklarata e Nju Jorkut" për Kosovën
Nju Jork - Në bisedimet e drejtpërdrejta ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit, është miratuar e ashtuquajtura deklarata e Nju Jorkut dhe është rënë dakord, që takimi i ardhshëm i drejtpërdrejt të mbahet më 14 tetor në Bruksel, ka deklaruar përfaqëuesi i BE-së, në treshën ndërmjetësuese Volfgang Issinger. Deklarata e ashtuquajtur e Nju Jorku-t, bazohet në kumtesën e Grupit të Kontaktit mbajtur një ditë më parë, në të cilën thuhet se ende vlejnë parimet e miratuara të Grupit të Kontaktit, dhe procesi i tashëm negociator zgjatë deri më 10 dhjetor.

(29 shtator) Kubish: ...Sllovakia nuk mund ta pranojë pavarësinë e Kosovës
Bratisllavë- Pa rezolutën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, Sllovakia nuk do të mund e pranonte pavarësinë e Kosovës, u ka thënë ministri i jashtëm i Sllovakisë, Jan Kubish liderëve të Kosovës në Nju Jork. Siç ka njoftuar sot Ministria e Jashtme sllovake, zoti Kubish ishte takuar me zyrtarët kosovarë gjatë mbajtjes së Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara dhe ata i kanë paraqitur vizionin e Kosovës së pavarur, si zgjidhje e qëndrueshme, që e mbështetë pjesa më e madhe e banorëve të saj.

(30 shtator) Solana: Takimi i Nju Jorkut ishte konstruktiv
Bruksel - Përfaqëuesi i lartë i BE-së për politikë të jashtme dhe siguri Havijer Solana, ka vlerësuar se takimi i parë i drejtpërdrejt ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit, ishte konstruktiv dhe ka shfaqur shpresën se vazhdimi do të jetë i suksesshëm. Në konferencën për shtyp në qytetin portugez Evora, gjatë takimit joformal të ministrave të mbrojtjes të vendeve anëtare të BE-së, Solana ka thënë se nuk mund të thotë se në Nju Jork


Javier Solana

është arritur shumë, por takimi i parë i drejtpërdrejt është zhvilluar në një atmosferë relaksuese dhe konstruktive.

Fotoreportazhi

AKTIVITETE TË SHOQATËS KULTURORE





Osman D. GASHI


Është bërë tashmë traditë që Shoqata kulturore "Zëri Ynë" gjatë muajit të bekuar të Ramazanit të organizojë iftare të përbashkëta dhe aktivitete të ndryshme.
Ndër këto aktivitete veçuam Iftarin e përbashkët me intelektualë, biznesmenë, artistë, etj.; Iftarin me studentë të gazetarisë; dhe koncertin në qytetin e Besianës i cili u mbajt për nder të Ditës së Fitër Bajramit.

Iftari me intelektualë, biznesmenë, njerëz të botës së artit...

Më 24 shtator në ambientet e hotelit "Victory" në Prishtinë, mbi njëqind intelektualë që veprojnë e punojnë jo vetëm në Prishtinë, por edhe në qendrat tjera të Kosovës si dhe jashtë saj, në Maqedoni e në vendet tjera fqinje, ishin mysafirë në iftarin e përbashkët të shtruar nga Shoqata Kulturore "Zëri Ynë".
Krahas intelektualëve ishin të pranishëm edhe biznesmenë të suksesshëm të cilët janë dëshmuar me solidaritetin e tyre ndaj nevojtarëve.
Në këtë sofër të përbashkët, nuk mungonin as njerëzit nga bota e artit, si artistë, këngëtarë etj.

Iftari me studentët e gazetarisë

Në muajin e solidaritetit, humanizmit e të mirësisë, Shoqata "Zëri Ynë" nuk la pas dore as studentët e Universitetit të Prishtinës. Kjo shoqatë e shtroi iftar për një grup studentësh të Degës së Gazetarisë pranë Fakultetit Filologjik të Universitetit të Prishtinës. Iftari u shtrua në hotelin "Victory" më 3 tetor.





Koncerti për nder të Festës së Fitër Bajramit

Në vazhdën e aktiviteteve të saj, shoqata "Zëri Ynë" për nder të Festës së Fitër Bajramit organizoi një koncert me këngë e recitale. Koncerti u organizua në Shtëpinë e Kulturës, në Besianë, ditën e parë të Fitër Bajramit, më 12 tetor.
Këngëtarët Ismet Azemi, Mentor Mripa e Agim Gërguri, janë duar-

"ZËRI YNË" NË MUAJIN E RAMAZANIT

trokitur gjatë nga të pranishmit. Publikun besianas e kanë emocionuar me deklamimin e poezive, edhe Selvete Kastrati dhe Flamur Maloku. Në këtë koncert u bë edhe promovimi i albumit "Zgjohu", i aktorit dhe këngëtarit Ismet Azemi.















MASAKRA E SABRËS DHE SHATILLËS

Kur Izraeli pushtoi Libanin, kishte plagosur dhe vrarë 200.000 mijë libanezë dhe palestinezë, pjesa dërmuese e të cilëve ishin civilë. Pat Robertson, një pastor evangjelist i njohur në Amerikë, kishte thënë se me këtë luftë Izraeli po vepronte sipas "dëshirës së Zotit".



Ajni SINANI

Robert Fisk, ka qenë njëri prej gazetarëve që kanë qenë prezent në llogoren e refugjatëve palestinez të Sabrës dhe Shatilës, në Liban gjatë kohës kur ishte kryer masakra. Ai ka shkruar librin "Pity the Nation", që flet për atë masakër makabre. Autori thekson, se ishte shokuar nga ajo që kishte parë. Kjo ngjarje e tmerrshme dhe tragjike, ka ndodhur më 18 shtator të vitit 1982, në kohën kur Ariel Sharon ishte ministër Izraelit i mbrojtjes. Izraelitët ia kishin dorëzuar të burgosurit palestinezë aleatëve të tyre, policisë krishtere libaneze, që ishte e etur për gjak. Ja si e përshkruan, midis të tjerave, ai këtë masakër: "Brenda llogoreve të refugjatëve palestinezë të Sabrës dhe Shatilës, më shumë se 600 viktima kishin filluar të qelbeshin në diell, dhe kundërmimi i trupave të tyre shpërndahej deri tek të internuarit, madje edhe deri tek të burgosurit. Ishte shumë nxehtë dhe të zihej fryma. Loren Jenkins nga Washington Post, Paul Edle nga Reuters dhe unë ishim të vetmit që kishim hyrë në këtë qeli, sepse izraelitët për shkak të pamjes sonë të jashtme perëndimore kishin supozuar se ne patjetër duhet të ishim agjentë të Shin Betas, shërbimit të fshehtë Izraelit. Shumë prej të burgosurve i kishin kokat e prera".

Në Liban ka pasur edhe më parë vrasje, por nuk kanë qenë të kësaj natyre. Kësaj here, qenë vrarë me qindra njerëz të paarmatosur. Kjo kishte qenë një vrasje masive dhe një lemeri e vërtetë. Ishte një krim lufte. Ajo që kishte ndodhur - sipas Fisk-ut - është vështirë të përshkruhet, kurse më së lehti mund të përshkruhet si ekzekutim i ftohtë.

"Në këtë kasaphanë gratë shiheshin në shtëpi të shtrira me fustane të grisura, ndërsa fëmijët me fyt të prerë. Një varg të rinjsh, pasi ishin mbështetur për muri, ishin vrarë nga shpina. Aty kishte bebe që ishin masakruar dhe trupat e tyre të nxira dhe të prishura, ishin hedhur në mbeturina së bashku me shishet e verës".



Vrasja ishte drejtuar kundër civilëve...

Kjo vrasje ishte e drejtuar kundër civilëve dhe njerëzve të pafajshëm dhe nuk kishte të bënte me njerëzit e armatosur, apo po të përdorim vokabularin izraelit me terroristët!

Kur Izraeli pushtoi Libanin, kishte plagosur dhe vrarë 200.000 mijë libanezë dhe palestinezë, pjesa dërmuese e të cilëve ishin civilë. Pat Robertson, një pastor evangjelist i njohur në Amerikë, kishte thënë se me këtë luftë Izraeli po vepronte sipas "dëshirës së Zotit".

Fisk në librin e tij përshkruan skenën trishtuese dhe rrëqethëse në kampin e Shatillës të kësaj masakre: "Poshtë, në të djathtë, shtriheshin një turmë kufomash. Kishte me dhjetëra e dhjetëra kufoma, njerëz të rinj duart dhe këmbët e të cilëve ishin të lidhura me njëra tjetrën. Të gjithë ishin të goditur nga afërsia, me faqe të shqyera nga plumbi që u kishte hyrë në tru. Disa kishin ngjyrë të purpurt ose vragë të zeza në grykat e tyre...

Sytë e atyre njerëzve të rinj ishin shumë të hapur. Më i riu prej tyre ishte 12 ose 13 vjeç. Në pjesën tjetër të rrugës, në një shteg, kishte disa gra dhe fëmijë. Gratë ishin të moshës së mesme dhe kufomat e tyre shtriheshin në një grumbull mbeturinash…

Një foshnje shtrihej në rrugë si një kukull e hedhur, petku i saj ishte i përlyer me baltë dhe pluhur. Nuk kishte më shumë se tre vjet. Zverku i ishte bërë copë e grimë nga plumbi që i ishte shkrepur në kokë…

Një grua mbante një foshnje shumë të vogël pranë trupit të saj. Plumbi që kishte kaluar nëpër gjoksin e saj kishte vrarë edhe foshnjën. Dikush kishte çarë barkun e gruas mbase për ta mbytur foshnjën, që akoma nuk kishte lindur. Sytë e saj ishin shumë ta hapur, fytyra e saj e përhimët ishte e ngjashme me një fytyrë horrori".

Në mesin e të vrarëve edhe foshnja tre vjeçare!

Sana Sersawi, e cila ishte me barrë tre muajsh, njëra nga dëshmitaret e masakrës, rrëfen: "Policia krishtere libaneze (falange), na nxori nga shtëpitë tona dhe na dërgoi në kampin në të cilin ishte hapur një gropë e madhe në tokë. Meshkujve u tha që të hyjnë në të. Pastaj një polic ka shkrepur armën ndaj një palestinezi… Kemi qenë të shokuar duke parë se si ai njeri është vrarë para nesh dhe u dëgjuan britma dhe bërtitje nga ana e grave.



Na thanë të ecim rrugës drejt ambasadës së Kuvajtit, gratë dhe fëmijët ishin përpara kurse burrat prapa. Pranë nesh ecnin fangalistët dhe ushtarët izraelitë. Akoma e shoh Hasanin (bashkëshortin 30 vjeçar) dhe kunatin Faraxhin. Dukej si një paradë. Ishim disa qindra njerëz. Kur kemi arritur tek stadiumi Cite Sportif (vetëm dy milje larg aeroportit të Bejrutit, që më vonë është zbuluar se ka shërbyer për mbajtjen e pengjeve), izraelitët i kanë lënë gratë në një dhomë të madhe prej betoni, kurse meshkujt i kanë ndarë në pjesën tjetër të stadiumit. Kishte shumë meshkuj prej kampit dhe nuk arrita ta shoh bashkëshortin tim...

Më vonë disa meshkuj janë paraqitur, por asnjëri prej tyre më i ri se 40 vjeç!...

Aty ishin kamionët izraelitë që transportonin me cerada sipër tyre. Nuk mund të shihnim se çfarë kishte brenda. Aty ishin edhe xhipat dhe tanket, dhe e gjithë kjo përbënte një potere të madhe. Kemi qëndruar aty deri sa është terruar dhe deri sa kanë shkuar izraelitët edhe që ishin shumë nervoz. Nuk kishte më asnjë njeri. Asnjë njeri. Unë isha martuar vetëm tre vjet më herët. Kurrë nuk e kam parë më burrin tim".

U hesht, sepse viktimat në Bejrut ishin palestinezë...

Policia krishtere libaneze kishte qenë në ato llogore me lejen izraelite. Ata ishin armatosur nga ana e Izraelit. Nëse në Sabër dhe Shatillë, janë vrarë me qindra njerëz të pafajshëm, atëherë shtrohet pyetja, se pse të mos vlerësohet një katrahurë e tillë si masakër? Kur masakra nuk është masakër? Sa njerëz duhet të vriten që një vrasje e tillë të klasifikohet si masakër?! Mos vallë njerëzit e vrarë janë numra tepër të ultë që vrasja e tyre të mos klasifikohet për masakër! Apo kësaj here u hesht, sepse viktimat në Bejrut ishin palestinezë?!

Sikur të ndodhte që forcat siriane të depërtonin në Izrael dhe t'ua kishin dorëzuar kibucët aleatëve të tyre palestinezë për t'i vrarë, të gjitha agjencitë perëndimore nuk do të vononin dhe nuk do të ngurronim aspak që ta cilësonin një veprim të tillë si masakër.

Fajtor për të gjithë atë që ndodhi ishte policia e krishtere së bashku me atë izraelite. Edhe nëse supozohet se izraelitët nuk kanë marrë pjesë direkt në ato vrasje makabre, ata padyshim se e kishin dërguar policinë në kamp. Ata i kanë trajnuar dhe i kanë dhënë uniformën forcave falange. Ata i kanë parë vrasësit në kamp, u kanë ofruar ndihmën e tyre ushtarake, u kanë ndihmuar vrasësve që të vrisnin refugjatët e Sabrës dhe Shatilës. Ka patur një bashkëpunim ushtarak mes forcave izraelite dhe falange krishtere të Libanit.

Ariel Sharon, edhe sot e kësaj dite nuk është gjykuar për këtë masakër edhe pse është bërë përpjekje dhe ka pasur kërkesa për këtë. Në vend të gjykimit ai është shpërblyer me pozitën e kryeministrit dhe edhe më pas ka vazhduar me të njëjtën strategji kundër palestinezëve! Tani Sharon është në gjendje kome dhe po mbahet në jetë përmes aparateve, as i gjallë dhe as i vdekur. Ky është një ndëshkim për këtë shpirtlig në këtë botë, para ndëshkimit shumë më të rëndë që e pret në botën tjetër.

FESTA E FITËR BAJRAMIT

Festa e Fitrit ka dalë si rezultat i një sakrifice të gjatë mujore të besimtarit, i cili për një muaj rresht është përballur me agjërimin, pra, me mos ngrënie ose ndryshe me urinë gjatë ditës, si dhe ndalimin e tij nga fjalët e pa matura ose të pista. Besimtari, muajin e Ramazanit për shumë arsye e konsideron si muaj më të privilegjuar të vitit, dhe për këtë arsye i përkushtohet më shumë adhurimit, se sa në muajt të tjerë

Mehmet SHKËMBI

Njerëzimi më herët në shenjë të plotësimit të "dëshirave të perëndive", në ditë të veçanta të tyre festive sakrifikonin më të bukurit/at ose më të dashurit e tyre. Fatkeqësisht, kjo lloj sakrifice akoma nuk është zhdukur. Si duket nuk do të zhduket kurrë, sepse ajo shfaqet herë pas here në grupe të ndryshme edhe në ditët tona të sotme. Pa marrë parasysh se sa i përparuar është njeriu në fushën e teknologjisë, kur është në pyetje universi dhe sekretet e tij, ai ndodh të humbet, dhe të marrë iniciativa fatale për veten e tij ose të grupit ku ai influencon. Kemi pasur raste të këtij lloji pak vite më parë në SH.B.A-në e sotme ku u bënë disa vetëvrasje kolektive që tmerroi mediat në mbarë globin.

Njerëzimi në përgjithësi dhe popujt në veçanti, kanë ditët e tyre festive të shënuara gjatë një viti. Ato janë të karakterit kombëtar, ekonomik, politik dhe fetar. Bajrami është një ditë festive e mbarë besimtarëve mysliman që jetojnë në botë. Bajram është fjalë turke, në arabishte quhet "iid", ndërsa në gjuhën shqipe do të thotë festë. Myslimanët festojnë dy festa fetare në vit, atë, festën e Fitrit dhe festën e Sakrificës-Kurbanit. Festa e Fitrit ka dalë si rezultat i një sakrifice të gjatë mujore të besimtarit, i cili për një muaj rresht është përballur me agjërimin, pra, me mos ngrënie ose ndryshe me urinë gjatë ditës, si dhe ndalimin e tij nga fjalët e pa matura ose të pista. Besimtari, muajin e Ramazanit për shumë arsye e konsideron si muaj më të privilegjuar të vitit, dhe për këtë arsye i përkushtohet më shumë adhurimit, se sa në muajt të tjerë. Dëshira e tij gjatë këtij muaji, është që të agjërojë, sepse atë e bën më të përkushtuar dhe më të afërt me Krijuesin. Atë e bën më të dëlirë dhe më paqësor ndaj njeriut tjetër, aq më tepër nëse ai është i varfër. Duke agjëruar myslimani mediton, si dhe përkujton njerëzit ose popujt që nuk kanë ushqim të mjaftueshëm. Kur plotësohet muaji i plotë hënor, ai interesohet për të varfëritë. Ai është në kërkim të tyre që t'iu ndajë atyre një sasi të artikujve të tij ushqimor, ose edhe më shumë. Personat që konsiderohen më të varfër dhe që duhet ndihmuar janë studentët, jetimët, të sëmurit kronik, skamnorët, borxhlinjtë, etj. Myslimani nuk mendon asnjë të keqe për njerëzimin, në veçanti këtë muaj ai lutet për paqe, mirëqenie dhe harmoni ndërnjerëzore. Kështu, kur ky muaj të mbarojë, ai me të drejtë feston për përkushtimin e tij gjatë muajit të kaluar. Meqenëse, ai këtë ditë e konsideron ditë festive, ai, do të ndihmojë të varfëritë, që edhe ata të gëzojnë sikur të gjithë të tjerët. Popujt mysliman, veçanërisht ata të gadishullit arabik, kanë arritur që në vendin e tyre të mos ketë të varfër, prandaj sasinë e paraparë të fitrave dhe zekatit e ndajnë në vende të tjera myslimane dhe jomyslimane, aty ku mbretëron uria dhe skamja. Para disa vitesh edhe ne ishim nevojtarë të kësaj ndihme e cila nuk mungoi. Të kuptuarit saktë dhe qartë islamin, është kënaqësia më e madhe që mund ta arrijë një njeri ose një popull.

Elita, nuk duhet të ikë nga shpjegimi i këtyre veprimtarive, ajo nuk duhet të paraqitet sikur nuk i njeh ato, ose të pretendojë të thotë se nuk ka pse të merret me to, sepse jemi të orientuar drejt perëndimit. Thirrjet, sikur ato drejt perëndimit, lindjes, veriut ose jugut, nuk kanë të bëjnë aspak me dukuritë që vijnë nga vertikalja-qielli, prandaj, elita këto duhet t'i kuptojë, nëse jo, atëherë populli seriozisht duhet të mendojë, se a kemi elitë apo pseudointelektualë që e mashtrojnë vazhdimisht këtë popull.

Festa e Fitrit ndër shqiptarë

Se kush ishin shqiptarët më parë, nuk kemi dëshmi të shkruara. Por, pozita jonë gjeografike ka bërë që edhe ne sikur të gjithë popujt t'iu bashkangjitemi trendëve më bashkëkohore të globit. Islami ndër ne është njohur që nga fillimi, pra, që në shekullin e shtatë, por me të u njohëm më gjerësisht në shekullin e nëntë, e më pastaj edhe më shumë pas shekullit katërmbëdhjetë. Si rezultat i paraqitjes së turqve në viset tona, populli ynë pranoi fenë islame me disa mangësi. Kur them kështu, kam parasysh se ai u shpjegua sipas mënyrës së turqve e jo sipas botëkuptimit dhe mundësive të pranimit të shqiptarëve në gjuhën e tyre. Atëkohë shqiptarët, nuk kishin gjuhë të shkruar, prandaj, edhe nxënia e diturisë fetare ishte më e vështirë. Shumëçka prej parimeve të fesë, janë mësuar verbalisht, pa i njohur mirë ato.

Secili njeri ose popull, e gjen veten e tij në Kur'an, prandaj të kuptuarit e Kur'anit duhet të vjen natyrshëm sepse ai kështu do të praktikohej më hareshëm.

Duke qenë se ne si popull pranuam këtë fe qiellore, pranuam edhe festat e caktuara, por, personalisht mendoj, se nuk kemi njohuritë e duhura rreth tyre. Tek ne, në tërësi, na mungojnë shpjegimet të cilat e motivojnë njeriun besimtar të sakrifikojë, ose të festojë këto dukuri fetare. Për këtë arsye, elita jonë duhet të merret seriozisht rreth këtyre dukurive, e mos t'ia lë rutinës, sepse ato në të ardhmen do të na kushtojnë shtrenjtë. Elita, nuk duhet të ikë nga shpjegimi i këtyre veprimtarive, ajo nuk duhet të paraqitet sikur nuk i njeh ato, ose të pretendojë të thotë se nuk ka pse të merret me to, sepse jemi të orientuar drejt perëndimit. Thirrjet, sikur ato drejt perëndimit, lindjes, veriut ose jugut, nuk kanë të bëjnë aspak me dukuritë që vijnë nga verikalja-qielli, prandaj, elita këto duhet t'i kuptojë, nëse jo, atëherë populli seriozisht duhet të mendojë, se a kemi elitë apo pseudointelektualë që e mashtrojnë vazhdimisht këtë popull.

Histori Islame (11)

Betejat e myslimanëve në gadishullin arabik (2)

Ndërsa rrethimi vazhdonte Muhammedit iu paraqit një njeri nga fisi Gatafan i cili kishte pranuar islamin vonë. Ai kërkoi nga ai s.a.v.s. që t'i jepte leje atij për të ndërmarë një fushatë përçarëse kundër forcave aleate. Muhammedi s.a.v.s. i tha: "Lufta është shkathtësi, taktikë dhe mashtrim"



Muhamed Jusufi – KAJOLLI

Grupimet e interesit pas betejës së Bedrit

Kjo betejë shkaktoi ndryshime shumë të mëdha në gadishull. Askush nuk e kishte paramenduar se grupi myslimanëve do të fitonte, gjithashtu askush nuk besonte se numri tyre ishte shtuar aq shumë. Ky lajm tronditi të gjitha fiset arabe në gadishull, si për ata që ia donin të mirën njashtu edhe për ata që i urrenin. Megjithatë, myslimanëve do t'ju shtohen detyrimet në ditët (vitet) në vijim, sepse do të sulmohen pandërprerë deri në fitoren përfundimtare të gadishullit.

Grupet e interesit pas kësaj beteje filluan të paraqiten haptazi, prej tyre mund të veçojmë:

Grupin e arabëve që kishin simpati për myslimanët, u afruan dhe filluan ta përqafojnë islamin si fenë e tyre dhe të vetme.

Grupi hebre, pas kësaj beteje doli haptazi kundër myslimanëve.

Grupi hipokritëve,

Grupi mushrikëve - politeistave në mbarë gadishullin ishte indinjuar tmerrësisht dhe po përgatitej për hakmarrje dhe

Grupi i beduinëve, të cilët nuk donin t'ia dinin fare as për myslimanët e as për mushrikët. Ata jetonin jetën e tyre të plaçkitësit të rëndomtë.

Para se të sjellim disa detaje të luftës së Uhudit ia vlen të theksohet se Muhammedi s.a.v.s. që kur u shpërngul në Medine dhe deri në përfundimin e jetës së tij ka marrë pjesë të drejtpërdrejtë në njëzet e shtatë beteja. Numri i ekspeditave në të cilat nuk ka marrë pjesë Muhammedi s.a.v.s. ishte mbi tridhjetë e tetë.

Luftërat të cilat u zhvilluan thamë se ishin të karakterit mbrojtës. Se sa ishte jeta e vështirë, dhe, ndryshimet që ndodhnin ndër myslimanë flet numri i madh i betejave, për tetë vjet sa jetoi Muhammedi s.a.v.s. në Medinë. Myslimanët për këto tetë vjet do të duhej të bashkonin fiset e gadishullit, do të duhej të instalonin rrjetin e kontrollit dhe sigurinë në gadishull, do të duhej të formonin formacione mbrojtje, do të formonin institucionet qeverisëse si dhe do të dilnin me vizione të qarta për njerëzimin. Për të mos u zgjeruar në temë nuk do të ndaloj këtu... Meqenëse jemi tek luftërat mendoj se nga beteja e Bedrit filloi një jetë e re për myslimanët. Kjo betejë u bë shkak për të mësuar se si i dërguari All-llahut s.a.v.s. e ndau plaçkën e luftës. Por në gjenerale rreth plaçkës mësojmë se Muhammedi s.a.v.s. atë e ndau në:

* plaçkë e cila arrihej si rezultat i fitoreve nëpër beteja dhe kjo plaçkë ndahej në pesë pjesë. Një pjesë i takonte Muhammedit s.a.v.s. ndërsa katër të pestat u takonin luftëtarëve dhe
* plaçkë e cila fitohej si rezultat i marrëveshjeve. Këtë e ndante, katër të pestat i takonin Muhammedit s.a.v.s ndërsa një e pesta i takonte luftëtarëve. Pjesa që i takonte Muhammedit s.a.v.s. ndahej prej tij në pesë grupe njerëzish:
* një pjesë e cila është 20% e plaçkës ia jepte vetes, grave të tij dhe ajo që ngelte prej kësaj përqindje e jepte në bamirësi të përgjithshme
* përqindjen e dytë ia shpërndante të afërmve të tij
* përqindjen e tretë ia shpërndante jetimëve dhe skamnorëve
* përqindjen e katërt ia jepte handikapëve dhe
* përqindjen e pestë e ndante për shkollim

Le të kuptohemi qartë, në këtë lloj shpërndarjeje nuk futen përfitimet që grumbulloheshin nga zekati e sadakaja, as nga detyrimet e tatimeve të një shteti tjetër-shtetit islam-xhizja si dhe as një e dhjeta që paguanin mushrikët nga tregtia e tyre.

Ngjarjet deri në betejën në Uhud

Menjëherë pas betejës së Bedrit, filluan thashethemet e shumta. Ndër politeistët nuk flitej gjë tjetër përveç hakmarrjes. Më herët kishim thënë se fisi hebre në Medinë kishte lidhur marrëveshje me myslimanët, por ata do ta prishin këtë marrëveshje për shkak se nuk mendonin se në botë kishte grup më të mirë se ata. Fitorja e myslimanëve i kishte tërbuar, nuk donin të pranonin se ka monoteistë më të privilegjuar se ata tek Zoti i botëve. Prishja e marrëveshjes erdhi si rezultat i intrigave, talljeve dhe kërcënimit që fisi Kajnuka (banorët e një lagjeje hebre në Medinë) ia bënin vazhdimisht myslimanëve. Ky fis ishte i pasur dhe njëkohësisht ishin mirë të përgatitur ushtarakisht. Ata posedonin shtatëqind kalorës të veshur mirë për luftë, dhe logjistikë të bujshme. Provokimet do të marrin fund, vetëm kur një ditën disa hebrenj talleshin me një grua myslimane e cila kishte shkuar të blinte flori tek një argjendar. Një mysliman i doli në mbrojtje asaj dhe, e mbyti njërin prej provokuesve, por edhe ata e mbytën atë. Me të dëgjuar Muhammedi s.a.v.s. për rastin mobilizoi ushtrinë dhe, i shpalli luftë këtij fisi. Të frikësuar nga nervozizmi i Pejgamberit, ata u mbyllën në fortifikatën e tyre dhe kështu qëndruan për disa ditë.

Askush nga ky fis, nuk besonte se do të mund t'i fitonin myslimanët e "tërbuar", prandaj paraqitën kërkesën për të lëshuar qytetin. Muhammedi s.a.v.s. ishte i vendosur për luftë, por një ditë i vjen Ibn Seluli (më vonë u shpall hipokrit) dhe,

kërkoi prej tij që të jetë i mëshirshëm ndaj tyre sepse atij ia paskan shpëtuar një herë jetën. Muhammedi s.a.v.s. deshi që Ibn Selulit t'ia jep shansin e përmirësimit dhe pranoi, por ata i kushtëzoi. Askush prej tyre të mos marrë me vete asgjë, përveç, nevojave të tyre personale.

Kështu dalëngadalë po pastrohej terreni i Medinës nga kundërshtarët ose armiqtë që mund ta rrezikonin komunitetin e myslimanëve. Një ditë vetë Pejgamberi s.a.v.s. kishte kërkuar të vritej Eshref bin Kabin. Ky njeri ishte kryeparë i fisit hebre Tajj, të cilët jetonin në një prej lagjeve të Medines. Ishte paraqitur në shoqërinë e re si mysliman dhe ishte i pasur. Ky shkonte shpesh në Mekkë, atje thurte poezi kundër myslimanëve, dhe, nxiste mekkasit për hakmarrje. Mos ekzekutimi tij do t'i kushtonte shumë myslimanëve. Të tjerët e këtij fisi si dhe fiseve të tjera të hebrenjve filluan të kuptojnë, se Muhammedi s.a.v.s. është i informuar mirë dhe, është i pa mëshirshëm me të gjithë ata që shkelin marrëveshjet, prandaj prej këtij rastin iu përgjigjën marrëveshjes së bërë me myslimanët.

Beteja e Uhudit


Mushrikët e kuptuan se koha po vepron në favor të myslimanëve dhe vendosën të hakmerren sa më parë që ishte e mundur. Vërtetë myslimanët po përparonin në kohë paqeje, udhëzimet e Kur'anit pranoheshin me lehtësi dhe numri i tyre shtohej vazhdimisht.

Mekkasit përgatitën një ushtri prej tre mijë ushtarësh të stërvitur mirë dhe, me vete morën shumë gra për t'ju shërbyer në logjistikë dhe njëkohësisht do të ndikonin në ngritjen e adrenalinës kundër myslimanëve.

Gjithashtu edhe myslimanët e kuptuan se duhet të luftojnë, e t'i largonin sa më larg pengesat. Ata synonin shumë më larg se sa hapësira e tyre në gadishull, prandaj edhe këta u përgatitën mirë dhe dolën vullnetarisht afër një mijë luftëtarë. Fushëbetaja u caktua vendi quajtur Uhud. Beteja përfundoi pa fitues, por lëvdatat e fitores i morën mushrikët.

Muhammedi s.a.v.s. kishte urdhëruar çetën e shigjetarëve që mos ta lëshonin pikën e istikamit të tyre për çfarëdo çmimi, por kur ata, panë se ushtarët myslimane i mundi edhe kësaj here, nxituan pas plaçkës së luftës. Lëshimi i atij vendi strategjik iu kushtoi myslimanëve shumë, sepse, Halid ibn Velidi shfrytëzoi këtë rast dhe udhëhoqi kalorësit e vetë përtej kodrines dhe i sulmoi myslimanët në befasi. Në këtë betejë u lëndua rëndë Muhammedi s.a.v.s. saqë iu thye një dhëmb. Gjithashtu u vra edhe axha i tij Hamzai. Për një moment ushtria myslimane u tërhoq, ndërsa mushrikët filluan t'i masakronin kufomat. Gruaja e 'hekurt' Hindi u gëzua pa masë kur Hamzait ia nxori zemrën. Pas një ç'lodhje myslimanët dolën përsëri në fushëmejdan por ushtria mekkase u largua duke festuar. Muhammedi s.a.v.s. dhe Ebu Sufjani këmbyen fjalë të ashpra dhe përfunduan duke lënë takimin tjetër pas një viti në Bedër. Lufta e Bedrit do ta përcaktonte fituesin e betejës së Uhudit.

Muhammedi s.a.v.s. këtë 'humbje' e shfrytëzoi, dhe zemrat e tyre u përforcuan edhe më shumë. Ai ua shpjegoi rëndësinë e mos respektimit të urdhrit dhe lakmive të kësaj bote. Kjo betejë për të gjithë ishte një mësim, myslimanët nuk do ta harrojnë kurrë këtë humbje me përjashtim edhe një herë tjetër kur u mashtruan me numrin e madh të ushtarëve që kishin në fushëbetejë. All-llahu i sprovoi me humbje duke i këshilluar se numri asnjëherë nuk është ai, që përcakton fitoren.



Ngjarjet deri në takimin e dytë të Bedr-it

Tani ndryshuan rolet, myslimanët u ndien humbës dhe problemet filluan të shtohen edhe më shumë. Myslimanët pas kësaj humbje u përfolën shumë dhe opinioni gjerë filloi të anojë në dëm të tyre. Nuk vonuan shumë, fiset kishin provuar fatin e tyre me myslimanët e "lodhur". Kështu filluan fiset ta sulmojnë Medinen ose më saktësisht lagjet e myslimanëve. Fillimisht e sulmuan fisi Benu Esed, pastaj fiset Adal dhe Kareh, pastaj Gatafan etj. Nga të gjitha këto sulme, prej palës së myslimanëve ranë shehid mbi tetëdhjetë persona, por të gjitha betejat iu takuan myslimanëve. Kështu i erdhi radha edhe e fisit hebre Benu Nadir, këta kishin marrë mësim nga fisi Kajnuka, por të bindur se do të fitonin kundër myslimanëve, sepse ishin në alencë të fshehtë me hipokritin tjetër Ibn Selulin, ata talleshin me myslimanët.

Një ditë Muhammedi s.a.v.s. kishte shkuar tek porta e këtij fisi dhe kërkoi prej tyre të paguanin gjakun e një personi. Ata iu përgjigjën pozitivisht sepse kështu ishte në marrëveshjen midis tyre. Në momentet kur Pejgambeti s.a.v.s. po priste i mbështetur në murin e oborrit të shtëpisë së tyre, ata në çast vendosën që ta mbysin Muhammedin s.a.v.s.sepse ishte rast i volitshëm për ta që hudhin një gurë të madh nga lartësia e murit të tyre. Por nuk ju doli ashtu siç menduan, ndërsa Muhammedit s.a.v.s. iu përgjigj atyre duke i kërcënuar që ky fis hebre të largohet nga qyteti për dhjetë ditë.

Në pritje të ikjes së tyre Ibn Seluli e bindi fisin Benu Nadir të qëndronin në vendet e tyre sepse do t'iu jepte ndihmën e tij prej dy mijë ushtarësh. Ata e dëgjuan atë dhe refuzuan ultimatumin e Muhammedit s.a.v.s.. Ky i fundit u detyrua ta dërgonte ushtrinë e tij dhe e rrethoi fortifikatën e tyre. Prej tyre u paraqit një mbrojtje filestare, duke menduar se do t'iu vinte ndihma e premtuar. Ajo ndihmë nuk ju erdhi kurrë. Meqenëse shigjetarët gjuanin nga fortifikata, dhe luftëtarëve të Muhammedi s.a.v.s. ua vështirësote afrimin në fortifikatë, ai urdhëroi që t'iu digjen fushat dhe lisat përreth tyre. Ky urdhër i tmerroi Benu Nadirët dhe filluan të frikohen shumë. Të rrethuar mbetën gjashtë ose pesëmbëdhjetë ditë. Pasi humbën shpresat e ndihmës ata pranuan kushte e Muhammedit s.a.v.s. Atyre ju ndalohej të merrnin më shumë mall se sa një deve të ngarkuar...

Pas shumë lodhjeve dhe peripecive që i patën myslimanët ia arritën fillimisht ta stabilizojnë vetveten e tyre, pastaj ndihej stabilizimi edhe në rajon. Kështu për një kohë relativisht të shkurtër prej një viti, myslimanët e rikthyen dinjitetin e tyre dhe fjala e fundit në rajonin e Medinës sërish iu takonte atyre.

Muhammedi s.a.v.s. nuk kishte harruar fjalën e dhënë Ebu Sufjanit, me të mbushur viti prej betejës së Uhudit tuboi njëmijë e pesëqind luftëtarët e tij dhe shkoi në Bedër për t'u ndeshur me Ebu Sufjanin. Kështu kishte vepruar edhe ushtria e mekkasve. Ata ishin tubuar dy mijë vetë dhe dolën nga Mekka duke marshuar. Para se t'iu afroheshin Bedrit përplasi sherri dhe frika brenda ushtrisë

së mushrikëve. Meqenëse shumica ishin për t'u kthyer, vendosën të mos ndeshen me ushtrinë myslimane. Muhammedi s.a.v.s. qëndroi tetë ditë në pritje të tyre dhe përfundimisht u mor vesh se ata nuk do të vijnë dhe kështu u kthye prapa në Medine si fitimtar.

Beteja e Hendekut

Gadishulli arabik sërish filloi të dëgjonte thashetheme rreth Muhammedi s.a.v.s., padyshim edhe për fitoren e tij kundër mushrikëve të Mekkës të cilët nuk kishin marrë pjesë në takimin e premtuar. Gjithashtu kontribut të madh dhanë edhe thirrësit e islamit të cilët gjendeshin gjithandej gadishullit. Në kohë të paqes Islami i ka të gjitha parametrat për tu zgjeruar dhe pranuar zërin tij në glob, prandaj armiqtë e tij mundohen ta pengojnë atë në forma të ndryshme si dhe duke e luftuar atë.

Më lartë theksuam se lufta e parë Bedrit i bëri fiset çifute të xhelozonin në fitoren e Muhammedit s.a.s.v. Dy vjet pas Bedrit Muhammedi s.a.v.s. po korrte fitore të njëpasnjëshme dhe ashtu siç kishin premtuar fisi Benu Nadir se do të hakmerrej kundër myslimanëve edhe bëri. Ky fis zgjodhi një grup prej katërdhjetë persona më të zgjuar të fisit dhe të shkonin nëpër fiset e ndryshme të gadishullit për të bërë aleanca me ta për ta sulmuar Muhammedin dhe pasuesit e tij.

Grupi parë prej njëzet personave u nis drejt jugut, pra, për në Mekkë. Ata për një kohë relativisht të shkurtër arritën që t'i bindin mekkasit se duhet luftuar dhe shkatërruar tërësisht Muhammedin s.a.v.s.;

Grupi dytë shkoi drejt lindjes tek fisi Gatafan të cilët pas një kohe të gjatë qëndrimi tek ky fis arritën t'i bindin se edhe këta duhet të luftojnë kundër Muhammedit;

Ndërsa grupi tretë merrej me beduinët e shkretëtirës.

Me një fjalë Medineja ishte e rrethuar nga të gjitha anët. Muhammedit s.a.v.s. i vinin informacionet se do të përballeshin me një sprovë shumë të madhe. Ajo që do t'i shpëtojë myslimanët është informacioni i bollshëm për lëvizjet e jomyslimanëve.

Në vitin e pestë të hixhretit, nga Mekka u nis një ushtri e madhe për kohën. Përgjatë marshimit të ushtrisë iu bashkëngjitën edhe shumë fise të vogla. Kështu numri tyre arriti mbi katërmijë ushtarë. Ndërsa ata të lindjes duke filluar nga fisi Gatafan dhe fiset tjera deri në afërsi të Medinës si dhe ata të fisin benu Nadir numri tyre arriti mbi gjashtëmijë ushtarë.

Ia vlen të theksohet se në atë kohë i tërë qyteti Medines nuk kishte dhjetëmijë, luftëtarë që mund të nxirrte Muhammedi prej këtij qyteti nuk ishte më shumë se tremijë.

Hapja e hendekut-kanalit

Derisa forcat aleate ende nuk kishin filluar marshimin drejt Medines, Muhammedi s.a.v.s. kishte mbledhur këshillin drejtues-shura. Në atë këshill u hodhën shumë propozime. I pari filloi Muhammedi s.a.v.s. dhe ju tha se ai mendonte që të bënte marrëveshje paqeje me fisin Gatafan duke ju dhënë atyre një të tretën e të korrave njëvjeçare. Pasi përfundoi Muhammedi s.a.v.s. njëri prej të pranishmëve Sead bin Ubade e pyeti. Këtë që dëgjuam është inspirim prej All-llahut ose mendim i juaji personal. Ai tha: jo mendim i tij personal. Atëherë ai tha: Ne jemi njerëz, por edhe ata janë njerëz, kemi jetuar në idhujtari ashtu siç janë ata tani. Derisa ishim në atë besim ata asnjëherë nuk janë ushqyer me bereqetin tonë me përjashtim kur kanë blerë ose kur kanë qenë mysafir tanë. Ndërsa neve u nderuam prej All-llahut me islam dhe duhet t'ua japim bereqetin tonë! Vallahi jo. Ne do t'i luftojmë ata deri në njeriun e fundit.



Në këtë mes mori fjalën e Selman Faresiu, ky ishte me origjinë perse. Ai u tregoi hapjen e hendekut. Ishte një praktikë e popullit të tij kur ndodheshin në situata të tilla. Ideja e hapjes së hendekut u pëlqye dhe menjëherë filluan të hapin hendekun-kanali.

Në hapjen e kanalit morën pjesë afër një mijë ushtarë. Kanali duhej të hapej nga pjesa jugore e Medinës dhe një pjesë nga ana lindore. Disa analistë të historisë janë pajtuar se kanali ishte i gjatë mbi dymbëdhjetëmijë metra.

Rrethimi i Medinës

Në Medine të parët arritën forcat e jugut, ata të Mekkës. Kur panë kanalin u befasuan sepse një mbrojtje e tillë nuk ishte parë ndonjëherë në gadishullin arabik. Ndërsa fiset të tjera kishin rrethuar anët tjera të qytetit. Ushtria mekkase dështoi në kalimin e kanalit, ata u përpoqën për disa ditë me radhë por pa sukses. Rrethimi zgjati një muaj, myslimanët shpëtuar falë prezencës së Muhammedit s.a.v.s. i cili shpërndau ushqimin në racione për të gjithë nga pak.

Ndërsa rrethimi vazhdonte Muhammedit iu paraqit një njeri nga fisi Gatafan i cili kishte pranuar islamin vonë. Ai kërkoi nga ai s.a.v.s. që ti jepte leje atij për të ndërmarë një fushatë përçarëse kundër forcave aleate. Muhammedi s.a.v.s. i tha: "Lufta është shkathtësi, taktikë dhe mashtrim" Pasi e mori lejen, ai fillimisht shkoi tek forcat e fisit benu Kurejdha. Ai ishte i mirëpritur tek ky fis dhe filloi të intrigojë për Muhammedin dhe në fund ju tha se Kurejshitët nuk janë si ju, nëse fitojmë bëhet mirë për të gjithë, por nëse humbim atëherë mjerë ju që jeni me banim afër myslimanëve sepse kurejshitët dhe gatafanët do të ikin dhe nuk ju ndodh asgjë. Së fundi ai propozoi prej tyre që mos të luftojnë pa marrë garancion prej kurejshitëve dhe gatafanasve një numër nga bijtë e tyre si garancion i marrëveshjes.

Pastaj shkoi tek mekkasit, pasi i bindi ata se është ishte në anën e tyre ju propozoi që fisit beni kurejdhave të mos u japin peng ushtarët e tyre sepse kishte informacion se ata e paskan shkelur marrëveshjen dhe e kanë informuar Muhammedin se nuk do të lutonin kundër tij sikur forcat aleate nuk do t'ua japi garancionin.

Kështu vajti edhe tek fiset tjera, gatafanëve dhe ju tha atë që ua kishte thënë mekkasve. Si përfundim lëvizjet e tij rezultuan me sukses, ata, ashtu edhe shumë të lodhur nga mossuksesi tyre për të kaluar hendekun mezi kishin pritur një përçarje midis tyre. Myslimanët atë kohë kujtojnë se ndihma e All-llahut erdhi sepse ishin lajmëruar erëra të forta dhe kishte mbretëruar një i ftohtë i madh. Moti tillë nuk ishte i zakontë për atë.

NJË VËSHTRIM PËRHAPJES SË DORËSHKRIMEVE ORIENTALE NË KOSOVË

"Asnjeri nuk çan kokën
Dokumentet për t'i mbledhur
Sikush nga një rrashtë rrokën
Në xhepa ar për të mbledhur".
Hafëz Ali Korça

Mr. Sadik MEHMETI

Me depërtimin e osmanlinjve në Kosovë dhe me vendosjen e administrimit të tyre (shek. XIV - XV), u fituan tipare të reja në të gjitha aspektet e jetës. Në përgjithësi depërtimi dhe vendosja e pushtetit osman bëri kthesë të madhe, jo vetëm në Kosovë, por gjithandej në trojet shqiptare, duke krijuar kështu një kufi të pakapërcyeshëm midis periudhës paraosmane dhe asaj osmane, pas së cilit kufi, përfundonte njëra dhe fillonte periudha tjetër krejtësisht e re, sepse, osmanlinjtë në trojet tona sollën, përveç të tjerash, një rregullim të ri shoqëror, një kulturë të re dhe një qytetërim të ri.

Kështu, me vendosjen e sundimit osman në trojet shqiptare dhe sidomos me përhapjen e islamit, i cili pati ndikim të ndjeshëm jo vetëm në mënyrën e jetesës, por edhe në kulturën materiale e shpirtërore, nis kontakti ballor i shqiptarëve me kulturën orientale, edhe pse shqiptarët historikisht kanë pasur lidhje kulturore si me Perëndimin, ashtu edhe me Lindjen. Mirëpo, me përqafimin e Islamit nga ana e tyre, lidhjet me Lindjen u zgjeruan, u shtrinë në disa fusha dhe u bënë më të drejtpërdrejta për një shtresë më të madhe të popullsisë.

Përhapja e islamit në trojet shqiptare, s'ka dyshim se ka luajtur një rol të dorës së parë në këtë drejtim, por jo edhe përcaktues. Themi jo përcaktues sepse kanë qenë, në radhë të parë, vlerat e larta të qytetërimit islam dhe të kulturës orientale ato që i kanë hapur rrugën vetes për të gjetur admirues në mesin e shumë popujve të tjerë. Ndërsa, përhapja e xhamive, mektebeve, medreseve, teqeve dhe bibliotekave kanë ndikuar në mënyrë të ndjeshme në zgjerimin e lidhjeve dhe të marrëdhënieve të ndërsjella kulturore shqiptaro-orientale.

Këto institucione të shumta, e institucionalizuan depërtimin kulturor të osmanëve në vendin tonë. Porse këto institucione nuk shërbyen vetëm si mjete të përvetësimit ideologjik në duart e sundimtarëve osmanë, siç është bërë zakon të thuhet. Ato u shndërruan në qendra të popullarizimit të arritjeve të shkëlqyera të qytetërimit islam, sidomos në fushën e letërsisë, në radhë të parë të poezisë dhe të filozofisë. Porse jo vetëm kaq. Ato u shndërruan edhe në qendra të studimit të kësaj trashëgimie, në qendra të lëvrimit të vjershërimit në gjuhën turke, arabe dhe perse.



Xhamitë, medresetë, teqetë, bibliotekat, vakëfet…

Xhamitë, medresetë, teqetë, bibliotekat, etj., kanë ndikuar pa dyshim në vetë popullatën, në kulturën e saj, në zhvillimin moral, në zakonet, në arsimin fetar e artistik dhe në aspekte të tjera.

Xhamitë, si institucioni më i rëndësishëm fetar islam, në Kosovë kanë njohur një shtrirje të madhe në kohë dhe hapësirë.

Xhamitë, gjatë tërë historisë së tyre, përveç se faltore u bënë edhe shkolla të para. "Shkolla, - siç vëren me të drejtë historiani i njohur F. Hiti, - i qe bashkuar xhamisë, nëse ajo vetë nuk ishte xhami" dhe nuk kishte ndryshime parimore midis shkollës dhe xhamisë.

Më vonë afër xhamive u ndërtuan godina për arsimin fillor, të ashtuquajtura kuttab ose mektebe, numri i të cilave u rrit aq shumë, saqë në çdo fshat kishte të tillë, madje në shumë raste kishte edhe më tepër se një.

Edhe në Kosovë funksioni shkollor i xhamive ishte i pranishëm, d.m.th. shkollat fetare islame në Kosovë janë të vjetra po aq sa edhe xhamitë. Kështu, vakëfnameja e Kuklibeut, e vërtetuar më 1538, i cili në atë kohë kishte ndërtuar shumë objekte fetare dhe social-humanitare, dëshmon se ai kishte ndërtuar dy xhami, të cilat njëkohësisht ishin edhe shkolla, kurse në mesin e dëshmitarëve kishte edhe disa mualim. Një shkollë të ngjashme kishte ndërtuar edhe Suziu, madje ai edhe vetë ishte mësues në të.

Gazi Mehmed pasha, pranë njërës prej xhamive më të bukura jo vetëm në Prizren, ndërtoi edhe medresenë e parë në Kosovë, e cila për nga përmbajtja dhe niveli i arsimit dallohej në tërë Rumelinë.

Veprimtarinë e xhamive e dëshmojnë edhe dokumentet e tjera, ku deri në gjysmën e dytë të shek. XVII zakonisht kishte aq mektebe, sa kishte edhe xhami. Prandaj mund të përfundohet se në mjediset myslimane numrit të xhamive përafërsisht i përgjigjej numri i mektebeve.

Në Kosovë, përveç mektebeve (numri i

të cilëve ishte shumë më i madh), pastaj shkollave iptidaie, rushdie dhe idadie, gati në çdo qytet relativisht të madh të Kosovës ka vepruar nga një medrese. Madje në vendet ku nuk kishte xhami a mekteb, mualimët (mësuesit) shkonin përkohësisht për t'i mësuar fëmijët.

Secila medrese, sipas rregullit ka pasur bibliotekë të veten, një pjesë libra dorëshkrimesh.

Bibliotekat, krahas xhamive dhe medreseve, kanë ndikuar shumë në zhvillimin kulturor dhe në ngritjen arsimore të popullsisë myslimane në këto treva. Më e vjetra ndër to, me sa dihet, është ajo të cilën e themeloi Suziu në Prizren.

Një bibliotekë tjetër mjaftë e vjetër që ekziston edhe sot është ajo e Mehmed pashës po në Prizren e ndërtuar në vitin 1537 ku ruhen afërsisht 200 dorëshkrime orientale. Prej tyre, për nga bukuria dallohen dy ekzemplarë të Kuranit, një koment i rrallë i Kuranit në gjuhën perse i vitit 1541/42. Këtu ruhet edhe "Kanuni mjekësor" - ("El-Kanun fi et-Tibb"), vepra "Mexhme'u-l-bahrejn" e vitit 1458, një koment i "Gjylistanit" të Saadiut, "Mesnevija" e Rumiut dhe vepra të tjera të rralla.

Këtu ruhen edhe veprat e disa myderrizëve të medresesë së Mehmed Pashës, si p.sh. biblioteka e çmueshme të cilën e dhuroi hafëz Abdullah ef. Hizri, myderriz i fundit i kësaj medreseje.


Edhe në qytete të tjera u themeluan biblioteka, si në Pejë biblioteka e "Atik Medresesë", e cila ka pasur një koleksion të çmueshëm të librave dhe të dorëshkrimeve orientale, pastaj në Gjakovë më 1733 u hap biblioteka e Medresesë së Madhe, me kupolën e saj karakteristike etj..

Mirëpo, librat - dorëshkrimet orientale nuk janë ruajtur vetëm nëpër bibliotekat e medreseve - shkollave (ndonëse këto ishin më të rëndësishmet, sepse shërbenin edhe si biblioteka publike), por ato kanë qenë pronë edhe e xhamive, teqeve dhe bibliotekave private, numri i të cilave në Kosovë, sikurse shihet edhe nga dorëshkrimet që ruhen në Arkivin e Kosovës, ka qenë i madh.

Ndërkaq, një rol jashtëzakonisht të madh dhe të pakrahasueshëm për përhapjen e fesë islame në Rumeli, pra edhe në Kosovë, dhe për përhapjen e kulturës islame në këto anë, rrjedhimisht edhe për mbajtjen, stimulimin e medreseve, xhamive dhe për mbushjen e pasurimin e fondeve të bibliotekave të këtyre institucioneve, e ka luajtur padyshim institucioni i vakëfit, që tek ne është i vjetër që nga viti 1513, kur poeti prizrenas Suziu themeloi vakëfin e tij dhe vakëfnoi një numër të madh të librave, ngriti xhaminë dhe themeloi edhe shkollën. Edhe Kuklibeu më 1538 themeloi një nga vakëfet më të mëdha në Rumeli.

I shënuam këto, me qëllim që të tregojmë rrugët përmes të cilave u përhapen dorëshkrimet orientale të cilat arritën deri në ditët tona.

Përhapja e dorëshkrimeve orientale është bërë edhe në rrugë të tjera, sidomos kur kihet parasysh fakti se një numër i njerëzve tanë janë shkolluar nëpër qendra të ndryshme islame, si në Stamboll, Kajro, Bagdad, Damask etj. Ata me rastin e kthimit nga atje, për nevoja të veta, kanë sjellë një numër të konsiderueshëm edhe të dorëshkrimeve orientale.



Edhe shkuarja në haxh ka qenë një prej rrugëve nga kanë ardhur këto dorëshkrime. Tregtarët, nëpunësit shtetëror dhe dinjitarë të tjerë që kanë shërbyer gjithandej në Perandorinë Osmane, gjithashtu kanë sjellë dorëshkrime orientale. Po edhe ata që kanë shërbyer tek ne, kanë shkruar a kopjuar libra në gjuhët orientale dhe pastaj i kanë lënë vakëf në vendin tonë. Sepse, siç dëshmojnë shumë burime historike, libri nuk është kopjuar vetëm në qendra të njohura të kulturës, por edhe në vendet më të skajshme të Perandorisë Osmane.

Me kopjimin e librit nuk janë marrë vetëm imamët (prijësit fetarë), siç ka qenë rëndomë tek pjesëtarët e feve të tjera, por me të janë marrë edhe myderrizët, talebët - studentët, bibliotekistët, ushtarët, zanatlinjtë etj.

Një dorëshkrim i kopjuar në vitin 1107/1695, nga Islam gaziu (ushtari) i biri i Abdul-gaziut, gjendet edhe në Arkivin e Kosovës.

Kopjimi i librit ka mund të porositej edhe tek kaligrafisti – "hattati", njeriu profesioni i të cilit pati qenë po ky.

Profesioni i kaligrafistit dhe i bukurshkruesit, në Kosovë është mësuar që me hapjen e mektebeve dhe medreseve të para. Madje në këto shkolla fëmijët kanë mësuar të shkruajnë në disa lloje të shkrimeve arabe, sidomos kanë mësuar llojin e shkrimit "rik'a", cili është përdorur në administratën osmane. Përgjithësisht në dorëshkrimet orientale, më së shumti takohen llojet e shkrimit "nes'h" dhe "ta'lik", kurse më rrallë lloji i shkrimit "thuluth".

Kujdes i veçantë i është kushtuar gjithashtu bukurshkrimit, kaligrafisë dhe vizatimit.

Kaligrafisti së bashku me "resuam"-in -miniaturistin dhe me "muxhel-lid"-in - libërlidhësin, përgatitnin anën artistike të librit, e sipas porosisë, për përgatitjen estetike të tij, angazhoheshin madje edhe nga tre artistë: kaligrafisti, miniaturisti dhe libralidhësi.

Me veprimtarinë e këtyre tre artistëve që i takonin institucionit të esnafit, në Kosovë, deri më sot, në mënyrë të veçantë nuk është marrë asnjë studiues. Të dhënat për këtë nuk mungojnë. Mendimin tonë e mbështesim në faktin se libralidhësit e Shkupit, të Shqipërisë dhe të Bosnjës kanë qenë të njohur në tërë Ballkanin.

Në anën tjetër, Prizreni që dikur kishte më shumë se 124 esnafe, sikundër edhe Gjakova, Gjilani e Prishtina, sigurisht në mesin e esnafëve të tyre, do të kenë pasur edhe libralidhësit, kaligrafistët dhe miniaturistët kosovarë.

Për zejen e libralidhësit, në studimet e tyre kanë dhënë ca të dhëna dr. Enver Dukagjini dhe dr. Drita Statovci, por me ilustrimin artistik të dorëshkrimeve orientale në Kosovë nuk është marrë asnjë studiues.

Alfabeti arab, shumë i përshtatshëm për kaligrafi, dekorime dhe për variante të nduarduarta, është shfrytëzuar shumë dhe me mjeshtri të rrallë në dorëshkrimet orientale. Dhe, me siguri, në asnjë art tjetër, - thotë Zagorka Janc, - kaligrafia, dhe ilustrimi artistik i dorëshkrimeve, nuk kanë pasur shtrirje sistematike sikurse në artin islam.

(Fusnotat i hoqi redaksia)

Leximi i tekstit

KUPTIMËSIA SHTRESORE E SHKRIMIT

Figura përbrenda njësive tekstore, bëhet ide për një artikulim jetësor, ku secila njësi dhe strukturë, do të shpreh një sistem specifik-kuptimor, duke forcuar kështu kohezionin kuptimor dhe semantik të tekstit.



Flamur MALOKU

Përmbledhja poetike e Vehbi Miftarit "Figura në rërë", artikulon një botë të emocioneve, emocione këto që shprehen përbrenda diskursit shkrimor të poezive. Subjekti identifikohet me këto emocione, të cilat nëpër shenjat e shkrimit trajtohen e artikulohen me vetëdije të plotë subjektive. Këto emocione rrjedhin nga koha, por edhe nga gjendja shpirtërore të tij. Ndërsa gjendja shpirtërore lidhet me një filozofi të veçantë të të menduarit e të të shprehurit. Kjo, do të thotë se rrafshi i emocioneve shtreson kuptime e domethënie të cilat, lidhen me figurshmërinë e tekstit, njëherit duke e krijuar edhe vet figurën. Në esencë, këto emocione janë para se gjithash, për të simbolizuar diçka përbrenda poezive. Poezitë sjellin kohën e tashme dhe të kaluar, e kaluara prodhon kujtimin ndërsa kujtimi emocionin, jo rastësisht, koha identifikohet dhe simbolizohet në kujtim. Kujtimet, ruajnë ndërmjet vete shenjat autobiografike, të cilat në disa poezi humbin ngadalë, sidomos kur subjekti përshkruan kohën e tashme. E tashmja-koha e largon autorin nga kujtimet, tani ai fillon të identifikohet më atë që është, mirëpo prapë koha e dikurshme e prodhon kujtimin, edhe pse kërkohet harrimi i saj. Kjo, njëherit krijon lidhje të ngushtë, ndërmjet asaj që përjetohet nga brenda dhe saj që kujtohet. Subjekti pozicionohet, në këtë rast në kërkim të figurave, të cilat gjatë poezive shprehin gjendje shpirtërore dhe emocionale. Nga kjo poezitë, konceptojnë dhe artikulojnë, çaste jetësore, çaste këto që shprehin një emocionalitet, të cilat shndërrohen në një argument të veçantë artistik, duke zbuluar e rizbuluar një shqetësim të ndjeshëm, një ironi dhe revoltë subjektive, të shprehura këto nëpërmjet diskursit poetik. Shqetësimi i ndjeshëm, si diçka ekzistuese dhe prezent, lidhet me kohën e shkuar, sidomos kur koha rikthehet në memorien e subjektit;

Më kujtohet
Atë ditë u zgjova më herët se zakonisht
Dhe nuk doja ta pija gotën e qumështit
Që kishte marrë ngjyrën e gjakut
Nëna e babai u zhytën n vorbullën e mendimeve
Prej nga dolën të bardhë

Kujtimet në kuadër te imagjinatës, rikthejnë në idenë autoriale kohën, e cila ka lënë gjurmë. Subjekti duke arsyetuar çdo herë përjetimin përball kohës, e karakterizon fuqishëm gjendjen dhe kuptimësinë, përkatësisht pësimin e dikurshëm. Rikthimi i qumështit në ngjyrë gjaku, shpreh metaforën e pësimit të dikurshëm të subjektin. Identifikimi nëpër kohë dhe hapësirë, përbënë një shumësi figurash, të strukturuar përgjatë emocioneve, të cilat cilësohen më një qartësi kuptimore. Një perceptim i këtillë manifestohet pothuaj në të gjithë veprën poetike. Përdorimi i figurave të sistemuara në ide e kuptim, në një farë mënyre, shprehin një depërtim të thellë në shpirtin e subjektit. Me përjetësimin e se djeshmes dhe të sotmes, krijohet ideja e jetës së vështirë dhe kuptimësia e saj, se çka përjeton njeriu, pasojë, dhembje dhunë etj. Poeti është i sigurt në zbërthimin e këtyre gjërave më të cilat njeriu ballafaqohet në jetë, prandaj, edhe rikthimi, sikur e emocionalizon poetin, sidomos kur ka të bëjë me rinjohjen e gjërave;



Herën e parë e pashë duke u katrrithur
Nëpër gurët e thepisur të rinisë së hershme
Ishte më i vogël se emri i tij
Por shpërthente si valë e krijuar
E kam parë
Për Zotin po

Subjekti nëpërmjet kuptimësisë shënjon rinjohjen e personit që dikur e kishte parë, mirëpo kjo rinjohje theksohet me një çuditëri të madhe, pra subjekti nuk u beson as syve të tij, në ndryshimin që sheh. Prandaj, për të argumentuar këtë lloj rinjohje subjekti betohet në Zot''Për Zotin po''. Ndryshimi vije si pasojë e moshës-kohës së vetë moshës, prandaj, esenca qëndron

këtu, se njeriu ndryshon përgjatë moshës nëse e kupton, kuptimi sqepaku vije, kur pushtohet së lodhuri prej ritmit dinamikë të jetës rinore. Ky mesazh poetikë, realizohet sipas logjikës së personalizimit përgjatë përjetimeve dhe preokupimeve nxitëse thjeshtë subjektive, të cilat lidhen me kohën dhe moshën e njeriut. Kështu, figura përbrenda njësive tekstore bëhet ide jetësore, ku secila njësi do të shpreh një sistem specifik, duke forcuar kështu kohezionin kuptimor dhe semantik të tekstit. Një konceptim i këtillë, në kuptimin e ligjërimit e të mendimit, shpreh vazhdueshëm ekzistencën e njeriut përballë jetës, funksionalizim ky që shënjohet në tërësinë kuptimore të tekstit. Jeta njëherësh është simboli, të cilën subjekti e trajton në mënyrë të veçantë me problemet që ka kjo. Mirëpo, përball jetës është edhe vdekja. Rinjohja e vdekjes është njëkohësisht edhe besim, për një rifillim tjetër jetësor, mirëpo, ky rifillim për autorin përjetohet si alarm;

U dha alarmi
Vehbiun e përpiu vala bashkë me shpresën
Detrat vdiqën në zemërimin e tij
Pas tij vrapuan gjithë zhytësit dhe mbytësit
Lajkatarët dhe koshmarët

Vargjet sugjerojnë një ç'thurje një zhgënjim subjektiv përballë moskuptimësisë së vdekjes. Subjekti ligjërues, vdekjen e sheh një shqetësim në vete, i cili shqetësim do të manifestohet me dilema të mëdha. Kjo kuptimësi e shprehur dhe e deklamuar në tekst, mbetet në rrafshin personal. Rrafshi personal identifikohet në çdo poezi, madje duke u identifikuar edhe më emër. Ky kategorizim tekstor harmonizohet në sistemin e kuptimit, si rrjedhojë e identifikimit subjektiv. Kjo rrjedhë nga fakti, së autori dëshiron një rinjohje me gjërat, për të cilat tani ai flet me dilema edhe pse prapë po rinjohët më to. Rinjohja nganjëherë mundet me qenë jo e perceptuar mirë, sidomos kur ekziston dilema përbrenda subjektit. Kjo ide do të konstituohet dhe determinohet nëpërmjet figurës dhe emocionit, ku emocioni dhe figura bëhen substanciale, për gjatë nivelit kategorial të shkrimit e të identifikimit. Ndjenjat dhe situatat personale, ndërtohen e mbindërtohen, duke rinjohur dhe shprehur emocionalitetin, që në këtë rast nënkuptojnë kohën – jetën autoriale, me një kryqëzim çdo herë të konkretësisë dhe dëshmisë. E gjithë kjo, nënkupton statusin- pozicionimin e autorit në tekst. Kjo, mund të shikohet dhe të konstatohet, nga shenjat dhe figurat, nëpër të cilat ndërtohet diskursi poetik, çdo herë në kërkim të rinjohjes me gjërat. Të cilat gjëra tani gërshetohen në mënyrë specifike, si në rrafshin e kërkimit, ashtu edhe në të realizimit, duke shenjëzuar ide dhe kuptime. Këto ide, sjellin një njohje të problemeve, probleme këto që hynë në strukturën kuptimore, duke u materializuar përgjatë veprës poetike. Figurat si; gurët, rëra, qumështi, vdekja, kopshti etj. Dëshmojnë më së miri, semiotikën e diskursit e të kuptimit, të cilat janë vënë, si shenjëzim i idesë, duke hapur shteg për thellim të mëtutjeshëm, çdo herë në kërkim të këtyre gjërave, për të cilat autori flet. Strukturimi kuptimor e artistik i figurave, luajnë rol esencial, për ndërtimin e shumësisë së pikëpamjeve, të cilat autori i shpreh.



Poezi

MALL PËR KOHËN E HESHTUR

Ervina HALILI

BALADË PËR HESHTJEN

Legjendë e verdhë mbi det
Ninullat bien si shi
Nina-nina djepin luhasin
Heshtjen s'e zë gjumi

ç'është ai mallë në horizont
I shenjuar në lule të ballit
Numëron stinët që nuk ndërrohen
Numëron ditët pa këmbë

Legjendë e verdhë mbi det
Qiell pa sorra
çudi
ç'është ai trishtim në frag të zi
Nina-ninë djepin luhatë
Por heshtjen s'e zë dot gjumi

DASMA

Sot heshtjen e martova
Pa këngë
Pa tupanë
Pa kavall

Sot, martova heshtjen time
Me heshtjen tënde të akullt
Mos u trashëgoftë
Kurrë.

KUSH E DI

U mbushën kujtimet pleshta
E malli nuk durohet
Nuk të gjej më
as në këngën e Amstrongut-"çfarë bote e bukur"
Ti…
Mund të kesh ikur
Me nëndetësen e fjalëve
Atje ku dielli perëndon në lindje

E kujtimet u mbushën pleshta
Mallin nuk kam vend ta mbaj
Nuk të gjej më as në gurët e sokaqeve
Kush e di
Ti edhe mund të kesh ikur
Pa i mësuar vargjet e mia të verdha
Sa dëm…

MË FAL

Nëse e do zhurmën,
drejtohu kah bota, të betohem
të pranon pa lutje
nëse ke dashur qetësinë
nuk mund ta jap timen
…është e mundimshme
më fal!

MË ZGJO

Më zgjo kur e verdha heshtje të ketë ikur
të vesh fustanin e kuq
E të nisem për festë
të ngre dolli për të vdekurën heshtje,
Dolli me një gotë gjaku nga shpirti i saj
Më në fund të them
Gëzuar…

NUK JAM UNË AJO

O ti
me sytë e verdhë
unë nuk jam mbretëreshë terri
që kalëroj ëndërrave nëpër mjegull,
as gjumi yt i pafjetur
që rrjedh
në gjakun twnd
ty të ka gënjyer shpirti


o ti,
unë s'jam as lodhja jote që të ndjekë
me thikë pas shpine
as heshtja e vetmisë
as piskama e kokës sate
o i verdhë
unë nuk jam ai
gjumi yt pa sorra.



Ese pa ilustrime

ARTSHKRIMI I ERËS SË RE

Gëzim ALIU



Pasi që eseja e lejon subjektivitetin, mendime që dalin drejt e nga shpirti pa u "censuruar" nga distilimi shkencor, pohoj se Fatos Kongoli e ka nisur një erë të re në letërsinë shqiptare. Jo në kuptimin e thyerjes së traditës, por në kuptimin e ripërtëritjes së saj, sipas ideve brilante të T.S. Eliotit.

Letërsia shqiptare, gati në krejt trupin e vet disa shekullor, është dashur t'i bartë blanat e rrethanave, njollat e ideologjive, që kanë lulëzuar nga ekstremi fetar e deri tek ekstremi ateist e komunist, por gjithmonë e mbështjellë me idenë supreme, idenë e kombit, ideologjinë kombëtare. Të paktë kanë qenë ata që kanë vepruar sipas aksiomës së Faik Konicës për ndarjen e letërsisë nga atdhesia. Në të vërtetë, siç pohon studiuesi S. Hamiti, përpjekjet për të kundërtën kanë shkaktuar edhe keqkuptime e polemika të pambaruara.

Letërsia ia fillon me literaturën kishtare, në kohën kur në Evropë shpërthente renesanca me Shekspirin; shpërthen romantizmi kur në Evropë shkruajnë Balzaku me shokë. Romantizmi shpërthen, në të vërtetë si vrull për identitet nacional, i ideologjisë së çlirimit kombëtar. Letërsia pas pavarësisë është normale, e drejtuar përfundimisht kah letërsia amë, letërsia perëndimore. Por, kjo edhe mund të ketë qenë shkak që pjesa më e mirë e saj u ndalua nga regjimi i ri i pasluftës së dytë, që synonte të lidhte dhe arriti, për fat të keq, të lidhë aleanca me lindjen dhe lindorët (sovjetët e kinezët). Nuk kemi asgjë kundër kësaj letërsie lindore, sepse dihet që edhe Naimi ka shkruar shumë sipas modeleve të saj dhe duhet të përkujtojmë kryeveprat e saj, por kallëpet e vendosura pas Luftës së Dytë ishin fillimi i aplikimit të mbytjes së letërsisë shqiptare. Edhe dogmat fetare u kanë lejuar Budit e Bogdanit të gjenin hapësirë për të futur veten si autorë të afishuar në veprat e veta. Por, letërsia e angazhimeve dëshironte që autor i letërsisë të ishte partia. Qenë të paktë ata autorë që i rezistuan kësaj, si p.sh., Kadare, që duke u munduar t'i ikë presionit krijon një sistem të vetin ideologjik mbrojtës, që prapëseprapë nuk mund ta kalojë idenë supreme, idenë e kombit. Neoromantizmi gjen shprehësin më të fuqishëm në këtë autor. Dhe ky neoromantizëm ia mundëson, fatmirësisht, njohjen ndërkombëtare. Kadare ka arritur që duke kundërshtuar me alegori historike e bashkëkohore dhe duke krijuar romantizmin e ri gati post-modern, të bëjë letërsi normale, të bukur. Por, brenda sistemit të letërsisë shqiptare.

Fati i njeriut jashtë kombit, jashtë ideologjive fetare a kombëtare a politike a tjetër sendi është trajtuar rrallë në letërsinë tonë. Migjeni e socializon kundërshtimin e vet të flashkët politik. Koliqi, tregimet veta të mrekullueshme i etnografizon. Kuteli po ashtu, përmes modelit intertekstual. Të mos flasim për Fishtën e madh, që idenë



kryesore të letërsisë sonë, idenë supreme, idenë e kombit, e ngre në lartësi artistike, por në lartësi artistike mitike. Ndonëse, në të njëjtën kohë ther me sarkazmin e vet. Konica mundohet, me atë romanin e vet të papërfunduar të trajtojë njeriun shqiptar tjetërqysh, por të qenit i pa përfundim nuk e kënaq kureshtjen tonë krejtësisht. Lasgushi nuk shkruan prozë dhe poezia e tij është ishulli i prehjes për mua kur dua të lexoj letërsi shqiptare pa praninë e idesë supreme. Në të vërtetë sintagma letërsi shqiptare është keqkuptuar gjithnjë, sepse është përkthyer si letërsi nacionale, çfarë edhe është dhe çfarë edhe mendohet edhe sot se është. E, unë dua të them se nuk ka letërsi nacionale, nuk ka pasur kurrë dhe nuk do të ketë. Ka padyshim literaturë nacionale, kurse letërsia, arti i shkrimit, qëndron gjithnjë përmbi. Ky fakt ndoshta e qet paksa në pozitë inferiore letërsinë shqiptare për të cilën nuk duhet të frikësohemi se nuk i ka në simbiozën e vet të dy tipat, literaturën shqiptare (nacionale) dhe letërsinë shqiptare. E para, natyrisht, artshkrimin e ka në format, modelet e statuset e tekstit, por që jetojnë në kuadër të idesë supreme. Shembull tipik është Kadare. Kurse, e dyta është artshkrim në formë e në ide. Shembull tipik e kemi Lasgushin dhe tash së voni, romancierin e madh Fatos Kongolin.

Kam dëgjuar së Kongoli trajton temën e pasojës. Pasojës së diktaturës. Mirë. Ai e trajton temën e njeriut, njeriut të humbur nga vrazhdësia e rrethanave. Nuk e trajton jetën vetëm të shqiptarit, por jetën njeriut që përcaktimi kozmologjik ia ka shkruar të jetë shqiptar. Kongoli nuk ka dyshim se shqiptari është në radhë të parë njeri, si gjithë të tjerët dhe se vuajtja e tij nuk është as shqiptare a as gjermane, por është vuajtje njerëzore. Vuajtje e palcës e shkaktuar nga ideologjia e poshtër e robërimit. Karakteret e tij janë njerëz të këtillë, fate të humbura në këtë labirint tmerri, që prapë përpiqen që ta luajnë lojën e jetës. Kjo lojë është tema e romaneve të tij. Ai shkruan edhe për kohën e tashme, por ajo është gati gjithnjë e lidhur me të kaluarën, sepse trauma e së kaluarës nuk mund të hiqet lehtë. Mirëpo, autori asnjëherë nuk bie në grackën e angazhimit. Ai rrëfen, rrëfen aq bukur saqë përpara na del koha e shkuar, e pikturuar pa mllef. Përpara na del koha e tashme, koha e "pasojës" mund të thotë dikush. Edhe kjo, gjithashtu! Prandaj, unë e mbroj mendimin e thënë në fillim se Kongoli e ka nisë një erë të re në letërsinë shqiptare. Se si do të quhet kjo, do të shohim pas disa dhjetëvjetëshave. Por, një gjë është e sigurt, se sikurse paraardhësit e tij prej letërsisë së krishtere, nëpër bejtexhinjtë e divaneve islamike e kah romantizmi i lindjes së idesë supreme nëpër letërsinë e pavarësisë e neoromantizmin, bashkë me avangardën, që kanë filluar epoka të reja, edhe ky autor, sigurisht edhe me të tjerë që do të dalin në pah në botën tonë letrare e sidomos të përkthyer në atë të huaj, e ka nisur epokën e majës së letërsisë artistike, letërsisë pa ato blanat e njollat që i ka bartur mjaft gjatë literatura shqiptare.

Ushqim i shëndetshëm për një trup të shëndoshë

DHJETË USHQIMET MË TË SHËNDETSHME NATYRALE

Rrepa, lakra, gujava, lakra zvicerane, kanella, purslana, shega, farat e frutave, kumbulla e thatë dhe farat e kungullit, janë dhjetë ushqimet natyrale, të cilat janë veçuar nga studiuesit

Artan BEJTA & Iliriana ALLOQI

Njëri prej faktorëve bazë dhe shumë i rëndësishëm për një shëndet të mirë, është ai i ushqyerjes në mënyrë të rregullt me gjëra të duhura dhe me masë.

Disa nga ushqimet që ne i shtrojmë në tryezën tonë janë më të pasur se të tjerët me përbërës që janë të rëndësishëm për një shëndet të mirë.

Shumë studime, janë bërë në lidhje me atë se cilat janë ato ushqime natyrale më të shëndetshme për organizmin tonë.

Sipas studimeve të realizuara, ekspertë të kësaj lëmie kanë arritur në përfundim, se ushqimet më të shëndetshme natyrale janë ato që përbëjnë lëndë ushqyese dhe antioksidant.





Antioksidantët janë substanca të cilat largojnë radikalet e lira, të cilat janë bashkime të paqëndrueshme me natyrë kimike që kanë efekt në shpejtimin e pjekurisë së qelizave. Kjo ndikon në parandalimin e sëmundjeve të ndryshme.

Dhjetë nga ushqimet natyrale të cilat janë veçuar nga studiuesit, janë: rrepa, lakra, gujava, lakra zvicerane, kanella, purslana, shega, farat e frutave, kumbulla e thatë dhe farat e kungullit.

Në vazhdim po i paraqesim disa nga karakteristikat kryesore të këtyre ushqimeve:

Rrepa

Është një nga përimet, që ka ngjyrë të kuqe me shije të ëmbël dhe janë shumë ushqyes dhe shumë vitaminoz, pothuajse nuk ka përime më vitaminoz se sa rrepat. Ajo përmban shumë përbërës të rëndësishëm,dhe është për shumë funksione të rëndësishme në organizëm. Dy prej këtyre substancave që i përmban rrepa janë; folat dhe bataina, dy lëndë ushqyese të cilat kanë efekt sidomos në ruajtjen e nivelit të gjakut, pastaj rindërtojnë arteriet e dëmtuara, e në këtë mënyrë ndikojnë në zvogëlimin e rrezikut për sëmundjet e zemrës.

Lakra

Është shumë ushqim kalorik dhe shumë i përdorshëm në vendin tonë, si në formë të freskët e po ashtu e gatuar me zierje. Përbërësit e saj luajnë rol shumë të rëndësishëm në stimulimin e shumë enzimave shumë me rëndësi në organizmin tonë, të cilat realizojnë prodhimin e radikaleve të lira, e në këtë mënyrë reduktojnë rrezikun nga kanceri.


Gujava

Është një frut tropikal, shumë pak i njohur në vendin tonë. Ka shije të ëmbël. Ka shumë përbërës, por më i rëndësishmi është likopeni. Likopeni si një përbërës shumë i rëndësishëm që gjendet në këtë frut, është një antioksidant, i cili lufton kancerin e prostatës.

Lakra zvicerane

Bimë jeshile në formë të gjethes së lakrës, e cila përmban lëndë të nevojshme për mirëfunksionimin e shëndetit. Në të gjenden përbërës të ndryshëm ushqimor, ndër ta edhe beta-karoteni. Ndër kemikatet të cilat gjenden në lakrën zvicerane, janë edhe ato







të cilat mbrojnë retinën e syrit, si dhe përmban pigmente që akumulohen dhe shfaqen në retinën e syrit.

Kanella

Njihet si një ndër aromat dhe erëzat më të vjetra të njohura në botë, e poashtu njihet edhe për ndihmën që jepte te burrat që kishin probleme me stomakun. Kanella, po ashtu ndihmon në kontrollin e nivelit të sheqerit në gjak, nivelet e larta të të cilit përbëjnë rrezik për shfaqjen e sëmundjeve të zemrës. Është zbuluar, se nëse të sëmurët me diabet tip-2 konsumojnë kanellë për gjashtë javë, atëherë do të ulet niveli i sheqerit në gjak.

Purslana

Kjo bimë është shumë e njohur dhe e përdorur në Meksikë, Kinë dhe Greqi edhe pse për Agjensionin e Kontrollit të Ushqimeve në botë, kjo bimë përbën një bar të keq, një lloj droge. Omega-3, është një përbërës shumë i rëndësishëm për sëmundjet e zemrës, e po ashtu përmban edhe një substancë si melatonina, një antioksidant i cili parandalon prodhimin dhe shtimin e qelizave kancerogjene.

Shega

Disa shkencëtarë kanë zbuluar se burrat që pinë një gotë me lëng shege në ditë, kanë përdorur një preventivë të mirë për t'u mbrojtur nga kanceri i prostatës, e po ashtu ndikon në rregullimin e punës së zemrës dhe presionin e gjakut. Është një lëng që përmban shumë vitaminë C, dhe ndikon jo vetëm në rregullimin e shumë proceseve në organizëm ,por shton edhe rezervat e vitaminave

në organizëm.

Farat e frutave

Shpesh shija e farës, të disa fruta të kujton shijen e frutit nga janë marrë. Përparësi e farave të frutave ndaj frutave është se, fara i reziston kohës d. m. th. është më e qëndrueshme se sa vetë fruti. Të tilla janë farat; e kajsisë, bajamet, frutat e ndryshme të thata, etj. Këto fara dhe fruta të thata në përbërjen e tyre kanë antioksidantë, të cilët reduktojnë nivelin e insulinës rezistente në gjak, e cila mund të jetë faktor rreziku për shfaqjen e diabetit.

Kumbulla e thatë

Kumbullat e thara përmbajnë sasi të larta acidi neoklorogjenik dhe klorogjenik, antioksidantë, që janë veçanërisht të rëndësishëm dhe efektivë në luftën kundër "radikalit superoksid anion". Ky radikal i keq dhe shumë i rrezikshëm shkakton dëmtime strukturale për qelizat dhe dëmtim i tillë mendohet të jetë shkaktari kryesor i kancerit. Për këtë arsye përdorimi i tyre ka një rëndësi të madhe.

Fara kungulli

Fara e kungullit, në përbërjen e vetë ka shumë magnez. Eksperimentet e shkencëtarëve francezë, dhanë rezultate se te personat që niveli i magnezit është i lartë në gjak, në një përqindje më të vogël janë të rrezikuar nga vdekja e hershme nga shkaktarë të ndryshëm. Fara e kungullit është mirë që të hahet e tëra me lëvozhgë.



TË REJA NË BOTËN E TEKNOLOGJISË

Adobe lejon vullnetarisht hakerat në Acrobat Reader



Boston (Reuters) - Adobe Systems Inc, softueri i të cilëve është përdorë nga miliona njerëz për leximin e dokumenteve të dërguara nëpërmjet Internetit, kanë njoftuar se disa prej programeve të tyre ende janë me të meta.

Më 5 tetor 2007, Adobe ka postuar lajmin në web faqen e vet ku ndër të tjera paralajmëron se ka të meta të dukshme në programet Adobe Reader dhe Acrobat të cilat do t'u lejonin programeve të dëmshme të futen në kompjuterin tuaj.

Nissan me modelin e ri të makinës që mund të ngitet nga të dy anët

Gjiganti i automobilave japoneze "Nissan" ka zbuluar veturën e re robotike të njohur me emrin "Pivo 2" të pajisur me rrotë të elektrizuara në mënyrë që të 4 gomat të ngiten si të pavarura dhe rrotullohen rreth kabinës së tij. (AFP/ Yoshikazu Tsuno)

Përgatiti:
Shkelzen Nuza



SËMUNDJET E GJIRIT

Sipas të dhënave më të reja, afër 6% e popullatës së femrave janë të përfshira nga kjo sëmundje si dhe me një tendencë rritjeje edhe në 1% brenda vitit. Mirëpo kjo sëmundje sot falë mundësive diagnostikuese, disiplinës dhe edukatës shëndetësore të vetë grave mund te zbulohet shume herët

Dr. sci. Selami SYLEJMANI

Gjinjtë janë gjëndra qumështi, çifte, të vendosura në muskujt e kraharorit në mes të brinjës së tretë dhe të gjashtë. Deri në moshën 8-10 vjeçare zhvillimi i tyre është i njëjtë si te djemtë ashtu edhe te vajzat. Pas kësaj kohe, për shkak të veprimit të hormoneve, të cilat prodhohen në vezore, te femrat vazhdojnë dhe zhvillohen ndërsa te meshkujt pushojnë së zhvilluari. Zhvillimi i tyre është nën veprimin e hormoneve seksuale (estrogjeneve dhe progesteronit). Në gjinj vazhdimisht kanë veprim hormonet seksuale për çka edhe madhësia, fyerja dhe konsistenca e tyre ndryshon gjatë fazave të ciklit menstrual.

Madhësia, forma dhe pozita e tyre varet nga raca, konstitucioni, veprimi hormonal dhe faktorët trashëgues. Gjinjtë tepër të mëdhenj, hipertrofik (macromasthia) mund të arrijnë peshë nga 5-10 kg e më shumë. Mund të jetë i rritur vetëm njëri gji, por zakonisht janë të dyja. Te disa gra kjo ndodh pas dhënies gji për një periudhë të gjatë dhe shumë lindjeve të cilat shkaktojnë lëshiminptozën e tyre.

Sëmundjet inflamatore ose pezmatimet gjinjve

Si çdo organ i organizmit të njeriut që mund t'i nënshtrohet proceseve patologjike, edhe gjinjtë e kanë këtë mundësi. Sëmundjet e gjinjve ndahen në: sëmundje inflamatore (pezmatime) dhe procese tumoroze.

Procesi i inflamacionit (pezmatimit) mund ta përfshijë tërë indin e gjirit (mastitis) ose thelbin e gjirit (thelitis). Në mbi 90% të rasteve shkaktarët e infeksionit vijnë nga jashtë, sidomos gjatë periudhës së lehonisë. Shkaktar më të shpeshtë janë: stafilokokët dhe streptokokët. Këto pezmatime paraqiten në fund të javës së parë të lehonisë. Shkaktarët e infeksioneve futen nga jashtë nëpërmes ragadeve (çarjeve) për shkak të higjienës jo të duhur të gjinjve.

Shenjë e parë është dhembja e lokalizuar në gjirin të cilin e ka kapluar inflamacioni dhe atë në vendin ku ndodhet ky pezmatim. Më vonë pos dhimbjeve, fillojnë të paraqiten edhe shenjat tjera lokale të inflamacionit si: skuqja e gjirit, tërheqje e lëkurës së vendit të pezmatuar dhe ënjtje. Nëse nuk fillohet mjekimi menjëherë, pezmatimi avancon dhe kalon në proces qelbësues ose absces. Nga shenjat e përgjithshme lehona ka ethetemperaturë të lartë dhe gjendje të përgjithshme të rëndë.

Çka duhet të bëjë lehona e cila ka pezmatim dhe a duhet t'i jepet fëmijës gji gjatë kësaj gjendjeje?

Që në fillim duhet t'i paraqitet mjekut më të afërt, i cili do t'i përshkruajë barërat përkatëse. Derisa të mos është paraqitur te mjeku, ajo mund të përdorë fasha të ftohta dhe ndonjë bar simptomatik (për temperaturë dhe dhimbje), pastaj mjeku i përshkruan terapinë përkatëse me antibiotikë. Nëse ka ardhur deri te formimi i qelbit (absces) atëherë duhet të bëhet një prerje dhe të largohet qelbi, por për këtë vendos mjeku përkatës.

Nuk mund t'i jepet gji foshnjës gjatë në këtë gjendje por laktacioni (mos humbja e qumështit) mbahet duke e mjel gjirin deri sa ai të mjekohet e pastaj mund të vazhdohet me dhënien gji edhe me gjirin që ka qenë i sëmurë.

Si të parandalohen proceset inflamatore - pezmatuarës?

Duhet t'i kushtohet rëndësi higjienës së gjinjve në përgjithësi dhe në periudhën e laktacionit (dhënies gji) në veçanti, të mos futen mjete të ndryshme në gji ose para të pastrohen duart para dhënies gji fëmijës. Mundësisht, thithat të pastrohen para dhe pas dhënies gji foshnjës. Në rastet me ragade (çarje) mirë është që pas dhënies gji thithat të lyhen me një yndyrë me antibiotikë psh. hidrokortizon. Nëse lehona ka shumë qumësht dhe foshnja nuk mund ta thithë gjithë sasinë atëherë duhet që pjesa e mbetur të milet dhe të largohet.


Çka është Mastopatia dhe me çka manifestohet kjo sëmundje?

Kjo është një sëmundje e gjinjve e cila ka shumë emra si: fibroza cystica, masthopathia chronica, adenosis, fibroadenomatosis etj. Manifestohet me një hiperplazion (rritje) të gjinjve, e cila mund të përcillet me formimin ose jo të cisteve në parenkimin e gjinjve. Nuk është sëmundje malinje. Kjo është sëmundje kronike dhe gati 50% e femrave vuajnë nga kjo patologji. Paraqitet te femrat e martuara dhe të pamartuara prej fëmijërisë e deri në pleqëri. Më e shpeshtë është nga mosha 20 deri në fillim të viteve 60-ta të jetës së femrës.

Sëmundja manifestohet me dhembje dhe fryrje në njërën ose në të dy gjinjtë. Ankesat janë të lidhura me ciklin menstrual dhe zakonisht paraqiten disa ditë para menstruacioneve ose gjatë gjakderdhjeve menstruale. Në disa raste edhe gjatë ovulacionit. Kur fillojnë menstruacionet, pengesat shpejt pushojnë e ndodh të vazhdojnë deri të kryhen menstruacionet. Gratë vetë prekin formacione-nyje të forta sidomos në 1/4 e jashtme të gjinjve. Mendohet se shkaktohet nën veprimin e estrogjeneve (hormone seksuale femërore).

Si mjekohet kjo sëmundje dhe a mund të kalojë në sëmundje serioze malinje?

Mjekim specifik nuk ka. Jepet terapi simptomatike. Mendohet se dhënia e preparateve me progesteron ka veprim të mirë. Kohët e fundit nga studimet që janë bërë është ardhur në përfundim se disa lloje ushqimesh si përdorimi i tepërt i kafesë, çajit të rusit ose Indisë, çokollatës si dhe streset, luajnë rol me rëndësi në paraqitjen gjegjësisht mosparaqitjen e kësaj sëmundje.



Duhet pasur kujdes nga se afër 6% të këtyre grave me këtë patologji mund të kalojë në kancer si dhe kujdesi i kësaj moshe (40-60 vj) nga se në këtë moshë paraqitet më së shpeshti kanceri i gjinjve.

A janë të shpeshtë tumoret e gjinjve te femrat dhe a duhet të mjekohen tumoret beninjë dhe si?

Një femër, ndër 5 gra preket nga një tumor i gjinjve, prej të cilëve 2/3 e rasteve janë beninje. Duhet të mjekohen patjetër nëse diagnostikohet ndonjë formë e tyre si formacionet cistike, ato duhet të operohen ngase në të kundërtën mund të kalojnë në tumor malinjë.


Po tumoret malinjë a janë të shpeshtë te femrat?

Nga të gjitha sëmundjet malinje (ose me zë të keq) te femrat, së bashku me kancerin e qafës së mitrës kanceri i gjinjve është ndër më të shpeshtit. Statistikat ndryshojnë nga vendi në vend, kështu në Japoni vdekshmëria nga kanceri i gjirit është 4 në 100.000, në SHBA 26. Në Evropë vdekshmëri më të

lartë ka Britania e Madhe, Danimarka 32-40 në 100.000 gra.
Gjatë jetës, 2-3% të grave sëmuren nga kanceri i gjirit. Nga të gjitha sëmundjet malinje 20-25% të tyre i takon kancerit të gjirit, ndërsa nga numri i vdekjeve nga sëmundjet malinje deri në 20% të grave vdesin nga kanceri i gjirit.
Sipas të dhënave më të reja, afër 6% e popullatës së femrave janë të përfshira nga kjo sëmundje si dhe me një tendencë rritjeje edhe në 1% brenda vitit. Mirëpo kjo sëmundje sot falë mundësive diagnostikuese, disiplinës dhe edukatës shëndetësore të vetë grave mund te zbulohet shume herët.

Në cilën moshë mund të sëmuret femra nga kanceri i gjirit si dhe a mund të sëmuren edhe meshkujt nga kjo sëmundje?

Nga kanceri i gjirit femra mund të sëmuret nga rinia e hershme e deri në fund të jetës së saj. Mosha më e shpeshtë kur sëmuren femrat është ajo rreth 40 deri në moshën 75 vjeçare. Sëmurën edhe meshkujt, por sëmundja te burrat është mjaft e rrallë. Marrëdhëniet e paraqitjes së kancerit të gjirit të burrat dhe gratë është 99:1 në favor të grave.



A dihet shkaktari i paraqitjes së kësaj sëmundje vdekjeprurëse dhe cilët janë faktorët të cilët e ndihmojnë paraqitjen e kësaj sëmundjeje?

Etiologjia (shkaku) e sëmundjes nuk dihet. Mirëpo ka mjaft studime që flasin për disa faktorë të cilët e favorizojnë si dhe disa të tjerë të cilët e mbrojnë femrën nga paraqitja e kësaj sëmundje të rrezikshme.
Faktorë kyçë janë hormonet seksuale të vezoreve sidomos estrogjenet. Kështu femrat të cilat nuk kanë lindur ose kanë pak lindje janë të favorizuara në paraqitjen e kësaj sëmundjeje. Sëmundja më e shpeshtë është te ato gra të cilat menopauza (menstruacioni i fundit) është e vonshme dhe gratë, të cilat kanë gjakderdhje të rregullta menstruale deri pas moshës 55 vjeçare, sëmuren nga kanceri i gjirit 2 herë më shpesh se te ato, të cilat menstruacionet u pushojnë para moshës 45 vjeçe.
Mënyra e ushqimit, sidomos ushqimi i pasur me yndyra, dhe gratë me peshë të shtuar (majme) sëmuren më shpesh nga kanceri i gjirit se femrat me peshë normale. Edhe femrat, të cilat ngelin shtatzënë për herë të parë pas moshës 30 vjeçare, më shumë mund të paraqitet kjo sëmundje se te ato që fare nuk kanë lindur dhe ky rrezik vjen duke u rritur sa më në moshë të shtyrë të jetë shtatzënia a parë. Disa studime flasin se edhe abortet e shpeshta rrisin rrezikun e paraqitjes së kësaj sëmundjeje.

Po duhani a ka ndikim në paraqitjen e karcinomit të gjirit?

Një kohë të gjatë janë duke u bërë studime në këtë drejtim. Te kafshët është vërtetuar se materiet kimike të cilat i përmban duhani me siguri shkaktojnë kancerin e gjirit. Kohët e fundit në Amerikë është shpallë një studim për kancerin e gjirit dhe duhanin. Nga ky studim është ardhur në përfundim se gratë, të cilat pinë duhan aftësia mbrojtëse e një gjeni, i cili ka ndikim në paraqitjen e kancerit të gjirit, ulet. Ky gjen, te popujt evropianë haset në mbi 50%. Janë të rrezikuara sidomos, ato femra që fillojnë të pinë duhan herët, si dhe ato, të cilat pinë më shumë se një pako brenda ditës.

A ka faktorë të cilët e mbrojnë gruan nga paraqitja e karcinomit të gjirit, cilët janë?

Rrezik më të vogël të paraqitjes së kancerit të gjirit kanë ato femra të cilave u janë larguar vezoret para moshës 40 vjeçare. Rrezik më të vogël nga paraqitja e kancerit të gjirit te femrat janë edhe menstruacionet e rralla për shkak të shtatzënive, dhënies gji një kohë të gjatë si dhe te ato femra, të cilat ngelin pa menstruacione herët. Edhe shtatzënitë e shpeshta e zvogëlojnë rrezikun nga paraqitja e kancerit të gjirit te femrat. Ka edhe disa të dhëna se shtatzënia para moshës 25 vjeçe e zvogëlon mundësinë e paraqitjes së kancerit të gjirit. Gratë, të cilat kanë lindur para moshës 18 vjeçare kanë vetëm 1/3 e rrezikut për tu sëmurë nga kjo sëmundje, në krahasim me gratë, të cilat për herë të parë kanë lindur pas moshës 35 vjeçare.

A është kanceri i gjirit sëmundje ngjitëse apo trashëguese?

Jo, dhe nuk ka frikë se kjo sëmundje mund t'i ngjitet personave të cilët e rrethojnë ose kujdesen për të sëmurën.
Nuk mund të thuhet me siguri se a është sëmundja trashëguese apo jo. Mirëpo, ka të dhëna se sëmundja është paraqitur te disa gjenerata të gruas së sëmurë si gjyshja, nëna, e bija, motra.
Incidenca e paraqitjes së kancerit të gjirit është 2-3 herë më e shpeshtë te gratë të cilat në familje (gjyshja, nëna, motra) kanë pasur të sëmurë me kancer të gjirit, në krahasim me ato gra, të cilat në anamnezën familjare nuk kanë pasur të sëmurë me këtë sëmundje.

Cila pjesë e gjirit është më e rrezikuar nga paraqitja e kësaj sëmundje?

Nëse gjirin e ndajmë në katër pjese atëherë në 1/4 e jashtme të sipërme në afër 48 të rasteve paraqitet më shpesh kanceri i gjirit, pastaj vjen 1/4 e sipërme e brendshme me 15%, 1/4 e poshtme e jashtme me 11% dhe më pak kanceri i gjirit lokalizohet në 1/4 e poshtme të brendshme 6%. Përreth thithit-areolës në 17% dhe multifolikular-në shumë vende 3%.

Cilat janë shenjat e paraqitjes së kancerit të gjirit?

Faza e fillimit të paraqitjes së kancerit të gjirit nuk ka ndonjë shenjë karakteristike. Shpesh ndodh që gruaja vetë të zbulojë, prek disa ndryshime në gjinj në formë të formacioneve të forta nyejsh. Këto zbulohen zakonisht gjatë larjes së trupit. Mirëpo janë bërë studime edhe te popujt më të ngritur në kuptim të edukatës shëndetësore, dhe se nga koha e prekjes së këtyre ndryshimeve e deri te paraqitja te mjeku së paku kalon 7-12 muaj. Sigurisht te populli ynë kjo është edhe më e vonuar për shkak të edukimit shëndetësor të pa mjaftuar. Në fillim këto nyje, të cilat preken janë të veçuara dhe të lira por me kalimin e kohës këto bashkohen me indin për rreth dhe më nuk janë të lira. Në disa raste hasen ndryshime në thitha (ato futen brenda) ose paraqitet skuqje apo trashje e lëkurës së gjirit. Në disa raste paraqitet rrjedhje e lëngut të përzier me gjak nga gjiri.

A përhapet sëmundja edhe në organe tjera?

Po. Në fillim procesi i kancerit të gjirit përhapet në tërë gjirin në drejtim të kraharorit dhe lëkurës ashtu që lëkura e gjirit merr një dukje si lëvorja e portokallit. Sëmundja mund të përhapet edhe me anë të gjakut në organe tjera si: vezore deri në 30% të rasteve, unaza të boshtit kurrizor, mushkëri, mëlçi, tru, etj.

Si caktohet diagnoza e kancerit të gjirit?

Për diagnozë të kancerit të gjirit duhet të merret anamneza mirë, ajo familjare dhe personale, të vështrohen gjinjtë, prekenpalpohen. Nga analizat duhet të bëhet: kontrolli me ultratingull sidomos te femrat e reja, mamografia-kontrolli me rëntgen dhe analiza citologjike e materialit të aspiruar – thithur me gjilpërë.

Kur duhet të bëhen kontrollet me ultratingull dhe me rëntgen ose mamografi?

Më së miri është që kontrolli me ultratingull ose me rëntgen-mamografi duhet të bëhet në fazën e parë të ciklit menstrual, pra menjëherë pas menstruacioneve gjegjësisht nga dita e 4 deri në ditën e 10 të ciklit menstrual.

A ka mjekim?

Po, ekziston mjekimi, i cili kryhet në institucione të specializuara. Rezultatet varen nga koha e zbulimit. Nëse zbulohet me kohe atëherë kohëzgjatja e jetës mund të arrihet deri në 20 vjet e deri në mjekim të plot. Mjekimi kryhet me rrugë operative dhe pastaj vazhdohet me dhënien e terapisë se specializuar për këtë qellim.

MASTURBIMI, VES VETËKËNAQËSIE APO SPONTANITET?

Masturbimi është një veprim që djem e vajza e bëjnë për të pasur kënaqësi trupore. Në fakt të masturbohesh, do të thotë të besh dashuri me vetveten. Disa e shohin atë si një gabim të tmerrshëm. Disa e dënojnë atë. Të tjerë thonë se në fillim është mirë, por më pas kthehet në një ves

Arber ZEKA

Masturbimi nënkupton fërkimin ose prekjen e trupit tuaj, në atë mënyrë që zgjon ndjenja seksuale dhe që pastaj vjen deri tek ejakulimi. Në moshën e adoleshencës, ky fenomen shfaqet të djemtë, por edhe te vajzat, si rezultat i dëshirës së tyre, për t'u njohur me trupin e tyre, më mënyrën së si ai punonë dhe se si funksionojnë organet seksuale të riprodhimit.
Masturbimi është një veprim që djem e vajza e bëjnë për të pasur kënaqësi trupore. Në fakt të masturbohesh do të thotë të besh dashuri me vetveten.
Disa e shohin atë si një gabim të tmerrshëm. Disa e dënojnë atë. Të tjerë thonë se në fillim është mirë, por më pas kthehet në një ves.
Me anë të masturbimit praktikuesi nuk arrin kënaqësinë reale, kështu që krejt ajo kënaqësi është produkt i imagjinatës personale dhe fantazi, prandaj ai person bëhet një tip që mbyllet me vetveten e tij, dhe nuk është komunikative më të tjerët.
Dobësimi i të mbajturit mend dhe indiferenca në mendime. Humbja e nervave, tendosje të karakterit, kështu që tek ata vërehet një ngushtësi dhe hidhërim të shpejtë për gjënë më të thjeshtë. Vonimi në martesë. Duke u bazuar në faktin së, ai që e praktikon atë, bëhet të mos mendoj për martesë, për të masturbimi është formë e shfryrjes së epshit.
Po ashtu, është shumë e njohur, së masturbimi ndikon, në raportet me bashkëshorten-in pas martesës, kështu që nuk arrin kënaqësinë e plotë gjatë marrëdhënieve seksuale me të.
Shumë njerëz vuajnë nga problemet e ndryshme në martesë, si mosndierja e kënaqësisë gjatë marrëdhënieve, apo probleme të ndryshme në organet e tyre gjenitale për shkak të praktikumit të masturbimit.
Nëse kjo gjë praktikohet për një kohë të gjatë, atëherë edhe pas martesës nuk mund të heq dorë njeriu nga kjo dhe për çdo hidhërim, vuajtje, apo pakënaqësi në martesë, mundohet ta kompensoj më këtë vepër të shëmtuar.

Meshkujt e praktikojnë masturbimin më shumë se femrat

Sipas statistikave, masturbimin pas martesës e praktikojnë 70 për qind e meshkujve dhe 60 për qind të femrave.
Praktikimi i masturbimit të vajzat është më i rrezikshme, për shkak së vajzat, në kërkim të kënaqësisë mund të përdorin mjete, e gjëra të ndryshme, apo edhe gishtat, që mund të shkaktojnë prishjen e virgjërisë. Gjithashtu, ajo mund të shkaktoj edhe deformimin e organit të femrës, si zgjerimi i tepruar i disa pjesëve të saj etj.
Edhe te meshkujt, praktikimi i masturbimit shkakton çrregullime shëndetësore, si dobësimi i ndjeshmërisë seksuale, etj.
Te djemtë, koka e penisit është shumë e ndjeshme dhe nga ngacmimi i saj ngjallë ndjenja për marrëdhënien intime. Presioni nga grafullimi i instinktit (seksual),e detyron të riun që me anë të masturbimit ta ejakulojë spermën nga trupi i tij, për t'i qetësuar nervat dhe tensionin seksual. Me atë rast aktivizohen gjëndrat seksuale dhe nga organi del sasi e caktuar e spermatozoideve. Megjithatë, nëse kjo procedurë, përsëritet shpesh mund që ndjeshmëria të dobësohet.



Prandaj, ai që aplikon këtë mënyrë të daljes së spermës mund të mos ketë mundësinë e kryerjes së marrëdhënieve intime, sepse organi gjenital i mashkullit më nuk ngacmohet me rastin e futjes së organit në vaginë, pasi që dalja e spermës nuk shkaktohet përveç pasi ta bëjë atë më dorë. Kjo shkakton dëm të vetë burri, gjithashtu edhe te gruaja, e cila ka të drejtë të kërkojë nga ai kënaqësi seksuale.
Me këtë rast, do të shtojmë edhe atë së sperma është një prej komponentëve kryesore të trupit dhe element bazë për krijimin e pasardhësve, përmendet së analizat kimike të bëra të spermës tregojnë, në mes të tjerash, së sperma përmban një sasi të madhe të kalciumit dhe fosforit, dy elemente shumë të nevojshme për formimin e trupit të njeriut. Nëse kjo është e vërtetë, atëherë njerëzit vërtetë gabojnë shumë kur këtë lëng (spermën) e konsiderojnë të tepërt dhe e hedhin jashtë pa nevojë.

Çka flasin statistikat për masturbimin në Kosovë?

Sipas hulumtimeve që janë berë në Kosovë nga Organizata Joqeveritare "Miqtë e Shëndetit", ku në hulumtim janë përfshirë 775 individë, në proporcion përafërsisht të njëjtë të dy gjinitë (53. 8 për qind femra dhe 45. 7 për qind meshkuj), të rinjtë nga të dy llojet e vendbanimeve, urban dhe rural, del se 26. 2 për qind e të anketuarve kanë provuar masturbimin.
Në bazë të grupmoshave, në hulumtim janë përfshirë 73. 5 për qind të rinjve të moshës 14-19 vjeç dhe 26. 5 për qind të rijnë të moshës 20-24 vjeç.
Ky fenomen është shumë më i shprehur, apo thënë më saktë shumë më i pranuar në këtë anketë, në mesin e meshkujve (47. 5 për qind) sesa në mesin e femrave (8. 2 për qind). Po ashtu, ka dallim në pikëpamje të vendbanimit, kështu që vetëm 18. 5 për qind e të të anketuarve nga regjionet rurale kanë pranuar të kenë masturbuar ndonjë herë derisa kjo përqindje është gati dyfish më e madhe tek të anketuarit urban (32. 1 për qind).
Prej atyre që kanë provuar masturbimin ndonjë herë dhe vazhdojnë të masturbojnë, 66. 1 për qind janë meshkuj dhe 76. 5 për qind femra. Ndërsa këtë shprehi e kanë braktisur 25. 6 për qind të meshkujve dhe 23. 5 për qind e femrave, që e kanë provuar ndonjë herë më parë.
Frekuenca e masturbimit brenda javës është më pak se një herë (47. 6 për qind të meshkujve dhe 32. 4 për qind të femrave) deri në 3 herë (2. 4 për qind të meshkujve dhe 5. 9 për qind të femrave).
Në bazë të moshës masturbimi është më i pranishëm në grupmoshën më të rritur (20-24 vjeç)-29 për qind, sesa në grup moshën më të re (14-19 vjeç)- 15 për qind.
Nga këto statistika, kuptojmë së masturbimi është dukuri mjaft e pranishme edhe në shoqërinë tonë.

Në Prishtinë është mbajtur një mbledhje parapërgatitore për Konferencën “e madhe” të donatorëve që pritet të mbahet në pranverë të 2008-s

Kosova pret mbështetjen e donatorëve ndërkombëtarë edhe pas statusit

Lulzim AHMETI

Në fillim të tetorit, në Prishtinë, është mbajtur një konferencë parapërgatitore për Konferencën “e madhe” të donatorëve që pritet të mbahet në pranverën e vitit 2008. Në këtë konferencë, udhëheqësit politikë të vendit, iu kanë premtuar donatorëve të mundshëm se do plotësojnë standardet e kërkuara nga Bashkësia Ndërkombëtare dhe se Kosova do të ketë në të ardhmen qëndrueshmëri financiare. Ata kanë kërkuar nga donatorët ndërkombëtarë që ta mbështesin Kosovën edhe në përudhen passtatusore.

Në këtë konferencë parapërgatitore, janë vlerësuar lartë sidomos të arriturat në sektorin privat në Kosovë.

Deri më tani Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës e kanë mbështetur me mjete financiare Banka Botërore (BB), Komisioni Evropian (KE) dhe donatorë tjerë të rëndësishëm ndërkombëtarë.

Prioritete të Qeverise së Kosovës të dalura nga Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH), janë sektori social, shëndetësia, arsimi, pensionet.

Nga kjo konferencë parapërgatitore, është arritur në përfundim se Kosovës i duhet vetëqëndrushmeri financiare, që të mos varet nga ndihmat dhe të fokusohet në prioritetet, sepse donatorët potencial duan t’i sigurojnë tatim-paguesit e vendeve të tyre se po investojnë parat e tyre në mënyrë të rregullt dhe të mirë në Kosovë.

Në takimin e parë në mes të Komisionit Evropian, udhëheqësve Qeveritarë të Kosovës dhe Bankës Botërore (BB), është prezantuar Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH), 2008-2010, nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave (MEF), si hap parapërgatitor për konferencën e madhe të donatorëve që pritet të mbahet pas definimit të statusit politik të Kosovës.

Në këtë konferencë, Qeveria e Kosovës është paraqitur me optimizëm duke dhënë fakte se do të ketë qëndrueshmëri financiare përkundër faktit se ende duhet ndihmë nga donatorët e jashtëm.

Duke folur para donatorëve kryeministri i Kosovës Agim Çeku ka premtuar se qeveria e Kosovës do t’i plotësojë standardet.

“Jemi Evropian jo vetëm me gjeografi, por edhe me zgjedhje dhe do t’i zbatojmë reformat e nevojshme”, ka thënë kryeministri Çeku duke shtuar se Qeveria e Kosovës është e përkushtuar plotësisht për një shoqëri shumë etnike që plotëson standardet më të larta ndërkombëtare. “Shoqëria jonë ka pranuar një konsensus se Kosova duhet të jetë shtet dhe Evropa duhet të jetë synim i yni”, ka thënë Çeku.

Kryeministri më tej i ka informuar të pranishmit, se janë bërë disa veprime për përgatitjen e Konferencës së Donatorëve duke potencuar se është hartuar Strategjia dhe Plani zhvillimor i Kosovës dhe Korniza Afatmesme e Shpenzimeve.

“Do të donim që të shfrytëzojmë këtë mundësi për të shtyrë përpara këtë proces drejtë finalizimit, dhe të pajtohemi për përgatitjen e Konferencës së Donatorëve në pranverë të vitit 2008”, ka thënë kryeministri i Kosovës, duke i falënderuar të gjithë donatorët për ndihmën e tyre.

Përfaqësuesja e Bankës Botërore(BB), për Evropën Juglindore, Orsalia Kalantzopoulos, ka tërhequr vërejtjen se gjatë periudhës deri në mbajtjen e Konferencës së Donatorëve, politikat e programit që Korniza Afatmesme e Shpenzimeve i ka të përshkruara, duhet të përmirësohen edhe më tej që të sigurohet stabilitet më i madh afatgjatë fiskal. “...Nëse donatorët i mbështesin investimet dhe projektet e dala nga Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH), kjo duhet të detajizohet edhe më tej dhe prioritetet e saj të jenë më të hollësishme për të gjithë sektorët, përfshirë sektorin social, shëndetësinë, arsimin, pensionet, etj., të cilat janë shumë të rëndësishme për një qëndrueshmëri afatgjate të zhvillimit”, ka spikatur Kalantzopoulos, duke shtuar se qëndrueshmëria i duhet edhe procesit të hartimit të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve.

Ndërsa shefi i UNMIK-ut Joakim Ruecker, ka theksuar se qeveria duhet të fokusohet në prioritetet të miratuara ne Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve, duke shtuar se Kosova ka më shumë të arritura në sektorin privat se sa në atë shoqëror. “Kemi mbushur zbrazëtira të mëdha në bilancin tregtar, eksporti po rritet, është hera e parë që sektori privat ka shënuar ngritje, ka theksuar Ruecker.


Numri një i UNMIK-ut, ka thënë se investitorët e jashtëm janë faktor i qëndrueshëm, duke e përmendur me këtë rast bisedimet rreth projektit “Kosova C”, të cilat i ka vlerësuar si sinjal se Kosova po ecën përpara.

Përfaqësuesi i Komisionit Evropian Drik Megank, ka premtuar se bashkësia ndërkombëtare do ta mbështes Kosovën. Ai ka theksuar se Kosova duhet të zvogëloj vartësinë nga ndihmat e jashtme dhe të përgatitet për të ecur vetë në rrugën e saj drejt zhvillimit ekonomik. Sipas tij, kjo mund të arrihet vetëm nëse Qeveria e Kosovës përmbush zotimet për përgjegjësinë fiskale.

Ministri i Ekonomisë dhe Financave, Haki Shatri, ka nënvizuar se buxheti i konsoliduar i Kosovës po mbahet me të hyra vetjake, por sipas tij ende janë të nevojshme donacionet nga donatoret ndërkombëtar. “Na nevojitet forma e mbështetjes buxhetore”, ka thënë Shatri, duke shtuar se vlera e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve nuk do të mbes vetëm në letër.

Në prezantimin e kësaj kornize para donatorëve të mundshëm, është bërë e ditur se sektorët me prioritet të studiuar nga qeveria e Kosovës janë: sundimi i ligjit, energjia, transporti, edukimi, arsimi, bujqësia, lehtësime për zhvillimin e sektorit privat, shërbime publike me efektive, etj.

Fjalëkryqi



HORIZONTALISHT

1. Solisti ynë, Sadiku, 2. Bazë ushtarake amerikane në Japoni, 3. Notueset, 4. Vuerja e trasës (shq.), 5. Vend në Indi – Shpend grabitqar, 6. Dorase – Intensitet 7. Jetësor – Kelvin 8. Futbollist injohur gjerman (shq.) 9. Litri – shprehje në fotoshop – Njeri I poshtër 10. Term në algjebër – Utopisti , Tomas – 1050 (romak) 11. Artur Esh – Shkenca që merret me gnomat 12. Agjenci e zbulimit secret anglez 13. Një perime – Tenistja gjermane, Shtefi – Përmër vetor, 14. Solisti Kutunjo – Nënat 50 (romak)- Njuton 15. Mbulesë e grave muslimane – Angstrem – Grup sporistësh (shq.) 16. Aeroport në Tokio – Përemër – Litri 17. Vullkan në Itali – Artikulacion 18. Veshje e sipërme e femrave – Furnizimi me armë 19. Komponime të cilat përmbajnë azot – I tërësishëm.

VERTIKALISHT

1. Aktori amerikan në Foto – Përfaqësues I antitanëve 2. Që ka të bëjë me dekorin – Lokal për të ngrënë 3. fuqia jetësore – ujëvarë 4. Vendës – Hapje me operacion e laringut – Iridium 5. Aktor dhe solist I vjetër amerikan – Aktorja, Rina – Austria 6. vend në Kongo – Tempo – Molekula – Zanore jona – Fushat 7. Miratim zyrtar – Lëndë vullkanike - Numër themelor 8. Hyjni supreme e egjiptasve të vjetër – Lum në Jakustuk 9. Ushtritë e padisiplinuara 10. Ish futboliisti holandez Johan – Futbollisti spanjoll Fernando 11. Amper – Gj. A – Litiumi – Literatura 12. Soliste jona, Morina – E para (ital.) 13. Personazh nga “1001 Netë” (shq.) – 1000 (fr.)